



Hëna e Re

Viti XXXV | Nr.370 | Korrik 2022 | Dhul Hixhe 1443 - Muharrem 1444 | Çmimi 50 den



Shlirshëm për Bajram



- Haxhi, konferenca më e madhe ndërkombëtare në botë
- Çdo besimtar duhet të jetë pjesë e porosive të Hixhretit
- BE: Një vendim historik



“Ne, vërtet, të dhamë ty shumë të mira. Andaj, ti falu dhe pre kurban për hir të Zotit tënd! E, s’ka dyshim se ur-rejtësi yt është farësosur.”

Besimtarë të nderuar, vëllezër e motra,

Po e përjetojmë Festën e madhe të Kurban-Bajramit, Festë të cilën ne myslimanët e përjetojmë me shpirt e me zemër, sepse Kurban-Bajrami na ripërkujton shumë ngjarje të historisë islame, e një ndër to është edhe përfundimi i Shpalljes së Kuranit famëlartë, me të cilin njëherë e përgjithmonë u vendosën themelet e individit, të familjes dhe të shoqërisë së shëndoshë.

Kësaj radhe gëzimi ynë në këtë festë është edhe më i madh, sepse në këto ditë në vendet e shenjta, në Qabënë e bekuar, në Arefat, Mine e Muzdelife, pas dy vitesh, me vetëdije të lartë e me iman të paluhatshtëm, mbi një milion haxhilerë e kryejnë kushtin e pestë islam - Haxhin, duke iu përgjigjur thirrjes së Zotit, me fjalët: **Lebejk Allahume Lebejke...** "Të përgjigjem i Madhi Zot. Unë të përgjigjem."

Në këto ditë feste të Kurban-Bajramit besimtari në praktikë e dëshmon besimin e tij, duke ndarë nga pasuria e tij për të prerë kurban, si një përkushtim ndaj Krijuesit, si një simbolikë e gatishmërisë së Ibrahimit (a. s.) për të sakrifikuar të birin e tij, Ismailin, për të çuar në vend premtimin e dhënë Allahut Fuqplotë - veprim ky i cili përfundoi me ndihmën e Zotit, duke dërguar një kafshë për ta flijuar në vend të Ismailit.

Kjo ia bëri me dije njerëzimit se ndihma e Zotit vjen atëherë kur njeriu mobilizon të gjitha potencialet e tij fizike-shpirtërore për të flijuar më të dashurën dhe më të shtrenjtën e jetës për Krijuesin.

Ti përkushtohesh Zotit me gjithçka që ke, do të thotë të kesh vetëdije të lartë mbi ndryshimin e botës drejt ngritjes së njeriut - vlerës më të madhe që krijoi Zoti.

Njeriu është krijesa më e shtrenjtë, ndërsa angazhimi për të është vlera më e madhe e njeriut dhe e jetës së tij. Andaj, kjo festë është rezultat i gëzimit për formimin e një ambienti të flijimit të më të shtrenjtës, nga e cila buron dashuria ndaj Zotit, për përkushtim ndaj njerëzores, humanes, morales, paqes e dinjitetit. Ndërkaq, varfëria, skamja, diskriminimi, mbytyja, lufta - janë veset më të shëmtuara që mund t'i ndo-

dhin njerëzimit. Të gjitha këto vijnë nga rënia e vetëdijes për të flijuar më të shtrenjtën për Zotin, e për të mirën e njeriut.

Të kryesh urdhrin e Zotit duke prerë kurbanin tënd, do të thotë përgatitje e lartë për t'u vënë në shërbim për tjetrin për një jetë pa keqpërdorime, pa vjedhje, pa korrupsion, pa amoralitet, pa destruktivitet dhe për të qenë personalitet dinjitoz në bartjen e amanetit të shenjtë në familje dhe në shoqëri me përgjegjësi dhe sakrificë të mundit, të dijes dhe të nderit, mu ashtu si gatishmëria e Ibrahimit (a. s.) për të flijuar më të dhimbshmen dhe më të dashurën - të birin e tij, Ismailin, e Ismaili - për të flijuar jetën e tij vetëm për një qëllim: realizimin e idealit hyjnor, i cili i lëviz rrjedhat e së mirës gjatë jetës së njeriut.

Ja si na e përkujton i Madhi Zot këtë koncept:

... (Ibrahimi tha) O biri im, unë kam parë (jam urdhëruar) në ëndërr të të pres ty. Shiko, pra, çka mendon ti? Ai tha: “O babai im, punojë atë që urdhëroresh, e ti do të më gjesh mua, nëse do Allahu, prej të durueshmëve!” (Assafaat: 102)

Vëllezër e motra!

Në këtë ditë të madhe të Festës së Kurban-Bajramit, nga thellësia e zemrës dhe e shpirtit, në emër të BFI të RMV dhe në emrin tim personal, të gjithë besimtarëve në vend dhe jashtë vendit, kudo që jetojnë dhe veprojnë, u shpreh urimet tona, duke iu lutur Allahut Fuqplotë që t'i pranojë lutjet tona, kurbanet tona, Haxhin e haxhilerëve që janë duke kryer, si dhe të gjitha ibadetet tona të bëra gjatë këtyre ditëve të bekuara.

Le të jetë kjo festë e gëzimit tonë, e respektit ndaj njerëzitetit, e afrimit me të tjerët, e shtimit të gëzimit dhe e kënaqësisë të skamnorët, tek ata që kanë vështirësitë e jetës; të faljes, të paqes e të solidaritetit dhe të afrimit të kënaqësia e Allahut Fuqplotë.

GËZUAR FESTËN E MADHE TË KURBAN-BAJRAMIT! – thuhet në Mesazhin e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, me rastin e Kurban-Bajramit 2022. Urimi është përpiluar me tekst dhe me zë në gjuhën shqipe, maqedonase, turke, boshnjake dhe rome. Ato janë transmetuar në platformat elektronike të BFI-së. (8.07.2022)

FRESKIME SHPIRTËRORE NË KËTË VAPË PËRCËLLUESE

Gjatë muajit korrik që po e lëmë pas, falë përputhjes kalendarike, përjetuam ngjarje të mëdha të karakterit fetar. Pra, në këtë muaj me vapë përcëlluese verore patëm edhe freskime shpirtërore, siç ishte rikthimi i kryerjes së kushtit të pestë islam – Haxhit, një kënaqësi e madhe jo vetëm për ata që shkuan haxhi, por edhe për të gjithë myslimanët, sepse dyert e Qabesë përsëri u hapën pas pezullimit dyvjeçar për shkak të pandemisë covid-19. Kjo bëri që festa e Kurban-Bajramit të jetë edhe më e hareshme dhe më kuptimplote. Po ashtu, therja e kurbaneve në emër të Krijuesit dhe shpërndarja e mishit, arriti kulmin e solidaritetit mes nesh.

Meqë muaji Dhul-hixhe është muaji i fundit i vitit hixhri, në korrik e kemi edhe datën e ndërrimit të viteve hixhri, nga ai 1443 në atë 1444. Pra, më 30 korrik është Hixhreti, ngjarje kjo që e tregon shpërnguljen e të dërguarit të Allahut (xh. sh.), Muhamedit (a. s.), nga Meka në Medinë.

Hixhreti i Muhamedit (a. s.) dhe i myslimanëve, ishte rrugë e përhapjes së dritës së besimit në Krijuesin e Gjithësisë, ishte rrugë e paqes dhe e shpëtimit, rrugë për të dalë nga errësira e tunelit të epokës së injorancës në dritën e epokës së re - epokë kjo e cila solli zhvillim të paparë në çdo lëmi të jetës.

Historia islame na tregon se Muhamedi (a. s.) nuk ishte peygamberi i parë e as i vetëm që bëri hixhret. Pra, edhe peygamberët tjerë kanë pasur hixhretet e tyre, siç është shpërngulja e Nuhit (a. s.), i cili njëherësh konsiderohet edhe hixhreti i parë në historinë e peygamberëve, pastaj hixhreti i Ibrahimit (a. s.), që konsiderohet “babai i peygamberëve” dhe hixhreti i Jakubit (a. s.) dhe i familjes së tij.

Këto hixhrete të peygamberëve (a. s.) dallojnë prej njëri-tjetri jo vetëm në kohë dhe hapësirë, por edhe për nga forma dhe mënyra e tyre e realizimit. Ndërkaq, ato janë unike në qëllime dhe motive dhe japin të njëjtën porosi: ajo është liria në besimin e vërtetë në Allahun (xh. sh.) dhe arritja e mirëqenies në këtë botë dhe në botën tjetër.

Meqë gjendemi në ditët e para të këtij viti, të frymëzuar nga porositë e Hixhretit, duhet bërë përpjekje që veprimet dhe punët tona t'i transformojmë, apo t'i "shpërngulim" nga e keqja në të mirë, nga e dëmshmta në të dobishmen, nga ndalimet e Allahut (xh. sh.) në hallallet (të lejuarat) e Tij. Kjo për ne, që s' kemi pasur mundësi të jemi pjesë e Hixhretit, është edhe obligative, duke iu referuar thënies së Muhamedit (a. s.): “*Nuk ka emigrim pas çlirimit (të Mekës), por ka mund, përpjekje, luftë dhe qëllim (nijet) të pastër*”; “*Mysliman (i mirëfilltë) është ai nga gjuha dhe dora e të cilit janë të qetë (të rehatshëm) myslimanët. Kurse muhaxhir (emigrues i mirëfilltë) është ai që i braktis plotësisht ndalimet e Allahut.*”

Nga këto thënie të të dërguarit të Allahut (xh. sh.) është shumë e qartë se Hixhreti nuk është një ngjarje që përkujtohet shkel e shko, por çdo besimtar i mirëfilltë duhet të jetë pjesë e porositë të Hixhretit, duke bërë përpjekje, duke dhënë mund, duke luftuar me të keqen në veprimet e tij në përditshmëri, për të vetmin qëllim, e ai është të largohet nga gjërat, nga veprat e këqija, drejt veprave të mira, ashtu siç na mësojnë mësimet islame.

Tanimë në vendin tonë është bërë traditë që kjo ngjarje të përkujtohet në mënyra të ndryshme. Bashkësia Fetare Islame e vendit tonë me rastin e ditës së Hixhretit organizon manifestim qendror kushtuar kësaj ngjarje të historisë islame. Përpos aktiviteteve tjera, në këtë manifestim, hafëzave të rinj, të cilit kanë kryer hifzin e Kurani Kerimit gjatë vitit hixhri që po lihet pas, në mënyrë solemne u shpërndahen diplomat e hifzit. Po ashtu, në këtë manifestim aktivistëve të caktuar u ndahet shpërblimi “Haxhi Vehbi Dibra”.

Në rastin e ndërrimeve të viteve hixhri, Redaksia e revistës “Hëna e Re” të gjithë lexuesve të vet u shpreh urime të përzemërta, duke u dëshiruar suksese në përpjekjet e tyre për t'u larguar nga veprimet e këqija e për të bërë vepra të mira.

Q. Osmani



MANIFESTIMI QENDROR, NË SHKUP



Manifestimi qendror i Kurban-Bajramit 2022, organizuar nga BFI e RMV, është mbajtur në Xhaminë e Mustafa Pashës në Shkup. Kurban-Bajrami është festa e dytë më e madhe pas Fitër-Bajramit (Bajramit të Ramazanit).

Më 9 korrik, 2022, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, uroi besimtarët myslimanë, duke kujtuar se kjo festë simbolizon solidaritetin, sakrificën dhe ndihmën e ndërsjellë. Ai tha se Haxhi është aspekti kryesor i kësaj feste, shoqëruar nga prerja e kurbaneve dhe ndarja e tyre me familjarët dhe ata që kanë nevojë. Haxhi i sivjetëm, tha ai, na ka gëzuar të gjithëve dhe ai erdhi pas mungesës prej dy vitesh për shkak të pandemisë me covid-19.

Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fe-

tahu, ndër të tjera, ka bërë edhe thirrje për paqe e bashkëpunim mes njerëzve pavarësisht feve dhe kombësive të tyre.

Manifestimi qendror në Xhaminë e Mustafa Pashës në Shkup filloi prej orës 04:30, me namazin e sabahut. Në orën 05:57 besimtarët në Shkup kanë falur namazin e Kurban-Bajramit.

Pas faljes së Bajramit, myslimanët kanë uruar njëri-tjetrin me mesazhe paqeje, mirësie, respekti, dashurie dhe mëshire. Sipas traditës, myslimanët Kurban-Bajramin e festojnë 3 ditë: me therje të kurbaneve dhe me vizita në familje, duke uruar njëri-tjetrin për ibadete të pranuar nga ana e Allahut (xh. sh.).

I tërë manifestimi qendror, në kohë reale, është transmetuar drejtpërdrejt nga Televizioni Publik i Maqedonisë së Veriut (MRT2). /desk.HeR/

“BAKLLAVAJA E BAJRAMIT” AFRON



Në fund të ditës së parë të Kurban-Bajramit (9.07.2022), Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në Hotel Bushi Resort & SPA në Shkup organizoi manifestimin “Bakllavaja e Bajramit”. Kishin ardhur për të uruar Kurban-Bajramin personalitete të ndryshme nga bashkësitë fetare, nga politika, diplomacia, media, jeta shoqërore dhe civile etj.

Me këtë rast, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu para të pranishmëve u paraqit me një fjalim rasti, i cili në kohë reale u transmetua përmes platformave elektronike të BFI-së.

Bakllavaja e Bajramit - rast i këndshëm, rast i afrimit mes miqve, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook.

Rast i volitshëm për pritjen e urimeve nga faktorë të brendshëm e të jashtëm, si: z. Ali Ahmeti, Kryetar i BDI-së; Kryeambasadori i Bashkimit Evropian; Kryetari i LB, z. Bilall Kasami; i boshnjakëve, z. Kolashinac; nga deputetë, Kryetarë komunash, përfaqësues të Dhomës Ekonomike, të Doganës së Maqedonisë së Veriut, të Bashkësisë Hebraike, të ambasadave e të tjerë, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu (10.07.2022).

ZOTI JU BEKOFTË!

Të dashur dhe të respektuar vëllezër, kolegë, bashkëpunëtorë, miq e dashamirë!

Në pamundësi për të kthyer urimet për festën e Kurban-Bajramit, të cilat kanë arritur në numër të madh, shfrytëzoj nga rasti që edhe unë përzemërsisht t'ju shpreh urimet e mia të përzemërta, duke iu lutur të Madhit Zot që t'ju japë shëndet, kënaqësi dhe suksese të reja.

Le të jetë kjo festë gëzim familjar, për afrim me njëri-tjetrin, për vendosmëri sakrifice e mudi fiziko-intelektual e shpirtëror, për të qenë sa më tepër në realizimin e aktiviteteve tona në të gjitha sferat në shërbim të Allahut Fuqiptotë, të Islamit, të vatanit dhe të popullit në përgjithësi. Zoti ju bekoftë! – ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook më 12.07.2022.

PAKETOHET DHE SHPËRNDAHET MISHI I KURBANIT

“Tek Allahu nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre, por tek Ai arrin devotshmëria juaj...”
(El-Haxh: 37)

Komisioni i Kurbaneve i Bashkësisë Fetare Islame të RMV njofton të gjithë besimtarët që kanë porositur kurbanin e tyre për nevojat e Internatit të Medresesë Isa Beu, se menjëherë pas faljes së namazit të Kurban-Bajramit, në mënyrë të organizuar ka filluar therja e tyre, thuhet në njoftimin e BFI (9.07.2022).

Procesi i therjes rrjedh sipas planifikimeve dhe për momentin janë therur mbi 50 për qind e tyre. Aksioni do të vazhdojë edhe në ditët në vijim.

Po ashtu, është paraparë që mishi që do t'i tejkalojë nevojat e Internatit të shpërndahet në mënyrë të organizuar për jetimët dhe skamnorët në të gjitha Myftinitë dhe në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lusim Allahun Fuqiptotë që të gjithë donatorëve që kujdesen për Medresenë Isa Beu dhe përcimin e fjalës së Allahut Fuqiptotë t'ua pranojë kurbanet dhe lutjet e tyre, thuhet në njoftimin e BFI.

Më 10.07.2022 ka filluar shpërndarja e organizuar e mishit të kurbanit nëpër Myftinitë, prej ku do të ndahet për të gjithë jetimët dhe skamnorët e vendit në bazë të listave të përpiluara paraprakisht nga Këshillat e xhamive dhe nga Myftinitë, thuhet në njoftimin e BFI (10.07.2022).

Amaneti i besimtarëve po kryhet me kujdes: Në ditën e dytë të Kurban-Bajramit Myftinia e Shkupit filloi me shpërndarjen e mishit të kurbanit dhe kryerjen e amanetit kundrejt besimtarëve, thuhet në njoftimin e BFI (10.07.2022).

Siç njoftoi Myftiu i Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, deri në orët e vona janë shpërndarë mbi 3.000 pako me mish kurban nëpër të gjitha rajonet e Myftinisë së Shkupit: në qytet, në Karadak, në Derven dhe në Karshiakë.

Në koordinim me Këshillat e xhamive të Shkupit, të gjitha familjeve me status të rrezikuar social u është dhuruar mishi i kurbaneve, pasi janë shikuar nevojat e Internatit të Medresesë Isa Beu.

Si çdo vit, në të katër rajonet aksionin

e kanë udhëhequr referentët e rajoneve përkatëse në bashkëpunim me hoxhallarët dhe përfaqësuesit e Këshillave të xhamive, të cilët e shpërndanë mishin e kurbanit mbi bazë të listave të përpiluara paraprakisht, me qëllim që mishi i kurbanit të arrijë në çdo familje me status të rrezikuar social, thuhet në njoftimin e BFI (10.07.2022).

Aksion i shpërndarjes së mishit të kurbaneve në Gostivar: Në ditën e dytë të festës së Kurban-Bajramit në Myftininë e Gostivarit në mënyrë të organizuar, në 31 xhami, janë shpërndarë 938 pako mish kurban. Aksioni i shpërndarjes do të vazhdojë edhe ditëve në vijim, duke mos lënë asnjë shtëpi skamnor pa i dërguar dhuratë nga mishi që i ka tejkuluar nevojat e mensës së Medresesë Isa Beu. Të gjithë donatorëve Allahu Fuqiptotë ua pranoftë kurbanet, thuhet në njoftimin e BFI (11.07.2022).

Amaneti i prerjes së kurbaneve të besimtarëve u realizua në përpikëri: Sot, në ditën e tretë të festës së Kurban-Bajramit, në ora 16:00 Komisioni qendror i Rijasetit të BFI për organizimin e prerjes së kurbaneve të besimtarëve nga vendi dhe diaspora njoftoi se plotësisht u krye dhe përfundoi therja e gjithsej 6.346 kurbaneve të dhuruara në BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI (11.07.2022).

I gjithë ky proces u krye në mbikë-



qyrje të plotë të Komisionit qendror dhe të nënkomisioneve nëpër të gjitha thertoret e kontraktuara. Tashmë tri ditë vazhdon ndarja e mishit nëpër të gjitha Myftinitë e BFI-së.

BFI dhe Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu shprehin falënderime ndaj besimtarëve që i besuan kurbanet e tyre për Medresenë Isa Beu. Allahu Fuqiptotë ua pranoftë dhe i shpërbleftë me shpërblimet e Tij të pakufishme, thuhet në njoftimin e BFI.

Në datën 11.07.2022 ka vazhduar shpërndarja e mishit të kurbaneve në Myftininë e Kërçovës, në Myftininë e Manastirit (1.000 pako) e kështu me radhë. Shpërndarja e mishit të kurbaneve do të zhvillohet në të gjitha Myftinitë e BFI të RMV, thuhet në njoftimet e BFI.



Shpërndarja e mishit të Kurbanit në Myftininë e Prilepit (foto: BFI, 12.07.2022).

MYFTIU I GOSTIVARIT URON BAJRAMIN NGA MEKA E BEKUAR

“Thuaj, namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve!” (En’am: 162)

Të nderuar besimtarë, vëllezër e motra!

Bekimet e vazhdueshme të Zotit që na mbuluan në këtë dhjetëditësh të Dhul-hixhes kurorëzohen me ditën e madhe të Kurban-Bajramit.

Nesër myslimanët anekënd botës festojnë Kurban-Bajramin. Kjo festë është quajtur kështu për hir të kurbanëve që myslimanët i sakrifikojnë për hir të Allahut këtë ditë. Por, krahas kësaj, është një festë, sepse vjen pas ditës së Arafatit, që është shtyllë e Haxhit – shtyllës së pestë të Islamit.

Myslimanët në këtë ditë përkujtojnë sakrificat e shumta të babait të pejgamberëve, Ibrahimit (a. s.). Si kurban, ashtu dhe ritet tjera të Haxhit, janë një rikujtim i gjurmëve të tij.

Këtë radhë, kam kënaqësinë që në emrin tim dhe në emër të të gjithë nëpunësve të Myftinisë së Bashkësisë Fetare Islame të Gostivarit t’ju uroj këtë festë nga Meka e Bekuar, nga këto vende të shenjta që mbajnë nënshkrimin e Muhamedit (a. s.) dhe të Ibrahimit (a. s.).

Sot është ditë e shënuar, ditë gëzimi, ditë feste, ditë reflektimi, ditë mirënjohjeje e ditë madhërimi. Sot falënderojmë Zotin për të mirat që na ka dhënë dhe vetëdijesohemi për mirësitë e mëdha që na rrethojnë nga çdo anë.



Të dashur besimtarë!

Këtë vit u rikthye mundësia që besimtarët e vendeve tona ta kryejnë Haxhin. Tavafi, Arafati dhe të gjitha adhurimet tjera na përkujtojnë gjenezën, na përkujtojnë se të gjithë jemi një dhe të njëjtë, se nuk ka dallim i bardhi nga i ziu, as i ziu nga i bardhi, përveçse në devotshmëri.

Ky adhurim i madh na përkujton ditën kur të gjithë të njëjtë do të dalim para Krijuesit tonë.

Andaj, le të jetë kjo festë ditë vetëdijesimi dhe nisme për t’u bërë më të mirë dhe për ta ndjerë në çdo moment se mbikëqyrësi ynë është me ne në çdo çast. Kjo

le të na bëjë më të mirë, më të ndjeshëm dhe më të dashur me njëri-tjetrin!

Sot, më shumë se kurrë, le ta kuptojmë madhësitinë e fjalës së Zotit, e cila na përkujton qëllimin dhe motivin e punëve tona: “Thuaj, namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botëve!”

Me shpresë e lutje Allahut Fuqplotë që t’i pranojë të gjitha duartë, adhurimet dhe kurbanet tona, ju uroj përzemërsisht të gjithëve: Gëzuar Kurban-Bajramin! Na qoftë për hair kjo festë e madhe! – thuhet në urimin e Myftiut të Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, me rastin e Kurban-Bajramit. (8.07.2022)

HAXHINJTË E BFI-SË UDHËTUAN ME 5 AEROPLANË



Më 26.06.2022 u nis grupi i parë i haxhilerëve të BFI të RMV për në vendet e shenjta. Ata u përcollën nga Kryetari i BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu dhe Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin ef. Zendeli, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, pati një fjalim rasti në ceremoninë e përcjelljes së grupit të parë të haxhilerëve nga Myftinia e BFI-Gostivar dhe kjo në kohë reale, drejtpërdrejt, u transmetua në platformat elektronike të BFI.

Më 27 qershor, në ora 02.05 min, në Aeroportin e Shkupit Kryetari i BFI, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, përcolli dhe i uroi rrugë të mbarë grupit të parë të haxhilerëve të BFI që u nisën për në vendet e shenjta. Ai shprehu mirënjohje për Drejtorin e Doganave, z. Muharrem Hasani, për pritjen dhe ndihmën që dha deri në brendinë e aeroplanit, që edhe një herë, në emër të BFI, t’u shprehim rrugë të mbarë haxhilerëve. Po ashtu, të njëjtën ditë, në orën 11:50, në mënyrën më të mirë udhëtoi edhe grupi i dytë i haxhilerëve, thuhet në njoftimin e BFI.

Në njoftimin tjetër të BFI (27.06.2022) thuhet: Arriti grupi i parë i haxhinjve në Mekë.

Grupi i parë i haxhinjve ka arritur shëndoshë e mirë. Haxhinjtë, kryesisht nga Gostivari dhe rrethina, u nisën nën mbikëqyrjen e Myftiut të Gostivarit, h. Sabahudin ef. Zendeli, i cili bashkë me stafin e tij të përbërë nga imamë, udhëheqës dhe mjekë, u përkujdesën që udhëtimi të kalojë sa më mirë.

Pas aterimit të aeroplanit, i cili u nis nga Shkupi dhe ateroi në Xhedah të Mbretërisë së Arabisë Saudite, haxhinjtë me transport të organizuar u bartën në hotelin Snood er Rejjan, hotel me katër yje dhe me kushte shumë të mira, në një distancë të afërt me Qabënë e Bekuar.

Haxhinjtë u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm i BFI h. Irsal ef. Jakupi dhe Përgjegjësi për Marrëdhënie me Botën Arabe h. Ismet ef. Ademi, të cilët patën dhe një udhëtim tjetër disa ditë më parë, me qëllim që të përkujdesen që atyre mos t’u mungojë asgjë gjatë qëndrimit në Mekë dhe në Medinë.

“Sot arriti grupi i parë i haxhinjve nga Maqedonia e Veriut, të cilët kanë bërë një jetë për të kryer kushtin e pestë të Islamit - Haxhin”, tha Sekretari i Përgjithshëm h. Irsal ef. Jakupi. Më tej ai shtoi: “Udhëtimi ka qenë mjaft i rehatshëm, ndërsa kushtet e vendosjes së haxhinjve tanë janë të mrekullueshme.”

Bashkësia Fetare Islame në orët e mëngjesit, më 27.06.2022, në faqen e saj zyrtare në rrjetin social Facebook transmetoi drejtpërdrejt arrijten e haxhinjve në hotelin e rezervuar. BFI edhe ditëve në vijim do të vazhdojë që të informojë familjarët dhe besimtarët e vendit rreth rrugëtimit të haxhinjve tanë. Allahu ua lehtësoftë dhe ua pranoftë Haxhin, thuhet në njoftimin e BFI (27.06.2022).

Haxhinjtë e Dibrës arritën në Mekë. Ata udhëtuan nga Shkupi për në vendet e shenjta, kanë arritur shëndoshë e mirë dhe tashmë janë akomoduar në hotelin ‘Snood er Rejjan’ në Mekë. Elhamdulillah! - thuhet në njoftimin e BFI (30.06.2022).

Në Informatën e parë të BFI të datës 30.06.22, ndërkaq, thuhet: Falënderimi i takon Allahut Fuqplotë, që e mundësoi që

919 haxhinjtë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, që udhëtuan me 5 aeroplanë gjatë këtyre tre ditëve prej Shkupit për në vendet e shenjta, të arrijnë shëndoshë e mirë dhe tanimë janë gati për të kryer Umren. Allahu Fuqplotë ua pranoftë lutjet dhe ua lehtësoftë Haxhin.

Në “Informim mbi Haxhin 2022” të po të njëjtës ditë thuhet: Falënderimi i takon Allahut Fuqplotë që mundësoi që 919 haxhinjtë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV, që udhëtuan me 5 aeroplanë prej Shkupit për në vendet e shenjta, të arrijnë shëndoshë e mirë. Bashkësia Fetare Islame e RMV me këtë rast njofton të gjithë besimtarët se me arrijten e aeroplanit të fundit, të gjithë haxhinjtë e RMV janë vendosur në hotelin Snood er Rejjan, hotel me katër yje dhe me kushte shumë të mira, në një distancë të afërt me Qabënë e Bekuar.

Të gjithë haxhinjtë e BFI të RMV për momentin e kanë kryer Umren dhe me shëndet janë mirë. Për shëndetin e tyre kujdesen 7 mjekë, të cilët vazhdimisht janë në përkujdesje të haxhinjve, ndërsa ambulanca është 24 orë e hapur dhe në shërbim të tyre.

Çdo grup prej 25 haxhinjve kanë një udhëheqës, i cili përkujdeset që të gjitha adhurimet të kryhen drejt dhe saktë. Meqë hoteli ku janë akomoduar haxhinjtë e BFI të RMV ndodhet në një afërsi të Qabesë, frekuentimi i shpeshtë i Qabesë bëhet me lehtësi.

Të gjitha procedurat e organizimit udhëhiqen nga Kryesia e Haxhit, në krye me Munadhimin h. Ismet ef. Ademi. Allahu Fuqplotë ua pranoftë lutjet dhe ua lehtësoftë Haxhin. Informon Kryesia e Haxhit 2022.

DITËT E TESHRIKUT...

Nga ditët e Kurban-Bajramit, çfarë janë Ditët e Teshrikut? Fjala "teshrik" do me thënë: tharje e mishit në diell. Kështu, ngase haxhinjtë, në të kaluarën e hershme, një pjesë të kurbanit të Haxhit e copëtonin në copa të vogla dhe e thanin në diell, që ta kenë si furnizim për rrugën e kthimit në vendet e tyre.

Ndërkaq, një mendim tjetër thotë se fjala "teshrik" do me thënë: lindje e diellit. Kështu, ngase falja e namazit të Bajramit dhe therja e kurbanit bëhen pas lindjes së diellit.

Ditët e Teshrikut janë: dita 11, 12, 13 të muajit Dhul-hixhe, përkatësisht dita e dytë, e tretë dhe e katërt e Kurban-Bajramit. (Kujtim Mirzo/në bashkëpunim)



“RRUGË TË MBARË, HAXHILERË DHE NA U KTHEFSHI ME HAXH TË PRANUAR”

Bazuar në programin e përcjelljes së haxhinjve të sivjetëm, Kryetari i BFI të RMV, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, ishte paraparë që në Aeroport të përcjellë personalisht grupin e parë dhe të fundit të haxhinjve të BFI të RMV, thuhet në informatën e BFI.

Kështu që, më 30.06.2022 Kryetari i BFI, Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, personalisht përcolli dhe uroi me rrugë të mbarë haxhinjtë e grupit të fundit të BFI, të cilët gravitojnë nga territori i Myftinisë së Kumanovës dhe Strugës. Në këtë grup udhëtoi edhe Kryetari i Haxhit 2022, h. Abedin ef. Imeri, Myfti i Kumanovës, i cili bashkë me Kryesinë Qendrore Republikane të Rijasetit do të koordinojnë në kryerjen e Haxhit të sivjetëm.

Mirënjohje të veçantë Komisionit Qendror për menaxhimin administrativ të udhëtimit, myftinjve të Myftinive me administratën e tyre për përgatitjen e haxhinjve, kompanisë "Free Bird" nga Turqia për precizitetin dhe rregullin e nivelit të lartë të fluturimeve ajrore, disiplinën e madhe të haxhinjve, në veçanti – administratës së Aeroportit, asaj të Kufirit dhe të Policisë, të cilët plotësisht ishin në shërbim të haxhinjve. Mirënjohje dhe ekipit përcjellës të BFI: z. Qufli Osmani, z. Shaban Rahmani dhe z. Milazim Dibrani.

Në këtë rast, Reis’ul-Ulemaja shfrytëzoi momentin që të urojë dhe t’u dëshirojë rrugë të mbarë të gjithë haxhinjve, duke lutur Allahun Fuqiptotë që t’u japë shëndet dhe iman të paluhatsëm, Haxh të pranuar dhe kthim në familjet e tyre shëndoshë e mirë. Zoti i bekoftë të gjithë haxhilerët e BFI të RMV, thuhet në informatën e BFI. (30.06.2022)



QABE, NA MUNGON

Qabeja është vendi më i mirë që ekziston në sipërfaqen e tokës. Është trualli më i përshtatshëm për çdo njeri që ka nevojën e këtij vendi të bekuar. Jo rastësisht Allahu fuqiptotë e ka përzgjedhur këtë tokë prej krejt vendeve të mbarë globit në përgjithësi.

Allahu thotë:

“Zoti yt krijon çka të dojë dhe zgjedh kë të dojë.” (Kasas: 68)


Pejgamberi (alejhis-selam) ka thënë:

“Pasha Allahun! Ti je vendi më i mirë i Allahut, ti je vendi më i dashur i Allahut tek Allahu; dhe sikur të mos më nxjerrin banorët tu prej teje (me dhunë), kurrë nuk do të të lija.” (Ahmedi dhe Tirmidhiu)

Meka e Bekuar është vend i shtëpisë së Allahut (xh. sh.), Ai adhurohet kudo dhe Atij nuk i përshkruhet shok.

Allahu (xh. sh.) thotë:

“Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo në Bekë (Mekë), e



dobishme, udhërrëfyese për mbarë njerëzimin.” (Ali Imran: 96)

O Zot, lutemi që mos të na e merrni shpirtin pa u takuar së paku një herë në

jetën tonë me këtë vend të bekuar dhe pa u kënaqur me dashurinë e tij. Amin.

(Përgatiti: Bajram ef. Ferati/në bashkëpunim)

HAXHI, KONFERENCA MË E MADHE NDËRKOMBËTARE NË BOTË



Nga Sabahudin ef. Zendeli

Me të drejtë Haxhi llogaritet edhe si konferenca më e madhe që organizohet dikund në botë.

Historikisht, në Haxh janë takuar personalitete nga vende të ndryshme të botës dhe kanë shkëmbyer përvoja me dobi për besimtarët.

Gjatë Haxhit të këtij viti, bashkë me Sekretarin e Përgjithshëm të BFI të RMV, h. Irsal ef. Jakupi, patëm kënaqësinë të ndjejmë edhe ne këtë madhështi nëpërmjet takimeve të shumta në Mekën e Bekuar - si në Arafat, ashtu edhe në vetë

Bejtullahun, pranë Qabesë së Bekuar - me personalitete nga Turqia, nga Kosova dhe shtetet tjera, si: Kryetarin e Diyanetit të Turqisë prof. dr. Ali Erbash, Kryeimamin dhe Sekretarin e BIK Vedat Sahiti dhe Ahmet Sadria, Ambasadorin e RMV në EBA z. Abdulkadër Memetin etj.

Gjithashtu, në Tavafin e Lamtumirës, pikëllimin e ndarjes nga Qabeja e Bekuar na e zbuti takimi me personalitete nga Turqia me peshë jashtëzakonisht të daluar në botën islame, duke filluar nga Myftiu i Stambollit prof. dr. Safi Arpagush, pastaj përgjegjësi i botimit të mus'hafeve për gjithë Turqinë hfz. dr. Osman

Shahin, ish-myftiu i Bursës dhe profesori universitar prof. dr. Mehmet Emin Ay, lexuesit e njohur të Kuranit nga Turqia - hafëz Alpxhan Çelik, Şykry Asëlleren, Is’hak Danësh etj., me të cilët biseduam për zhvillimin e mëtejshëm dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

I përgjrohemi Zotit që t’i ketë pranuar të gjitha lutjet dhe adhurimet tona, me shpresë se kthehemi me Haxh të pranuar dhe me mëkate të falura.

Allahu ju ruajtë dhe ju bekoftë!
/14.07.2022/

(Autori është Myfti i Myftinisë së Gostivarit)

DY LIGJËRATA NË MESXHIDIN E HOTELIT NË MEKË

Më 2 korrik, 2022, në Mesxhidin e hotelit në Mekë, ku po qëndrojnë haxhinjtë e Maqedonisë së Veriut, përgjegjësi i haxhinjve të Shkupit, Fejsal ef. Kadriu, organizoi ligjëratë dhe program fetar me të gjithë haxhinjtë e Shkupit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

Në fillim u lexua ashere nga Reshat Hoxha. Fjalë përsëritëse mbajti Fejsal ef. Kadriu, ndërsa ligjëratë rreth Haxhit dhe rëndësisë së tij mbajtën hoxha Amel ef. Kurtishi dhe Hafiz ef. Izairi.

Gjatë programit u kënduan edhe disa ilahi nga Nexhmi ef. Ferati dhe Xhevahir ef. Kamberi.

Duanë e bëri hoxha Orhan ef. Saliu.



Më 3 korrik, 2022, ndërkaq, udhëheqësja e haxhinjve nga Myftinia e Shkupit, Semra Kurtish, në Mesxhidin e hotelit në Mekë mbajti një ligjëratë për gjininë femërore, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Shkupit.

MBLEDHJE PËRGATITORE PËR ARAFAT



Sot, në mesxhidin e hotelit ku qëndrojnë të gjithë haxhinjtë e Bashkësisë Fetare Islame, Kryesia e Haxhit mbajti mbledhjen përgatitore për Arafat me të gjithë koordinatoren dhe udhëheqësit fetarë të Myftinive të BFI të RMV, thuhet në njoftimin e BFI.

Në mënyrë të detajuar, nga Kryesia të pranishmit u njoftuan për rrjedhën e organizimit të grupeve për dalje në Arafat, qëndrimin në tenda atje, të cilat këtë vit janë me kushte të mira (të klimatizuara, me tri vakte ushqim etj.) dhe shkuarjen në Muzdelife dhe Mina.

U përcaktuan detyrat e çdo udhëheqësi, për një organizim sa më të mirë. Allahu (xh. sh.) ua lehtësoftë dhe ua pranofitë kryerjen e Haxhit! – thuhet në njoftimin e BFI. (6.07.2022)



Më 5 korrik, 2022, haxhinjtë e Myftinisë së Shkupit vizituan Xhaminë e Aishes (radijallahu anha); Xhebeli Nurin, kodrën ku gjendet shpella Hira, ku filloi shpallja e Kuranit famëlartë; dhe shpellën Theur, ku u strehua Muhamedi (a. s.) gjatë Hixhretit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Shkup.

LUTJA NË DITËN E ARAFATIT



**Nga Taxhudin Hamidi
(Enkas për HeR)**

Muhamedi (alejhis-selam) është lutur: ‘O Zot, na mundëso që ta mbërrijmë Ditën e Arafatit dhe na mundëso që lutjet tona të pranohen (në këtë ditë).’

Besimtari mysliman falënderon Krijuesin e Gjithësisë dhe lutjet ia drejton Atij. Falënderimi dhe lutja janë cilësi të besimtarit.

Dita e Arafatit është një ditë shumë e rëndësishme, shumë e vlerësuar te Krijuesi i Gjithësisë. Lutja më e mirë është lutja në Ditën e Arafatit, apo në ditën e arifes.

Zoti i Gjithësisë dëgjoi lutjet e Musait karshi tiranisë së Faraonit. Ai dëgjoi lutjen e Hz. Junusit në brendinë e barkut të balenës. Ai gjithashtu shpëtoi Hz. Jusufin nga burgu i Faraonit (për ta mbrojtur njerëzimin nga katastrofa e thasësirës).

Në këto ditë të udhëtimit për në Haxh të gjithë janë të afërt me përkujtimet e Hz. Ibrahimit.

Allahu i Madhërisëm ia fali favorin

mbi sprovën e atësisë (me Hz. Ismailin). Zoti i Gjithësisë i pranoi lutjet e Hz. Ademit dhe Hz. Havës dhe i bashkoi (në këtë ditë të Arafatit). Në Ditën e Arafatit shpresojmë që Krijuesi i Gjithësisë, që përsosi qenien tonë, nuk do të na braktis dhe nuk do t’i refuzojë lutjet tona.

“O ZOT, SHPËTOJI EDHE MIQTË E MI”

Sepse, besimtari islam dhe realizuesi i kushtit të pestë – haxhiu nuk dëshiron të gëzohet dhe të lumturohet i vetëm. Nëse më shpëton mua (thotë ai), të lutem, o Zot, shpëtoji edhe shokët dhe miqtë e mi.

Dita e Arafatit dhe dhjetë ditët e Dhul-hixhes mbajnë primatin e natyrës njerëzore: të gjithë s’bashku me lutje para Krijuesit të Gjithësisë.

Muhamedi (alejhis-selam) paralajmëron si peygamber i fundit, duke thënë: *Lutja më e plotë në Ditën e Arafatit, të cilën e kanë thënë profetët e Zotit para nesh është: ‘Lailahe il-la All-llahu vadeu la sherike lehu, leahul mulku, velehul hamdu, vehuve ala kuli shejin kadijr.’*

Lutjet e besimtarëve janë nxitje për

një jetë më të ngjeshur me veprime pozitive dhe punë të hairit. Pra, nëse Zoti i Gjithësisë na braktis - kush mund tjetër të na lartësojë?! Nëse Ai na lartëson - kush mund tjetër përveç Tij të na mbrojë?!

Besimtari në këto ditë të festës së Kurban-Bajramit i drejtohet Zotit me lutje, duke thënë: *Zoti im, unë nuk dëshiroj të gëzohem i vetëm. Më ndihmo që me mua të gëzohen miqtë, shokët, fqinjët dhe gjithë ummeti i Muhamedit (alejhis-selam).*

Përsëri, lutjet janë të lidhura nga aspekti social dhe shoqëror dhe kjo shihet nga kërkesa e besimtarëve. Ata thonë në duatë e tyre: Nëse më shpëton mua, të lutem, o Zot, shpëtoji edhe shokët dhe miqtë e mi nga bregat e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Besimtari islam është një individ, një person, i cili atë që dëshiron për vete, e dëshiron edhe për gjithë njerëzimin. Kështu është natyra e besimtarit mysliman, e në veçanti e besimtarit shqiptar.

Kështu, Dita e Arafatit është karakteristike me lutjet: *O Zot, Ti je Ai që ke përsosur qenien time... Falëm mua dhe më mëshiro mua. - O Zot, Ti i dëgjove lut-*

jet e mia të sinqerta, prandaj mos na mërzi dhe mos na harro në këto ditë të bekuara. - O Zot, ne e mbërritëm Ditën e Arfatit, festën e Kurban-Bajramit, tani presim që të na falësh dhe të na pastrosh nga mëkatet.

- Ne shpresojmë që lutjet e haxhilerëve, dhe të gjitha lutjet në gjithë rruzullin tokësor, do të pranohen. - Dhe, si rezultat i lutjeve tona të pranuar, na dhuro lumturi në familjet tona dhe na dhuro suksese në punën tonë. - Mbroje vatanin tonë nga të ligat, nga deformimet dhe devijimet, nga shturjet, sepse ato janë patologjia e shoqërisë sonë, e cila do të ngec në lajthitje dhe prapambeturi. - O Zoti ynë, të lutemi, bëje ditën e sotme më të mirë se të djeshmen, ndërsa të nesërmen më të mirë se të sotmen. - Zoti ynë, së pari na prano si robër dhe si ummet i Pejgamberit (alejhis-selam) dhe na bëj të sigurt në amanetin tonë, deri në kohën kur atë t'ua lëmë të tjerëve. - Zoti im! Dërgoji në tokë sa më shpejt njerëzit e besueshëm, ashtu që pa e dëmtuar fare amanetin që kemi mbi supet t'ua për-cjellim gjeneratave të reja me shumë dinjitet dhe pastërti.

DUAJA, NISHANI I ÇDO BESIMTARI

Duaja dhe lutjet janë isharet dhe nishani i çdo besimtari. Sepse, besimtari përmes lutjeve dhe dhikrit e tregon përkushtimin dhe nënshtrimin e vet ndaj Krijuesit të Gjithësisë.

Populli shqiptar mysliman asnjëherë nuk u është shmangur lutjeve drejtuar Allahut (xh. sh.).

Nga origjina jonë shqiptare, në kontinuitet, kemi treguar nevojë për lutjet ndaj Allahut të Madhërisë. Pa dyshim, kjo cilësi e lutjeve tona, si një praktikë e mrekullueshme, ka vazhduar deri në ditët tona.

Populli ynë - gjithsesi, me popujt tjerë, dorë për dorë - në ditët dhe muajt më të mirë dhe më të dobishëm të vitit i lutet Allahut të Madhërisë. Dhe themi: Zoti i faltë të gjithë besimtarët. Zoti i udhëzotë të gjithë njerëzit në rrugën e Allahut.

Në Ditën e Arfatit besimtarët kërkojnë paqe, liri, drejtësi dhe barazi në botën mbarë. Prandaj edhe ne i bashkëngjitemi lutjes për paqe dhe stabilitet në botë. Urojmë që festa e Kurban-Bajramit të mbetet ditë e solidaritet, e ndihmave, e shprehjes së gëzimit dhe e faljeve mes njerëzve.

(Autori është Referent i Vakëfit në Myftininë e Tetovës)

ARAFATI (MARIFETI)



Arafati, para së gjithash, është një vend metafizik, një zbrazëti/plotëni dhe, më pas, një vend fizik, i gjendur në mes të shkretëtirës së Arabisë.

Në Arafat nuk ka asnjë objekt apo memorial; bile, as gjethe e pemë. Gjithçka është e "zhveshur" dhe kjo atmosferë të përkujton Ditën e Kiametit.

Lutja që recitohet në Arafat është: "Zoti im, na plotëso nën Arshin Tënd, ditën kur nuk do të ketë hije tjetër përveç

hijes tënde!"

Në Arafat hija rrezaton Dijen Hyjnore, "Al-Ma'rifâ" - term që ka të njëjtën rrënjë si vetë fjala Arafâ.

Ma'rifâ (marifeti) synon njohjen dhe përjetimin e Unicitetit, të Tërësisë (al-Ahad); jo vetëm tek mali Arafât, por kudo ku manifestohet prezenca e Krijuesit në këtë botë. /7.07.2022/

(Enris Qinami/në bashkëpunim)

NË ARAFAT, DERI NË PERËNDIM TË DIELLIT



Sonte, më 7.07.2022, 919 haxhinjtë e Bashkësisë Fetare Islame të RMV u vendosën në tendat në Arafat, duke pritur me lutje dhe ibadete ditën e Arifes - Haxhin e madh, thuhet në njoftimin e BFI.

Haxhinjtë e BFI, shëndoshë e mirë në Arafat: Bashkësia Fetare Islame e RMV njofton besimtarët dhe familjarët e haxhinjve të BFI se sot haxhinjtë nga Meka kanë shkuar në Arafat, ku edhe kanë filluar ritualin e Haxhit, thuhet në njoftimin e BFI (8.07.2022).

Me të mbërritur në Arafat, ata janë akomoduar në tenda dhe në bazë të informacionit nga Udhëheqja e Haxhit, të

gjithë janë shëndoshë e mirë. Në Arafat do të qëndrojnë deri në perëndim të diellit.

Me lejen e Allahut (xh. sh.), do të vazhdojnë rrugëtimin e tyre për në Muzdelife. Haxh të lehtë e të pranuar, ishalla! - thuhet në njoftimin e BFI.

Manifestime qendrore për Ditën e Arfatit nga ana e Bashkësisë Fetare Islame për gjininë mashkullore dhe femërore në tendat e Arfatit. Fjalim ka pasur Emirul-Haxhi i vitit 2022, Myftiu i Myftinisë së BFI-Kumanovë, h. Abedin ef. Imeri, thuhet në njoftimin e BFI (8.07.2022).

ARAFAT TË PRANUAR, TË DASHUR HAXHILERË

Nga Shaqir ef. Fetahu

Sot është Dita e Madhe e Arfatit. Të gjithë haxhinjtë e botës, në mesin e tyre edhe të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, po e kryejnë kushtin kyç të Haxhit - qëndrimin në Luginën e Arfatit.

Haxhinjtë e vendit tonë në krye me Emirin e Haxhit, h. Abedin ef. Imerin dhe anëtarët tjerë të Kryesisë: h. Ismet Ademi, z. Irsal Jakupi, h. Fejzal Kadriu, h. Selver Xhemaili, Myftiu i Gostivarit h. Sabahudin Zendeli, si dhe tre anëtarët e Rijasetit: prof. dr. Shaban Sulejmani, z. Fadil Ramadani dhe Myftiu Samet Aj-

dari, bashkë me koordinatorët dhe ekipin udhëheqës, prej momentit të parë e deri më sot i ka përshkuar aktiviteti i lartë, kënaqësia e përzemërt, ndjenja e thellë shpirtërore, duke iu drejtuar të Madhit Zot: "Të përgjigjemi i Madhi Zot."

Sonte nisen për në Muzdelife, Mina, deri në hudhjen e gurëve në Xhemeratë. Tërë natën do të jenë në ibadet të pandërprerë.

Jam shumë i lumtur me rrjedhën e realizimit të Haxhit: të gjithë unikë drejt një qëllimi, pa asnjë problem, pa sëmundje apo vështirësi. Si vëllezër e motra, i përshkon fryma e kënaqësisë dhe ndihma për njëri-tjetrin.

I bëj lutje Allahut Fuqplotë që, së pari, t'ua pranojë qëndrimin në Arafat dhe, në këtë natë të bekuar, me sukses t'i kryejnë ritet tjera dhe obligimet që kanë të bëjnë me Haxhin.

Ju priftë e mbara, sonte, në këtë natë të bekuar.

Zoti jua pranofte të gjitha ibadetet dhe ritet e haxhit.

Njëherësh, të gjithë haxhilerëve iu shpreh urime për Festën e Madhe të Kurban-Bajramit.

Zoti ju bekoftë. /8.07.2022/

(Autori është Reis'ul-Ulema i BFI të RMV)



Sekretari i Përgjithshëm i BFI-së, h. Irsal ef. Jakupi: Tavafi im i fundit për Haxhin 2022, Tavaful Veda (Tavafi i Lamtumirës), me dy myftinjtë e nderuar - Samet ef. Ajdari /Ohër dhe Sabahudin ef. Zendeli /Gostivar. (13.07.2022)

HIDHEN GURALECËT NË MINA

Më 10.07.2022, në mënyrë të organizuar, me 14 autobusë, të gjithë haxhinjtë e BFI realizuan hedhjen e guralecëve në ditën e dytë në Mina (Xhemerat), thuhet në njoftimin e BFI.

“Me kujdes të veçantë po e përcjell realizimin e kushtit të pestë të Islamit - Haxhin në Mekë të Arabisë Saudite. Ndjej kënaqësi të veçantë kur shoh se këto katër ditët e fundit me vetëdije të lartë kanë kryer shtyllat kryesore të Haxhit, duke i përshkuar fryma e gëzimit, e kënaqësisë dhe lumturisë gjatë qëndrimit në Arafat, Muzdelife, Mina, gjatë ritit të hedhjes së guralecëve në Xhemerat, kryerjes së Tavafu zijareh, duke arsyetuar titullin ‘Mysafirë të Allahut’.

Kryesia e Haxhit, në krye me h. Abedin ef. Imerin, deri më tani, me të gjithë trupat organizativë, kanë treguar aftësinë dhe përkushtimin e tyre të lartë shpirtëror e fizik. Shpresoj të vazhdojnë me të



njëjtin kujdes dhe nivel deri në ditët e fundit, në shërbim të plotë të haxhilerëve tanë nga Maqedonia e Veriut, duke ua plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme, sepse kjo ka qenë dëshira dhe ideali i

jetës së tyre. Mund i plotë, në shërbim të haxhilerëve tanë. Zoti i bekoftë”, ka shkruar në faqen e vet në Facebook Reis’ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu të njëjtën ditë.

KRYHEN TË GJITHA OBLIGIMET E HAXHIT

Më 17 korrik, 2022, haxhinjtë e Strugës, të ndarë në tre grupe dhe të shoqëruar nga udhëheqësit e tyre, kryen Tavafin e Lamtumirës (veda) dhe me këtë u dhanë fund të gjitha obligimeve të Haxhit, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Strugës.

I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që t’ua pranojë Haxhin, të gji-

tha adhurimet dhe lutjet e bëra në Mekën e Bekuar.

Një ditë më vonë haxhinjtë tanë udhëtojnë për në Medinë, qytetin e Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe atje do të qëndrojnë deri më 25.07.2022, kur është paraparë edhe fluturimi nga Medina për në Shkup, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Strugës.



GRUPI I PARË I HAXHINJVE KALON NË MEDINËN E NDRITUR

Bashkësia Fetare Islame e RMV më 14 korrik, 2022, ka dalë me një komunitatë në të cilën thuhet: Njoftohen të gjithë besimtarët dhe familjarët e haxhinjve që kanë udhëtuar nën përkujdesjen e BFI të RMV, se grupi i parë i haxhinjve të BFI-së e ka kryer Tavafin e lamtumirës dhe në mënyrë të organizuar ka arritur në Medinë e Pejgamberit (a. s.). Grupi përbëhet prej 180 haxhinjve nga Myftinia e Gostivarit.

Po ashtu, njoftohet opinioni se të gjithë haxhinjtë janë shëndoshë e mirë dhe në ditët në vijim do të kenë mundësi që të kryejnë ibadete dhe lutje në Medinë e Ndritur, ku do të vizitojnë xhaminë dhe varrin e zotërisë së njerëzimit, Muhamedit (a. s.). I bëjmë lutje Allahut Fuqplotë që t’ua pranojë Haxhin gjithë haxhilerëve tanë dhe të kthehen me Haxh dhe lutje të pranuar! – thuhet në njoftimin e BFI.



HAXHINJTË E GOSTIVARIT NË MEDINËN E NDRITUR

Në organizim të Kryesisë së Haxhit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, më 17 korrik, 2022, haxhinjtë e grupit të parë dhe të dytë që vijnë nga Myftinia e BFI-Gostivar, nën udhëheqjen e Myftiut h. Sabahudin ef. Zendeli dhe në koordinim të koordinatorit hfz. Jusuf ef. Xheladini, si dhe udhëheqësve fetarë-hoxhallarëve të nderuar, realizuan vizitat në Medinë e Ndritur, si: atë në kodrën Uhud, Mesxhidul Kibletejn (Xhaminë e Dy Kibleve), shtatë xhamitë në Hendek, Xhaminë e Kubasë dhe Kopshtin e hurmave etj., thuhet në njoftimin e BFI.

Një atmosferë e këndshme për të shijuar ëmbëlsinë shpirtërore dhe për të përkujtuar të lavdishmen e ummetit islam, në vendet ku kanë qëndruar më i miri i njerëzimit, Muhamedi (a. s.) dhe shokët e tij.

Po ashtu, të njëjtën ditë, haxhinjtë e Myftinisë së Gostivarit, në kuadër të vizitave të tyre, në mëngjes gratë (haxhine-shat) dhe në mbrëmje burrat vizituan



Kopshtin e Xhenetit (Reuda), ku falën namaz dhe bëjnë dua. Më pas kaluan pranë varrit të Resulullahut (a. s.), Ebu Bekrit (r. a.) dhe Omerit (r. a.), ku përcollën selame për ta, thuhet në njoftimin e BFI.

HAXHINJTË E TETOVËS BËJNË TAVAFIN E LAMTUMIRËS

Më 14 korrik, 2022, haxhinjtë e Myftinisë së Tetovës përfunduan edhe Tavafin e Lamtumirës. E lusim Allahun Fuqiptotë që të gjithë haxhilerëve t'ua pranojë lutjet dhe të gjitha ibadetet! – thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Haxhinjtë e Myftinisë së Tetovës më 17 korrik vizituan Mesxhidin Kibletejn (Xhaminë me Dy Kible), Mesxhidin Kuba, kodrinat e Uhudit dhe varrezat e shehidëve (dëshmorëve) të Uhudit, thuhet në njoftimin e BFI.



SHKURTOJE MJEKREËN, MIK...



Nga Irfan Agushi

Nëse bashkë me mjekrën rritet edhe krenaria (egoja) jote, atëherë të sugjeroj ta shkurtosh atë...

Të ishte një rast, do ta kaloja pa përmendur, por janë bërë shumë.

Ka disa myslimanë të cilët pas namazit që bëjnë ndihen më superiorë ndaj atyre që nuk falen me rregull; ka të tjerë që i shikojnë me përbuzje ata që nuk agjërojnë; disa të tretë, pasi të jenë kthyer nga Meka e bekuar (Haxhi), e vënë veten në vendin e një studenti të sapodiplomuar; dhe, në fund fare, ka nga ata të cilëve bashkë me mjekrën u rritet edhe krenaria dhe të tjerët i shikojnë me përbuzje.

Epo, të nderuara motra e vëllezër, këto veprime nuk përkojnë me frymën islame dhe me rrugën e Pejgamberit (a. s.).

E para, nëse fal namaz, nëse agjëron, nëse shkon në Haxh dhe mundohesh të ndjekësh Sunnetin, nuk do të thotë që puna është kryer. Ka edhe një derë ku duhet të kalojnë veprat që bëjmë - Dera e Kabullit, e pranimit të tyre nga Allahu (xh. sh.). Kështu që, sado vepra të mira



të bëjmë, asnjë (prej nesh) nuk është i sigurt për epilogun e tyre. Andaj, duhet harxhuar më shumë energji me vetveten.

E dyta, morali i mirë i myslimanit synohet përmes veprave që cituam më lart, ndërsa Muhamedi (alejhis-selam) ka thënë se vepra që do të fut më shumë besimtarë në Xhenet është morali. Kështu që, nëse namazi yt, agjërimi yt, mjekra

jote nuk të bëjnë më të dashur në shoqërinë tënde, nuk të bëjnë më të dashur me njerëzit që të rrethojnë, atëherë diçka duhet të ketë shkuar keq.

Në një rast të këtillë duhet korrigjuar vetja. Vepra të pranuar tek Allahu (xh. sh.) janë ato që bëhen me sinqeritet, për Allah, jo ato për t'iu dukur te të tjerët. (Zvicër, 29.05.2022)

REISI PRITI HAXHINJTË NË AEROPORTIN E SHKUPIT



BFI-në pritje të grupit të parë të haxhinjve: të lumtur e të gëzuar, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu më 21.07.2022 në faqen e vet në Facebook, teksa në orët e vona të natës kishte dalë me delegacionin nga Rijaseti në Aeroportin e Shkupit për të pritur grupin e parë të haxhinjve nga Meka dhe Medina (Arabia Saudite).

Kryetari i BFI të RMV ishte i pari që u dëshiroi mirëseardhje haxhinjve, të cilët kanë udhëtuar në organizim të Bashkësisë Fetare Islame të RMV drejt vendeve të shenjta, në Haxh. Ata po kthehen, shyqyr Zotit, shëndoshë e mirë

në vendlindje, thuhet në njoftimin e BFI.

Lot, gëzim dhe buzëqeshje nga familjarët e shumtë që kishin dalë në pritje në Aeroportin e Shkupit. Haxhinjtë e BFI të RMV kanë udhëtuar, në vajtje-ardhje, në mënyrë të organizuar, grupe-grupe, me pesë aeroplanë. Grupet tjera pritet të kthehen në vendlindje ditëve në vijim, thuhet në njoftimin e BFI.

Bashkësia Fetare Islame e RMV në platformat e saj elektronike transmetoi drejtpërdrejt, në kohë reale, kthimin e grupit të parë të haxhinjve, i cili u prit nga Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.

Më 20.07.2022 BFI kishte njoftuar se aeroplani i parë pritet të aterojë në Aeroportin e Shkupit në ora 23:00 dhe se në pritje të haxhinjve do të jetë i pranishëm vetë Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me myftinjtë dhe anëtarët tjerë të Rijasetit.

Haxhinjtë fillimisht kanë vizituar Mekën, ku kanë kryer Haxhin, ndërsa më pas kanë vazhduar qëndrimin dhe vizitat në qytetin e Medinës.

BFI e RMV uron të gjithë haxhinjtë, me lutje tek Allahu Fuqiptotë për Haxh e ibadete të pranura, thuhet në njoftimin e BFI të kësaj date.

PAS XHUMASË MBËRRIN GRUPI I DYTË I HAXHINJVE

Më 22 korrik, 2022, pasdite, arriti në vendlindje edhe grupi i dytë i haxhinjve. Në rrugë për pritjen e grupit të dytë të haxhinjve, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me delegacionin, u ndal në xhaminë e fshatit Qojli, afër Aeroportit të Shkupit, për të falur namazin e xhumasë. Reis'ul-Ulemaja falënderoi Imamin Ilhan ef. Emini dhe xhematin e kësaj xhamie për pritjen, thuhet në njoftimin e BFI.

Të gjithë haxhinjtë e grupit të dytë, kryesisht nga qyteti i Tetovës dhe Gostivarit, mbërritën shëndoshë e mirë dhe në pritje të tyre kishin dalë shumë familjarë, të cilët i pritën me lot gëzimi dhe buzëqeshje. Ata u pritën nga Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i cili ishte i pari që iu dëshiroi mirëseardhje në vendlindje haxhinjve nga vendet e shenjta.



Haxhinjtë e BFI të RMV udhëtojnë në mënyrë të organizuar, grupe-grupe, me pesë aeroplanë. Grupet tjera pritet të kthehen në vendlindje ditëve në vijim, thuhet në njoftimin e BFI.

“BFI-grupi i dytë: pritje për mirëseardhje haxhinjve, Myftinia Tetovë”, ka

shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook, shoqëruar me një tufë fotografish.

Edhe mbërritja e grupit të dytë të haxhinjve u transmetua drejtpërdrejt, në kohë reale, në platformat elektronike të BFI-së.

VIJNË HAXHINJTË E SHKUPIT



Më 22 korrik, 2022, në orët e vona, në Aeroportin e Shkupit arriti edhe grupi i tretë i haxhinjve-njëkohësisht grupi i parë i tyre nga Myftinia e Shkupit, thuhet në njoftimin e BFI.

I pari që u dëshiroi mirëseardhje ishte Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, bashkë me Myftiun e Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, të shoqëruar dhe nga delegacioni i pritjes i Rijasetit të BFI.

Të gjithë haxhinjtë e grupit të tretë u kthyen shëndoshë e mirë dhe në pritjen e tyre kishin dalë qindra familjarë e të njohur, thuhet në njoftimin e BFI.

BFI në platformat e saj elektronike bëri transmetim të drejtpërdrejtë, në kohë reale, nga Aeroporti i Shkupit. Reis'ul-Ulema Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook kishte shkruar: "BFI: grupi i tretë, pritja e haxhinjve - Myftinia e Shkupit".

Më parë, gjatë ditës, nga BFI u dha

kjo informatë: "Siç njofton Myftiu i Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, koordinorët e haxhinjve të Shkupit kanë informuar se të gjithë haxhinjtë nga qyteti i Shkupit dhe rrethina janë shëndoshë e mirë dhe se aeroplani tanimë është nisur nga qyteti i Medinës për në Aeroportin ndërkombëtar të Shkupit. I lutemi Allahut Fuqiplotë që udhëtimi të shkojë mbarë e të na kthehen shëndoshë e mirë!"

KTHEHET GRUPI I PARË I HAXHINJVE TË KOSOVËS

Në aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari" në Prishtinë, 285 haxhinj nga Prishtina, Podujeva, Fushë-Kosova, Obiliqi, Lipjani, Drenasi, Gjilani dhe Istogu, nga grupi i parë, kanë arritur në Kosovë më 19 korrik, 2022, thuhet në njoftimin e BIK.

Në pritje të tyre, përveç numrit të madh të familjarëve, kishte dalë edhe Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili uroi haxhinjtë për kryerjen e Haxhit, duke lutur Zotin që t'ua ketë pranuar këtë ibadet.

Bashkësia Islame e Kosovës njofton se edhe grupet tjera të haxhinjve pritet që të arrijnë në Kosovë sipas orareve të parapara. Këtë vit nga Kosova Haxhin e kanë kryer 741 haxhinj, thuhet në njoftimin e BIK.



"MELAQET MBI QABE..."


Nga Imam Muhamed B. Sytari

Ka disa ditë që më pyesin rreth disa "fenomeneve", si: "melaqet e shfaqura" mbi Qabën e Madhnueshme në disa postime që kanë mbushur rrjetet sociale, mbi emrin e Allahut (xh. sh.) në ca lëvizhje pemësh e barqe peshqish dhe gjëra të ngjashme, që i gjen krejt kollaj aty-këtu në postime të mahniturish.

Ju them përherë: mos lejoni të tallen me intelektin dhe besimin tuaj me primitivizma të tilla, që ju mpijnë mendjen dhe ju robërojnë zemrën!

Jo thjesht sipërfaqja e Qabesë, por shtëpia ku ti banon, puna ku ti fiton hallallin, vendi ku je tubuar me shoqërinë tënde, me të cilët uletsh dhe ngrihesh si mysliman, hapat që hedh kudo që shkel, teksa gjuha jote madhëron Mëshirëbërësin, vështrimet plot bekim ndaj familjes tënde, përlësia ndaj prindërve, mëshira ndaj jetimit, loja me fëmijët tu, përkushtimi ndaj punës që ke amanet, sakrificat e madhe për të kërkuar dijen; duke vrapsuar pas mexhliseve të dijes, duke shpenzuar për një libër plot dobi, duke u konsultuar rreth një ajeti a një meseleje shkencore në dobi të njerëzimit, shpenzimi për pasurinë e librotekës personale e të ngjashme - krejt këto veprime janë të rrethuara nga mëshira dhe bekimet e Allahut në jetën tënde!

Prandaj, mos të bëhemi folkloristë e sipërfaqësorë në marrëdhëniet tona me besimin dhe bukuritë e tij! Ne nuk kemi nevojë të na shfaqen "melaqet" mbi Qabe, për ta kuptuar e vlerësuar madhështinë e



një kibleje, që bashkon krejt myslimanët e botës për të dëshmuar bashkërisht se myslimanët janë forcë ndërtuese në këtë botë; forcë, pa të cilën kjo botë shkon dita-ditës drejt greminave të ateizmit dhe mjerimit që i ka sjellë dhe vazhdon t'i sjellë ai botës, ekstremizmit fetar, abuzimit me logjikën dhe mendjen e njeriut në emër të "fesës" së abuzuar mjerisht, shthurjes në emër të lirisë personale, prishjes së familjes dhe degjenerimit në emër të barazisë gjinore etj.; forcë e cila ka ardhur koha të riaktivizohet, pas një shekulli hutimi dhe devijimi nga udha e së vërtetës, me të cilën u dërgua Hz. Muhamedi (a. s.); forcë bekuese, për të dëshmuar toka shërimin e njeriut dhe kthimin e tij në origjinën e së mirës, pa të cilën kjo tokë do të ishte tharë si lulja pa ujë!

Ne nuk kemi nevojë për peshq me emrin e Madhëruar mbi kurriz, as për fruta me forma harfesh, a re lëvizëse me detaje mistike, për të parë në pasqyrë besimin tonë! Besimi dhe bindja në Allah, i tejkalon këto detaje, para të cilave një shumicë e konsiderueshme kanë rënë në grackën e "idhujtarisë materiale" në emër të Besimit!

Më kujtohet një i moshuar, frekuentues i një prej xhamive të shumta, që kam vizituar gjatë viteve të shërbimit, i cili më tregoi një ditë një gur me ca plasaritje pa asnjë kuptim. Më tha: "E sheh emri i kujt është shkruar mbi të?" I habitur, ia ktheva: Nuk e kuptoj gjuhën, me të cilën është shkruar!

Zgjohuni dhe ejani në vete, o njerëz!

(Autori është Myfti i Zonës Shkodër, KMSH)

PEJGAMBERI YNË

Ulej në tokë, rregullonte mbathjet, qepte rrobat e veta, përkujdesej për kafshët që kishte, e milte delen, ndonjëherë nata e zinte pa ushqim; i vdiq babai, pastaj nëna, pastaj gjyshi, pastaj gruaja e dashur e zemrës, pastaj fëmijët; e dëbuan nga vendi i vet, çdo ditë

mundoheshin ta mbytnin e ta zhduknin nga faqja e dheut; e përgjakën, e torturuan - megjithatë, buzëqeshja asnjëherë nuk i mungoi në fytyrë, mirësia dhe bujaria në zemër; madhështia e tij qëndronte në modestinë që kishte; e falënderonte Zotin e tij, aq sa këmbët i

ënjtëshin dhe thoshte: "Nëse Zoti im është i kënaqur me mua, nuk kam dert tjetër." Ky ishte Pejgamberi ynë, Muhamedi (a. s.).

(Përgatiti: dr. Rijad Imeri/ në bashkëpunim)

PËRKRAHJE VLERAVE DHE RRJEDHAVE EVROPIANE

Më 14 korrik, 2022, Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në mbledhjen e Kuvendit të RMV, i ftuar nga Kryetari Talat Xhaferi, thuhet në njoftimin e BFI.

Ai ndoqi ekspozenë e Kryetares së Komisionit Evropian, znj. Ursula von der Leyen, e cila foli për Propozimin francez, që i hap rrugën RMV drejt BE. Në mbledhje ishin të pranishëm personalitetet më eminente të jetës politike, diplomatike, kulturore e fetare.

Me kujdesin më të madh u përcoll ekspozēja, ku znj. Leyen edhe një herë shpjegoi në mënyrë të argumentuar të gjitha dilemat rreth planit të reviduar francez për fillimin e bisedimeve me Bashkimin Evropian. Sipas Reis'ul-Ulemasë, kjo është një përkrahje e fuqishme për vendin tonë drejt vlerave dhe rrjedhave evropiane, thuhet në njoftimin e BFI.

Paraqitjen e Kryetares së Komisionit



Evropian, znj. Ursula von der Leyen, në Kuvend e kuptova si një përkrahje të fuqishme për vendin tonë drejt rrjedhave dhe vlerave evropiane, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook të njëjtën ditë.

NË CEREMONINË PËR BE



Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, mori pjesë në ceremoninë e organizuar nga Kryeministri i vendit, z. Dimitar Koveçevski, për nder të fillimit të negociatave me Bashkimin Evropian, thuhet në njoftimin e BFI.

Ceremonia u organizua më 20 korrik,

2022, në Klubin e Deputetëve në Shkup.

Në këtë ngjarje, Reis'ul-Ulemaja u takua me figurat eminente të Shtetit, të cilët i uroi dhe u dëshiroi suksese në këtë rrugëtim shumë të rëndësishëm për të ardhmen e vendit tonë, thuhet në njoftimin e BFI.

Të njëjtën ditë, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook kishte shkruar: "Në Klubin e Deputetëve, me rastin e manifestimit të fillimit të negociatave me BE" dhe kishte ngjitur më shumë fotografi nga manifestimi.

NJË VENDIM HISTORIK

Nga Shaqir ef. Fetahu

VENDIMI I KUVENDIT të RMV (dt. 16.07.2022) - historik. Urime të përzemërta!

Vendimi i Kuvendit vërtetoi rrugën drejt BE-së, si vullnet i shoqërisë sonë. Një vendim historik, që paraqet rrugën e zhvillimit, të përparimit, të paqes e të tolerancës.

Uroj vetëdije të lartë dhe angazhim të paluhatshëm në procesin e këtij rrugëtimi.

Na priftë e mbara.

MIRË SE VINI BASHKATDHE-TARË TË NDERUAR: Me të madhe dhe me gëzim të madh po na vijnë bashkatdhetarët tanë nga të gjitha vendet e Evropës.

Në fytyrat e tyre shihet malli për atdhe.

Andaj, le të përjetojnë ditë të këndshme në vendlindjen e tyre, të lumtur, duke shijuar trojet, të cilat ua do zemra më tepër se gjithçka në botë.

T'u japim hapësirë dhe ambient të bukur; ata e meritojnë këtë, sepse gjithmonë, kur e do nevoja, janë në shërbim të çështjeve madhore të fesë dhe të kombit.



Të gjithë ne, kudo që jemi, le t'u shërbëjmë dhe le të jemi në ndihmë të tyre. Zoti i bekoftë.

TË JESH I LUMTUR, do të thotë të bësh me nder dhe me sinqeritet punën që të është besuar.

Vepra e zbkuron njeriun dhe i jep dimensionin që e lidh tokën me qiellin, që e lidh veprën me Zotin.

Këtë lidhje forcoje me angazhim dhe pastaj jepu dritë, me këtë, atyre që i ka godit zilia e egoizmi, shpifja e sharja, punët e këqija, që t'i nxjerrësh nga ngushtimi i rëndë i shpirtit dhe i zemrës, ani pse dikur i ke ushqyer, i ke rritur, i ke profesionalizuar...

Ani, ti mos urrej. /17.07.2022/

(Autori është Reis'ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut)

URIME DITËLINDJEN, AMERIKË!

Bashkësia Fetare Islame e RMV, me në krye Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, të gjitha organet dhe institucionet e veta, uron popullin amerikan dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës me rastin e Ditës së Pavarësisë së Amerikës - 4 Korrikut, thuhet në njoftimin e BFI.

Pikërisht në këtë ditë, në vitin 1776 Presidenti Tomas Xheferson përpiloi Deklaratën e Pavarësisë, dokumentin me të cilin lindi pavarësia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i garantoi lirinë dhe demokracinë popullit amerikan.

Kjo demokraci sot rrezaton më fuqishëm se kurrë, duke u shndërruar në një fanar udhërrëfyes dhe mburojë e vlerave humane në botë, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir

ef. Fetahu, më 6.07.2022, në Ambasadën e SHBA-ve në Shkup, në shoqërim të z. Mustafa ef. Dauti dhe të z. Agron Vojnika, mori pjesë në manifestimin e Ditës së Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë ceremoni Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu personalisht uroi Ambasadorën Kate Marie Byrnes me rastin e 246-vjetorit të Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pas këndimit të himnit të Maqedonisë së Veriut dhe të SHBA-ve, Ambasadorja Kate Marie Byrnes mbajti një fjalim mjaft shprehëdhënës, frymëzues dhe inspirues për vendin tonë dhe për qytetarët tanë, në të cilin bëri një rezymë për arritjet e vendit në rrugëtimin euro-atlantik, thuhet në njoftimin e BFI.



MENDËSIA REGRESIVE E “GISHTIT TË URREJTJES”

Skenat që u reprizuan kohëve të fundit në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, nga disa eksponentë ultranacionalistë, të djathtë e të majtë, në fakt, janë vazhdimësi e asaj mendësie naziste të trajtimit të shqiptarëve si qytetarë të rendit të dytë, të cilët nuk duhet të gjenden në çdo segment të jetës politike dhe sociale në vend, në RMV.

Nga Bashkim Aliu

Debat i fundit për “propozimin francez” në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, i cili do të duhej të përfundojë me një “po”, për të hapur rrugë për fillimin e bisedimeve për integrimin e Maqedonisë së Veriut në BE, shpalosi për të satën herë me radhë mbetjet toksike të mendësisë totalitare dhe filozofisë së urrejtjes ndaj tjetrit, më saktë thënë: ndaj popullit autokton të Ballkanit-shqiptarëve, që kësaj radhe më zhurmshëm dhe më qartë plasohet nga lideri flokëlëshuar i partisë “Levica” Dimitar Apasiev.

Në fakt, Apasiev është vetëm një nga të shumtët që mendojnë dhe besojnë si ai në këtë shoqëri me mbetje toksike, me rrezik të lartë që nga pushteti monist, se

shqiptarët “e ndershëm” dhe “të mirë” ishin “ëmbëltoreshinjtë”, “byrekshinjtë”, “bozaxhinjtë” dhe “akulloreshinjtë” nëpër rivierat kroate dhe qytetet tjera të ish-Jugosllavisë komuniste, por jo edhe ata që kërkonin universitet, të drejta të shkollimit në gjuhën amtare, alokim të drejtë të mjeteve të buxhetit dhe zhvillim të barabartë rajonal.

Normalisht, të gjithë ata që kanë punuar në veprimtari të ndryshme me nder dhe hallall, meritojnë respekt, dhe me këtë nuk e kemi për qëllim që ta nënçmojmë punën e dikujt, ngase shumë prej tyre me atë që kanë fituar u kanë ndihmuar edhe lëvizjeve kombëtare shqiptare në hapësirat e ish-Jugosllavisë komuniste për ta demaskuar dhunën e pushtetit sllavo-komunist që shiste kuazi bashkim-vëllazërim, por me këtë deshëm ta rik-

thejmë në memorien e shqiptarëve të Ballkanit atë se skenat që u reprizuan kohëve të fundit në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, nga disa eksponentë ultranacionalistë sllavë, të djathtë e të majtë, në fakt, janë vazhdimësi e asaj mendësie naziste të trajtimit të shqiptarëve si qytetarë të rendit të dytë, të cilët nuk duhet të gjenden në çdo segment të jetës politike dhe sociale në vend.

LARGIMI I VETOS SË BULLGARISË

Me fjalë të tjera, segmente të caktuar, si Ministria e Punëve të Jashtme, e Punëve të Brendshme, e Financave, Banka Popullore etj., janë të rezervuara për qytetarët e “rendit të parë”, përkatësisht sllavët, ndërkaq për këta të “rendit të

dytë”, pra shqiptarët, janë të rezervuara veprimtari të hotelierike dhe disa pozita të skalionit të dytë. Nga këtu buron edhe gjithë ai mllef, i cili hidhet edhe mbi ministrin shqiptar të Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, i cili është duke u piketuar si fajtori kryesor për gjoja shitjen e identitetit nacional të bashkësisë etnike maqedonase, si dhe të gjuhës dhe të kulturës së saj, pikërisht për shkak të qëndrimit pozitiv ndaj “propozimit francez” që mundëson largimin e vetos së Bullgarisë për fillimin e bisedimeve të Maqedonisë së Veriut me BE-në.

Në këtë kontekst, gjuha e urrejtjes dhe qëndrimi nazist ndaj ministrit shqiptar u përshkallëzua nga gjyqi publik që ministrit shqiptar, kryeministrit dhe zv/kryeministrit për çështje evropiane ua bëri Unioni i të Rinjve i partisë VMRO-DPMNE, të cilët i “shpallën fajtorë” për tradhti ndaj shtetit dhe çdo njërin prej tyre e dënuan me 101 vjet burg (!).

Gjuha e urrejtjes ndaj shqiptarëve përmes sharjes së ministrit shqiptar të Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut vazhdon edhe nga shumë analistë dhe oratorë në programe të ndryshme debative, të cilët, bile, edhe nuk ia zënë emrin Bujar Osmani, por në mënyrë fyese e quajnë “Bugar Osmani”, duke aluduar te bullgarët.

Kjo është gjuhë tipike e urrejtjes, e cila për fat të keq demonstron ende në këtë shekull në një shtet multi-etnik si Maqedonia e Veriut. Bile, lideri i partisë ekstreme majtiste “Levica” vazhdon në stilin e Fidel Kastros dhe të Hugo Çavezit: kohë më parë, me gisht t’u drejtohet deputetëve dhe kryetarit shqiptar të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, me çka tregon se ende nuk është ndarë nga mendësia e regjimit totalitar, e ngulitur thellë në një masë të këtyllë toksike të diskriminimit në baza nacionale dhe të racizmit.

Gishti i tij dhe narrativa fashiste që përdoret nga opozita maqedonase në “tempullin e demokracisë”, siç e quajnë parlamentin, edhe pse i piketon personat, në fakt, i tejkalon ata, për t’iu drejtuar të gjithë shqiptarëve dhe për t’ua bërë me dije se ata nuk kanë të drejtë të vendosin në këtë shtet.

Zaten, nëse ndiqen debatet që zhvillohen nëpër media të ndryshme të Maqedonisë së Veriut, do të shihet se me çdo kusht tentohet të përjashtohen shqiptarët nga vendimmarrja në këtë vend - në këtë rast, nga votimi për “propozimin francez” në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut, me pretekst se kjo çështje i tangon interesat nacionale maqedonase dhe shqiptarët nuk kanë të drejtë ta rëndojnë



ndonjëherë palë me votat e tyre, me çka i dëmtojnë interesat nacionale, identitetin dhe gjuhën maqedonase.

Mirëpo, oratorët dhe analistët maqedonas duhet ta kenë të qartë se shqiptarët janë banorë autoktonë të këtyre trojeve, pa marrë parasysh si janë ndarë kufijtë e shteteve pa vullnetin e tyre dhe, si të tillë, askush nuk do të mund t’i privojë nga vendimmarrja në këtë shtet. Ka kaluar koha kur ata janë lënë jashtë proceseve dhe janë përjashtuar nga institucionet, kur ata nuk kanë mundur të jenë ministra të Punëve të Jashtme e të Brendshme, kryetar Parlamenti dhe ministër të Financave; ata sot janë faktorë kryesorë, të cilët e ndërtojnë dhe vendosin për të ardhmen e vendit.

Po ashtu, “propozimi francez”, edhe pse e ka fokus problemin e ngritur nga Bullgaria në lidhje me çështje identitare të maqedonasve etnikë dhe gjuhën e tyre, megjithatë quhet ‘propozim për zgjidhjen e kontestit ndërmjet Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut’ dhe jo ‘mes bullgarëve dhe maqedonasve etnikë’. Kjo do të thotë se në këtë shtet nuk jetojnë vetëm maqedonasit etnikë, por jetojnë edhe bashkësi të tjera etnike – bile, bashkësi etnike autoktone, si shqiptarët. Për këtë, është naive dhe tepër primitive të mendohet se shqiptarët do të mund të përjashtohen nga vendimmarrja për të ardhmen e vendit.

Nga ana tjetër, vetë opinioni maqedonas është i ndarë në lidhje me këtë propozim, ashtu që nuk ka konsensus brenda bashkësisë etnike maqedonase se ky propozim dëmton seriozisht identitetin dhe interesat etnike maqedonase. Refuzimi i këtij propozimi është përcaktim i një pjese të bashkësisë etnike maqedonase dhe, për rrjedhojë, qëndrimi i shqiptarëve për këtë propozim nuk dëmton asgjë në

raport me identitetin dhe gjuhën maqedonase, por e gjithë ajo që mund të thuhet është se nuk përputhet me pikëpamjet dhe agjendën e opozitës maqedonase, në veçanti: të forcave ultranacionaliste maqedonase, të cilat e kanë kokën kah “Bashkimi Sovjetik”.

ME GJUHËN E URREJTJES DUHET TË MERRET PROKURORIA PUBLIKE

Nisur nga kjo, gishti i Apasievit, drejtuar deputetëve dhe kryetarit shqiptar të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, si dhe gjuha e urrejtjes kundër ministrit shqiptar të Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, janë naziste, regresive dhe nxitëse të urrejtjes ndërnacionale, që realisht do të duhej të ishin lëndë për Prokurorinë Publike të shtetit.

Në shkencat e komunikimit gjuha e urrejtjes, gjuha fyese, denigruese, linçuese dhe ikja nga debati konstruktiv përmes djegies dhe grisjes së dokumenteve në Parlament, si dhe fishkëllimave ndaj deputetëve që e përmbajnë “propozimin francez”, quhet ndotje akustike e ambientit, ndërkaq politikisht i dëmton vetë protagonistët e këtyre veprimeve dhe e shpalos agjendën e tyre të vërtetë.

Henri Bergson ka argumentuar se njeriu i duket sikur çdoherë flet fjalë të mençura dhe të domosdoshme, por, sipas tij, nëntëdhjetë për qind e tyre nuk janë veçse teprime linguistike, fonema të zhurmshme; me një fjalë: gjëra të kota, të cilat, si të thuhet, si mos të thuhet, nuk ngrënë ndonjë peshë në fatet e njerëzve dhe të shoqërisë. Kjo analizë e tij, edhe pse e bërë në vitet tridhjetë të shekullit të njëzetë, vlen sot për “Levicën” dhe të tjerët si ata në këtë debat me nuanca të qarta naziste në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut. (16.07.2022)



REISI URON FESTËN KOMBËTARE FRANCEZE



Më 14 korrik, 2022, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, vizitoi Ambasaden e Francës në Shkup, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI u takua me Ambasado-

rin e Francës në RMV, z. Cyril Bomgartner, me rastin e Ditës Nacionale të Francës, 14 Korrikut (14 Juillet). Në pritjen e organizuar, Reis'ul-Ulemaja i uroi Ambasadorit Bomgartner, dhe përmes tij tërë

popullit francez, Festën Kombëtare.

Në pritje, Kryetari i BFI u shoqërua nga Drejtori për Marrëdhënie me BE, mr. Mustafa Dauti, thuhet në njoftimin e BFI. (15.07.2022)

AMBASADORI I SPANJËS NË BFI

Më 13.07.2022 Kryetari i BFI të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, priti Ambasadorin e Spanjës në Shkup, Shkëlqesinë e Tij z. José Luis Lozano García, thuhet në njoftimin e BFI.

Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja i shprehu mirëseardhje, duke e falënderuar për vizitën, të cilën, tha, e kuptojmë si respekt ndaj Institucionit dhe besimtarëve në përgjithësi, si dhe përkrahje angazhimeve të BFI në kohë dhe në vend, duke

i shpjeguar Ambasadorit për BFI dhe rolin e saj në shpjegimin e Islamit, dialogun ndërfaqësor, formimin e ambientit paqësor në këtë shoqëri multinationale dhe multikonfesionale, përpjekjet e RMV për caktimin e datës për bisedime për hyrje në BE, për maturinë, mençurinë dhe tolerancën që duhet kultivuar që janë vlera për fillimin e negociatave me BE dhe rrjedhat euroatlantike dhe shumë çështje të tjera.

Edhe Ambasadori shprehu falënderimet e tij për pritjen dhe konceptin e shëndoshë të BFI për rrjedhat e kohës në sfera të ndryshme. Njëherësh, shprehu gatishmëri për bashkëpunim të ndërsjellë aty ku e shihet nevoja.

Në këtë pritje të Ambasadorit spanjoll Kryetarit e BFI e shoqëruan Drejtori për Marrëdhënie me BE mr. Mustafa Dauti dhe Shefi i Kabinetit dr. Abdulkerim Iseni, thuhet në njoftimin e BFI.



AMBASADORI I OSBE VIZITOI BFI-në

Më 27.06.2022 BFI të RMV e vizitoi Ambasadori i OSBE, z. Klemens Koja, të cilin e priti Kryetari i BFI, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga z. Mustafa Dauti, drejtor për çështje me botën e jashtme dhe dr. Abdulkerim Iseni, shef i Kabinetit të Reis'ul-Ulemasë, thuhet në njoftimin e BFI.

Kryetari i BFI i dëshiroi mirëseardhje në mesin tonë mysafirrit nga OSBE. U bisedua për shumë çështje që kanë të bëjnë me rrjedhat e kohës në sferën fetare, si dhe më gjerë.

BFI si gjithmonë mundohet që në mënyrë të drejtë të japë kontributin e vet në kultivimin e vlerave që e ndihmojnë ba-



shkëpunimin mes njerëzve dhe popujve në përgjithësi, për të formuar një ambient

të këndshëm për secilin, thuhet në njoftimin e BFI.



GJENOCIDI I SREBRENICËS, TRISHTIM PËR BOTËN

Sot mbushen plot 27 vjet nga ngjarja më e dhimbshme dhe më e trishtueshme e gjenocidit të Srebrenicës, ku në mënyrë të brutale dhe më të egër u masakruan mbi 8 mijë fëmijë, gra, burra pleq të pafajshëm boshnjakë nga hordhitë serbosllave, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjenocidi ndaj myslimanëve të pafajshëm dëshmoi se deri në çfarë niveli mund të bjerë njeriu nga djallëzia e tij. Aktet e këtilla kurrë s'duhet harruar dhe duhet të jenë një shembull se angazhimi për t'u mbrojtur jeta e njeriut është vepra më e shenjtë dhe më e shtrenjtë dhe se kultivimi i respektit, paqes dhe tolerancës, janë vlerat më madhore të jetës së njeriut, të kombeve dhe të botës në përgjithësi.

Përkrahja për familjet që humbën anëtarët e tyre në këtë gjenocid është e paalternativë dhe kurrë mos ndodhshin të këtilla akte të trishtueshme. Populli boshnjak mbetet ta përkujtojë këtë, duke vazhduar zhvillimin e tij në të gjitha sferat për të dhënë kontributin e tij dhe të vazhdojë të jetë faktor i paqes dhe inkudrimit të tij në rrjedhat e kombeve të

ngritura dhe liridashëse.

BFI e RMV plotësisht solidarizohet me kombin boshnjak në këtë dhimbje të madhe dhe do të jetë në shërbim të ngrit-

jes së tij në çdo sferë të jetës së tij në vendin tonë. Zoti e bekoftë popullin boshnjak, thuhet në njoftimin e BFI. (11.07.2022)



Marsh i paqes në kujtim të viktimave të Srebrenicës në Shkup, organizuar nga partitë boshnjake dhe shoqatat joqeveritare boshnjake në Maqedoni të Veriut. Në emër të Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu prezent ishte Shefi i Kabinetit, dr. Abdulkerim ef. Iseni, thuhet në njoftimin e BFI. (12.07.2022)

KUSH, DHE NGA KUSH, U MASAKRUA NË SREBRENICË DHE NË REÇAK?

Ata që u vranë në Srebrenicë ishin boshnjakë, dhe u vranë pse ishin të tillë, dhe jo pse ishin njerëz. Ata që u vranë në Reçak ishin shqiptarë, dhe u vranë pse ishin të tillë, dhe jo pse ishin njerëz. Ata u vranë nga serbët, dhe vrasësit, kur ia kanë mësyre Bosnjës, Kosovës, janë bekuar nga kreu i Kishës ortodokse serbe.

**Shkruan: Bashkim Aliu
(Enkas për HeR)**

E gjithë bota, me përjashtim të kryeministrit të Malit të Zi Dritan Abazović dhe punëdhënësit e tij të Shumadisë, e kanë të qartë si dita dhe nata se në Srebrenicë u masakruan boshnjakë myslimanë dhe në Reçak të Kosovës u masakruan shqiptarë.

Mbase këto nuk janë masakrat e vetme, të kryera nga ana e një prej makinerive gjenocidale më famëkeqe që ka njohur shekulli XX, por ato përmenden si shembulli më i theksuar i terrorit serb mbi boshnjakët dhe shqiptarët.

Çdo korrik nga Bosnja e martirizuar në zemër të Evropës së Revolucionit Francez, që ngriti sloganin “Liri e Barazi”, përcillet mesazhi i domosdoshmërisë së humanizimit të njeriut, me qëllim që mos të lejohet përsëritja e ngjarjeve të trishtta, të cilat i tejkalojnë edhe rrëfimet e tragjediave të legjendave.

Nga ky vend i bëhet thirrje njeriut që mos të hipnotizohet nga puna e dorës së vet e ta shohë njeriun si robot, të cilin e prodhoi vetë, i cili, në rast se prishet, shndërrohet në skrap, pa pasur nevojë që t'i shprehen ngushëllime, pasi nuk ka shpirt.

DEKLARATA E ABAZOVIQIT-SKANDALOZE DHE JOHUMANE

Kjo ndoshta lexuesit i duket e tepërt, ngase do të thoshte se gjërat që dihen nuk ka nevojë të shpjegohen dhe as të elabohohen, pasi nuk kemi prurje të re. Mirëpo, deklarata e kryeministrit të Malit të Zi Dritan Abazović më 11 korrik 2022, në ditën e përvjetorit të masakrës së Srebre-



nicës, na zbraps nga entuziazmi i liberalëve të qytetarisë dhe kosmopolitëve, të cilët, si duket, njerëzit kanë filluar t'i shohin si robotët, të cilët nuk kanë etni, fe e racë, por thjesht janë produkt. Kështu duket të jetë edhe deklarata skandaloze dhe, aq më tepër, johumane, e Abazovićit, sipas të cilit, në Srebrenicë janë vranë njerëz nga politika, pa mos e përmendur përkatësinë e atyre njerëzve dhe shkaku se pse u vranë.

Në Srebrenicë - e po ashtu, edhe në masakrat që u kryen në Kosovë - nuk u vranë njerëzit pse ishin njerëz, por u vranë për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe fetare. Në rastin e Srebrenicës, u vranë boshnjakë - jo pse ishin njerëz, por pse ishin boshnjakë myslimanë, ndërsa në rastin e masakrave në Kosovë - u vranë shqiptarët, jo pse ishin njerëz, por pse ishin shqiptarë.

Këta nuk u vranë nga një palë e panjohur, që të përdoret diateza pësore, por u vranë nga formacione që dihen se nga kush udhëhiqeshin, në emër të kujt luftonin dhe cilit etnitet i takonin. Në të dy rastet - si në Srebrenicë, ashtu edhe në Reçak, dhe në çdo vend tjetër ku u kryen masakra në Bosnjë dhe Kosovë - masakrat i bënë serbët lokalë dhe ata të Serbisë, bashkë me mercenarët e huaj, të mbështetur nga aparati shtetëror i Serbisë. Kjo është dokumentuar, dhe nuk mbulohet dot me deklarata skandaloze dhe infantile të tipit të atyre të Abazovićit. Në rastin e Srebrenicës, masakra ndodhi para syve të ushtarëve holandezë të forcave të OKB, të njohura si UNPROFOR, dhe kjo e implikon përgjegjësinë edhe të bashkësisë ndërkombëtare në këtë masakër të tmerrshme në zemër të Evropës, e cila sa është e trishtueshme,

po aq është edhe e turpshme për bashkësinë ndërkombëtare dhe ata që e kanë gojën plot demokraci, liberalizëm, antiekstremizëm, antiterrorizëm dhe luftë për të drejtat e njeriut.

ARGATËT E SERBISË

Të vërtetat e pamohueshme për masakrën e Srebrenicës, të Reçakut dhe të masakrave të tjera në Bosnjë e Kosovë, kurrë nuk u pranuan nga ata që ato i kryen, të cilat (masakra) mbase kanë mundur të jenë planifikuar edhe diku tjetër. Për më tepër, ata jo vetëm që i mohuan, por në mënyrë sistematike kanë punuar për t'i minimizuar dhe tjetërsuar, duke u dhënë kahe dhe konotacion tjetër, ndryshe nga e vërteta e tyre.

Serbia këtë e ka bërë vazhdimisht, jo vetëm në kohën e ish-Jugosllavisë komuniste, por edhe më herët. Në kohën e Jugosllavisë komuniste ushtronte dhunë dhe raprezalje mbi shqiptarët në Kosovë, por për ta mbuluar këtë, sajonte viktima prej serbëve, të cilët plasnin edhe prapancën e vet duke futur shishe në të, si rasti i Gjorgje Martinovićit në Gjilan, për ta trazuar Jugosllavinë dhe opinionin më të gjerë, kinse janë duke përjetuar zullum nga “nacionalistët” shqiptarë.

Me këto fabrikime, ata jo vetëm që tentonin t'i mbulojnë krimet e veta mbi shqiptarët në Kosovë, por shkonin një hap edhe më tutje - duke kaluar në sulm për mobilizimin e opinionit më të gjerë kundër shqiptarëve, duke i paraqitur faj-

torë dhe dhunues të serbëve në Kosovë.

Dhe, ja, tash, në rastin e Srebrenicës, vazhdojnë me të njëjtin strategji, apo, thënë ndryshe, me të njëjtin sherr shkajau, duke mos mjaftuar me mohimin e masakrës, por shkojnë më tutje - duke u munduar ta minimizojnë efektin e saj për serbët me deklarata se atje janë vranë njerëz, pa e përmendur përkatësinë e tyre etnike dhe fetare.

Në ditën e përkujtimit të masakrës së Srebrenicës Serbia vendosi t'i trazojë ato shpirta të lënduar të nënave të Srebrenicës me deklarata të porositura johumane, të ambalazuara me etiketa të “njerëzve kosmopolitë, liberalë dhe me koncept qytetar” të çiftit të sajësës “ideologjikisht të modifikuar” Abazović, i cili, edhe pse me përkatësi etnike shqiptare, u vu në shërbim të kauzës serbe për neutralizimin e ideologjisë fashiste të shtetit dhe të Kishës serbe, në emër të dimensionit më të gjerë human dhe njerëzor të masakrës së Srebrenicës, pa i përmendur kriminelët me emër dhe pa i përmendur viktimat se kush ishin dhe pse u vranë.

MASAKËR QË NUK MBAN MEND HISTORIA

Të shprehet në këtë mënyrë një kryeministër, më së paku mund të jetë lëshim, lapsus apo shprehje joadekuate. Kryeministri nuk është si çdo qytetar tjetër që nuk ka pozitë dhe shprehet pa teklif, pasi nuk mban përgjegjësi institucionale. Palla se - është lëshim; nuk pi ujë; dhe,

as kërkim falja nuk është bindëse. Këtu nuk flitet për breshër që e ka shkatërruar bostanin në arat e Hasës dhe të Husës, por flitet për më tepër se tetë mijë jetë njerëzish, për masakër që nuk mbahet mend në historinë e kohës më të re.

Kjo mënyrë e shprehjes është tallje me ndjenjat e lënduara tejmase të nënave të viktimave, është fyerje dhe ofendim i viktimave, është rreshtim në anën e ideologjisë fashiste të Kishës ortodokse serbe dhe të shtetit serb, të cilët i motivuan dhe i mbështetën aktorët e këtyre masakrave.

Me fjalë të tjera, kështu shprehet vetëm ai që është argat i Serbisë dhe, dorën në zemër, Abazović në shumë raste ka dhënë sinjale të fuqishme për një gjë të tillë, pavarësisht asaj se deklaratat kanë qenë të kamufluara, me ambalazh tjetër, me sfond kosmopolit, qytetar dhe liberal.

Është për të ardhur keq që kësaj radhe Vuçiçi e luajti lojën me një shqiptar “liberal e kosmopolit me koncept qytetar” dhe e përdori pikërisht një shqiptar, për t'u dhënë kahe tjetër masakruarëve që u bekuar nga kreu i Kishës ortodokse serbe.

Ata që u vranë në Srebrenicë ishin boshnjakë, dhe u vranë pse ishin të tillë, dhe jo pse ishin njerëz. Ata që u vranë në Reçak ishin shqiptarë, dhe u vranë pse ishin të tillë, dhe jo pse ishin njerëz. Ata u vranë nga serbët, dhe vrasësit, kur ia kanë mësyre Bosnjës, Kosovës, janë bekuar nga kreu i Kishës ortodokse serbe. (Zvicër, 12.07.2022)



TESTAMENTI I MUHAMEDIT (A. S.)

Një histori e rrallë që ngërthen, në esencë, qëllimin paqësor islam, është një testament i Muhamedit (a. s.) drejtuar murgjve të krishterë të Sinajit në vitin 626 të erës sonë.

Testamenti është në gjendje të mirë dhe ruhet në muzeun „Topkapi” në Stamboll (Turqi).

Kopjen e kanë murgjit e kishës „Shën Katerina“ të Sinajit dhe e ruajnë me kujdes, se është dokument me vlerë hyjnore islame. Aty ka dispozita ligjore që edhe sot vlejnë dhe duhet të respektohen nëse të krishterët janë në shtetin mysliman.

Nga ky dokument hyjnor mund të marrin mësim të gjitha fetë botërore.

DËSHMI: ...Sipas traditës, murgjit e krishterë të manastirit “Shën Katerina” në Sinaj nuk ngurrojnë të tregojnë të vërtetën: pejgamberi Muhamed shpesh e vizitonte manastirin dhe zhvillonte biseda me klerikët krishterë.

TË DHËNA BAZË: Ky dokument është shkruar në vitin 626, ndërsa përbëhet nga disa dispozita rreth termave që lidhen me jetën e të krishterëve nën udhëheqjen islame dhe mban vulën e njohur të Pejgamberit (a. s.).

Sulltan Selimi i Parë letrën origjinale e dërgoi në Stamboll në vitin 1517, ku edhe sot ruhet në muzeun “Topkapi”, kurse me kërkesë të murgjve është bërë edhe kopja e saj dhe është vendosur në manastir.

PËRMBAJTJA E LETRËS:

“Kjo është nga pejgamberi Muhamed, Ibn Abdullah, si

(Për botim: marrë nga z. Feti Hani, Bursa, Turqi, 2 korrik, 2022)

TESTAMENT

për ata që janë të krishterë: qoftë në afërsi ose largësi.

-Ne fuqishëm qëndrojmë pranë tyre. Me të vërtetë: unë, shërbëtorët, ndihmësit dhe pasuesit e mi, do t'i mbrojmë, sepse të krishterët janë qytetarët e mi dhe, pasha Allahun, do t'i kundërvihem çdo gjëje që ua prish rehatinë;

-Kundrejt tyre nuk guxon të ushtrohet dhunë;

-Gjykatësit e tyre nuk guxon të përjashtohen prej pune. As murgjit s'guxon të dëbohen prej manastireve të tyre;

-Askush nuk guxon t'i rrenojë shtëpitë e fesë së tyre (kishat), e as t'i dëmtojë ato, ose të marrë (grabis diçka) prej tyre e të dërgojë në shtëpi të myslimanit.

-Po që se dikush merr ndonjë gjë prej tyre, atëherë ai konsiderohet se e ka shkelur TESTAMENTIN e Zotit dhe ka treguar padëgjueshmëri ndaj pejgamberit të Tij. Vërtet, ata janë aleatët e mi dhe kanë mbrojtjen time kundër asaj që urrejnë;

-Askush nuk guxon që t'ua imponojë udhëtimin ose shkuarjen në luftë;

-Myslimanët duhet të luftojnë për ta;

-Nëse myslimani dëshiron ta marrë për grua një të krishterë, martesë nuk guxon të ndodhë pa pëlqimin e të krishterës, e as e krishtera s'guxon të pengohet nga burri mysliman që të mos e vizitojë kishën për t'u lutur.

-Kishat e tyre patjetër duhet të respektohen;

-Rindërtimet e tyre s'guxon të pengohen e as të ndalohen;

-Gjërat e shenjta të shkrimeve të tyre të ruhen me kujdes!

Detyrim:

-Askush prej myslimanëve nuk guxon të tregojë padëgjueshmëri ndaj këtij TESTAMENTI gjer në Ditën e Kiametit.”



RUAJUNI NGA FASIKU

Pleqtë më parë thoshin: “Ruajuni prej atij personi që paratit si melaqe në publik, ndërsa në brendi është fasik.”

Në këtë kontekst kemi fjalën e Allahut (xh. sh.), ku thuhet: “A po i urdhëroni njerëzit për punë të mira, e veten tuaj po e harroni? Ndërsa ju e lexoni librin (Tevratin). A nuk po mendoni?” (Bekare: 44)

Ndërkaq, për besimtarët thuhet:

”O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni!” (Saff: 2-3)

(Përgatiti: Imer Jusufi)

VLERA E DHJETË DITËVE TË MUAJIT DHULHIXHE

Shkruan: Jusuf Zimeri

HYRJE

Është fakt i pakontestuar se koha sipas argumenteve dhe parimeve autentike islame është sendi më i shtrenjtë për njeriun, e që nuk mund ta blejë me asgjë. Njeriu në përgjithësi, e besimtari islam në veçanti, është i obliguar që me veprimtarinë e tij konstruktive të përditshme të shfrytëzojë kohën në maksimum. Mirëpo, dëshira e Allahut fuqplotë ishte që disa kohë të kenë vlera më të mëdha në aspektin e vlefshmërisë së veprimtarisë, andaj besimtari islam këto kohë duhet t'i shfrytëzojë për përfitime jo vetëm individuale, por edhe shoqërore. Në mesin e kohëve të dalluara për veprimtari dhe adhurime të veçanta janë edhe dhjetë ditët e muajit Dhulhixhe, që

kryesisht kanë të bëjnë me kushtin e pestë islam, Haxhin.

VLERA E MUAJIT DHULHIXHE

Muaji Dhulhixhe është muaji i dymbëdhjetë sipas kalendarit islam. Dhjetë ditët e para të muajit Dhulhixhe përveç që ndërlidhen me kryerjen e kushtit të pestë islam, Haxhit, shtohen edhe disa aktivitete të tjera islame, siç është agjërimi i ditës së Arefatit për ata që nuk janë në Haxh, e që është dita e nëntë e muajit Dhulhixhe, dita e Kurban-Bajramit, në të cilën myslimanët që kanë mundësi sakrifikojnë me therjen e kurbaneve, përmes të cilave solidarizohen me skamnorët, shtohen tekbirot (të quajtura tekbirot eteshrik) pas çdo namazi farz, duke filluar nga dita e nëntë, apo më mirë thënë nga

dita e Arefatit dhe përfundojnë në ditën e katërt të Kurban-Bajramit me namazin e iqindisë dhe një sërë aktivitete të tjera të besimtarëve islamë.

Nëse hulumtojmë në Kurandin fisnik për vlerën e këtij muaji, vërejmë se Allahu fuqplotë betohet në dhjetëshin e parë të muajit Dhulhixhe, e kjo e ngre vlerën e këtij muaji, sepse Allahu fuqplotë nuk betohet në sende që nuk kanë vlerë. Allahu (xh. sh.) thotë: “Pasha agjimin dhe pasha dhjetë netët.” (El-Fexhr: 1-2)

Imam Taberiu në tefsirin e tij shpjegon se betimi i Allahut në ajetin “pasha dhjetë netët” ka për qëllim dhjetë netët e para të muajit Dhulhixhe dhe këtë e vërteton edhe konsensusi i dijetarëve islamë. Këtë e vërteton edhe Ibni Kethiri në tefsirin e tij, ku thotë se me këtë betim për-



fshihen dhjetë netët e para të muajit Dhulhixhe, ndërsa pastaj transmeton edhe mendimin e shumë komentuesve, siç janë Ibni Abasi, Ibni Zubejri, Muxhahidi dhe shumë të tjerë.

Në një hadith me transmetim nga Xhabiri (r. a.) thuhet: “Dhjetëshi i përmendur, është dhjetë ditëshi i Dhulhixhes, kurse shprehja ‘vitri-tek’ në ajet ka për qëllim ditën e Arefatit, e shprehja ‘shef’i - çift’ ka për qëllim ditën e Kurban-Bajramit. (Imam Ahmedi)

Andaj, duke marrë parasysh vlerën e këtyre ditëve, Allahu (xh. sh.) këto ditë i quan ditë të caktuara, të cilat ne duhet t’i shfrytëzojmë në maksimum. Allahu (xh. sh.) thotë: “Për të qenë të pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin Allahun në ato ditë të caktuara.” (Haxh: 28)

Në shkoqitjen e këtyre ajeteve komentuesi më i njohur i Kuranit, Ibni Abasi (r. a.), thotë se “ditët e caktuara” që përmenden në Kuran janë dhjetë ditët e muajit Dhulhixhe.

Vlerën e këtyre dhjetë ditëve e gjejmë edhe në disa hadithe të Pejgamberit (s.a.v.s.) dhe në mesin e tyre është edhe hadithi i transmetuar nga Ibni Abasi (r. a.), i cili ka thënë: “I dërguari i Allahut (s.a.v.s.) ka thënë: “Nuk ka ndonjë ditë pune më të mirë që është më e dashur tek Allahu se këto ditë” – domethënë, ditët e Dhulhixhes. Të pranishmit kur i dëgjuan këtë fjali nga Pejgamberi (a. s.), i thanë: “A as xhihadi në rrugën e Allahut? Pejgamberi (a. s.) tha: “As xhihadi në rrugën e Allahut.”

Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Xhabiri (r. a.), Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Nuk ka ditë më të vlefshme tek Allahu sesa ditët e Dhulhixhes.” Një njeri i pranishëm i tha: O i dërguar i Allahut, ato ditë janë më të vlefshme, apo ditët që i kalon në xhihad në rrugën e Allahut? Tha: Ato janë më të vlefshme sesa kalimi i tyre në xhihad në rrugën e Allahut.” (Ibni Hibani)

Imam Ahmedi regjistron një hadith me transmetim nga Ibni Omeri (r. a.) se Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Nuk ka ditë më të mëdha e as punë më të dashura tek Allahu sesa këto dhjetë ditë, andaj shtoni sa më shumë në këto ditë shehadetin, tekbirin dhe tahmidin-falënderimin”.

KARAKTERISTIKAT DHE VEPRIMTARIA E KËTYRE DITËVE

S’ka dilemë se këto ditë të madhërishe që i ka vlerësuar dhe ngritur Allahu (xh. sh.) janë ditë që ne duhet t’i shfrytëzojmë me veprimtari konstruktive, për

shkak të karakteristikave të këtyre ditëve dhe bereqetit të veprimtarisë gjatë këtyre ditëve.

Në vazhdim do të përmendim disa karakteristika dhe veprime me të cilat besimtarët islamë duhet të angazhohen sa më shumë gjatë këtyre ditëve. Karakteristikë themelore e këtyre ditëve është se Allahu (xh. sh.) është betuar në këto dhjetë ditë, e kjo nënkupton vlerën e këtyre ditëve.

Këto dhjetë ditë të muajit Dhulhixhe në Kuran përshkruhen si ditë të caktuara, si ditë të veçanta, që nënkupton se edhe shpërblimet janë të veçanta për veprimtarinë tonë gjatë këtyre ditëve. Në këto ditë kemi edhe disa ibadete të veçanta, siç është tekbiri gjatë ditëve të teshrikut, therja e kurbaneve dhe, më e veçanta e këtyre dhjetë ditëve, është dita e Arefatit, ditë kjo për të cilën Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Nuk ka ndonjë ditë tjetër gjatë së cilës Allahu (xh. sh.) liron të dënuar nga Zjarri i xhehenimit më shumë se ditën e Arefatit.” (Muslimi)

Në dhjetë ditëshin e parë të muajit Dhulhixhe, respektivisht me ditën e tetë, e cila quhet “jevmu tervije”, fillon zbatimi i Haxhit dhe këtë ditë haxhinjtë bëhen gati për të dalë në Arefat.

Dita e dhjetë të muajit Dhulhixhe është dita e Kurban-Bajramit, kur besimtarët islamë përveç faljes së namazit të Bajramit, për hir të Allahut therin kurbanet e tyre dhe solidarizohen me skamnorët dhe jetimët. Për këtë ditë Pejgamberi (a. s.) thotë: “Prej ditëve, madhështore tek Allahu (xh. sh.) është dita e Kurban-Bajramit, dita kur theren kurbanet.” (Ebu Davudi)

Këto dhjetë ditë të muajit Dhulhixhe janë dhjetë ditët më të vlefshme të vitit. Në lidhje me këtë është pyetur Shejh Ibni Tejmije, se cilët janë ditët më të vlefshme, dhjetë ditët e muajit Dhulhixhe apo dhjetë ditët e fundit të muajit Ramazan? Ibni Tejmije është përgjigjur: Ditët e dhjetë ditëshit të parë të muajit Dhulhixhe janë më të mira se sa ditët e dhjetë ditëshit të fundit të muajit Ramazan, kurse netët e dhjetëditëshit të fundit të muajit Ramazan janë më të vlefshme se netët e dhjetëditëshit të muajit Dhulhixhe.

Shkaku i vlefshmërisë së tyre dhjetë ditëve të muajit Dhulhixhe, sipas dijetarëve islamë, është se këto dhjetë ditë bashkojnë të gjitha llojet e ibadeteve, duke filluar nga haxhi, namazi, agjërimi, sadakaja, kurbanit etj., që këto adhurime të gjitha nuk bashkohen në asnjë kohë tjetër përveç në muajin Dhulhixhe.

VEPRAT E PREFERUARA GJATË KËTYRE DITËVE

Meqë kjo kohë është me vlera të veçanta, gjithsesi duhet shfrytëzuar këto momente me vepra konkrete që të përfitojmë prej tyre. Nga veprat më të preferuara gjatë këtyre ditëve janë:

Shtimi i dhikrit dhe përmendjes së Allahut (xh. sh.), duke filluar nga dëshmia - shehadeti, leximi i Kuranit dhe formave tjera të dhikrit. Kjo përfitohet nga porosia pejgamberike ku thotë: “Shtoni sa më shumë në këto ditë shehadetin, tekbirin dhe tahmidin-falënderimin.” (Ahmedi)

Shtimi i namazeve nafile gjatë këtyre ditëve - sepse namazet nafile zëvendësojnë apo përmirësojnë të metat e namazeve farze. Namazet nafile janë dëshmi që dëshmojnë për dashurinë e njeriut ndaj Krijuesit të tij dhe ndaj Pejgamberit (a. s.). Në një transmetim nga Thevbani (r. a.), i cili thotë: E pyeta Pejgamberin (a. s.) për këtë çështje, e ai më tha: “Sa më shumë të bësh sexhde për Allahun e madhërishtë, sepse ti nuk do të bësh ndonjë sexhde për Allahun, e vetëmse ke për t’u ngritur në derexhe dhe do të shlyejë nga ti nga një mëkat.” (Muslimi)

Agjërimi i këtyre ditëve, e me theks të veçantë agjërimi i ditës së Arefatit për ata që nuk janë në Haxh: Në hadithin e transmetuar nga Ebu Seid el Hudriju (r. a.) Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Nuk ka një rob të Allahut që agjëron një ditë për hir të Allahut, e vetëm se Allahu (xh. sh.) do ta largojë fytyrën e tij nga zjarri i xhehenimit për 70 vite.” (Buhari, Muslim) Kurse për agjërimin e ditës së Arefatit Pejgamberi (a. s.) ka thënë: “Agjërimi i ditës së arefatit ti falë mëkatet e një viti që ka kaluar dhe një viti që vjen pas” Muslimi

Tekbirët teshrik pas çdo farzi që fillojnë me namazin e sabahit ditën e nëntë të dhulhixhes dhe përfundojnë me ditën e katërt të bajramit me namazin e iqindisë.

Prerja e kurbaneve ditën e Bajramit dhe shpërndarja e mishit të tyre për hir të Allahut (xh. sh.): Gjatë këtyre ditëve është mirë që besimtarët islamë të aktivizohen edhe më shumë në sferën e solidaritetit përmes shpërndarjes së sadakave ndaj atyre që kanë nevojë dhe jetimëve.

Gjithsesi, gjatë këtyre ditëve përveç lutjeve, nuk duhet harruar edhe pendimin si formë më e mirë e rehabilitimit të njeriut dhe përmirësimit të gjendjes së tij jo vetëm nga sfera e besimit, por edhe atë morale. (29.06.2022)

(Autori është Drejtor i Sektorit Fetar-Arsimor të Rijasetit të BFI të RMV)

DIMENSIONI METAFIZIK I KURBANIT

Kurbani nuk komentohet me mendje, por me dashuri, me ashk. Njerëzit me zemra të ngurta assesi nuk kanë mundësi ta kuptojnë kurbanin. Ata që janë të kapluar nga lukset e kësaj bote nuk kanë mundësi ta kuptojnë as kurbanin, as Ibrahimin (a. s.) dhe as Ismailin (a. s.).

Shkruan: Dr. Husein Rizai

Nevoja e njeriut për Krijuesin është edhe falënderim për tërë atë që Ai ka krijuar. Nevoja e njeriut për Krijuesin është edhe shenjë mirënjohjeje për vetë ekzistencën e tij dhe për çdo gjë përreth tij. Njeriu gjithnjë ka ndërjet nevojë që Allahut absolut t’i drejtohet për ndihmë dhe mbrojtje gjatë ballafaqimit me fenomenet që e rrethojnë, ka pasur nevojë për kurajë, për përkrahje, për inkurajim, ngushëllim dhe mbështetje

të tjera tipike për njeriun. Këtë nevojë të tij, sipas udhëzimeve hyjnore, njeriu e ka manifestuar në forma dhe mënyra të ndryshme. Njëra nga format e komunikimit ndërmjet Krijuesit dhe krijesës është edhe flijimi, sakrifica, e cila në gjuhën fetare islame njihet si kurban.

Kurbani nuk komentohet me mendje, por me dashuri, me ashk. Njerëzit me zemra të ngurta assesi nuk kanë mundësi ta kuptojnë kurbanin. Ata që janë të kapluar nga lukset e kësaj bote nuk kanë mundësi ta kuptojnë as kurbanin, as Ibra-

himin (a. s.) dhe as Ismailin (a. s.). Në rrethin ku jetojmë, pothuajse çdokush është kurban i diçkaje! Dikush është kurban i pasurisë, tjetri i postit, ndërsa shumë të tjerë janë kurban të pasioneve. Ka prej tyre që thonë: ‘ne asnjëherë nuk bëjmë e as nuk bëhemi kurban i askujt’, e në fakt ata janë kurbanet e vetvetes, të krenarisë, të egos, të postit, të pasioneve dhe mu këta janë të gJORËT. Këta njerëz nuk kanë mundësi të flijojnë asgjë në rrugë të Allahut, sepse janë bërë robër të vetvetes. Ata që nuk e kuptojnë këtë fli-



Jim dhe janë robër të pasioneve të tyre, Bajramin e kuptojnë si hare, ndërsa Kurbanin si kafshë të thjeshtë.

AFRIM TEK ALLAHU I PLOTFUQISHËM

Në realitet, Kurbanit është një akt adhurimi dhe një prej treguesve të afrimit tek Allahu i plotfuqishëm. Synim i therjes së kurbanit është humanizmi dhe bujaria ndaj atyre që nuk mund t'u sigurojnë fëmijëve në sofrat e tyre qoftë edhe një copë mish gjatë kësaj feste. Kafsha që pritet gjatë ditëve të Kurban-Bajramit nga ana e myslimanëve, në gjuhën arabe emërohet me fjalën kurban apo ud'hijje. Në përkthim të fjalëpërfjalshëm, fjala kurban do të thotë 't'i afroresh dikujt apo diçkaje'. Prandaj, ai që ther kurban në emër të Allahut, me këtë vepër synon t'i afrohet Zotit të botëve.

Në përgjithësi, në ibadetet e fesë islame kërkohen 3 gjëra apo segmente, të cilat e bëjnë ibadetin kuptimplotë dhe nevojën për ibadet adhurim:

1. Motivi ose shkaku,
2. Dobia ose interesi,
3. Hikmeti ose urtësia.

Në përgjithësi, te të gjitha ibadetet, e në veçanti te kurbanit, shkaku, interesi dhe urtësia janë të ndërlidhura me parimin - **Lima Hulika Lehu** - 'qëllimi i krijimit të gjërave'. Allahu fuqiptotë në Kuranin fisnik thotë: "*Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por tek Ai arrin bindja juaj. Ai ashtu ua nënshtroi*

ato juve, që ta madhëroni Allahun për udhëzimet që jua bëri. Bamirësve jepu myzhde." (Haxh, 37) Si rrjedhojë, qëllimi, shkaku dhe hikmeti janë se kafsha duhet të pritet, kurse zëvendësimi i kësaj është në kundërshtim me qëllimin e krijimit dhe kjo është padrejtësia më e madhe që mund t'i bëhet Allahut fuqiptotë.

Nënshtimi ndaj ligjeve të Allahut (xh. sh.) është nevojë e çdo individi, për arsye se vetëm në këtë mënyrë mund të jetohej një jetë e qetë dhe e lumtur. Në të kundërtën, mospërfillja e ligjeve të Allahut (xh. sh.) të çon t'u nënshtrohesh interesave të ndryshme, pasioneve, gjërave negative e destruktive.

Allahu fuqiptotë gjithçka na ka nënshtuar neve - diellin, hënën, lumenjtë, kafshët, ndërsa ne duhet t'i nënshtrohemi Allahut. Kjo është natyra dhe obligimi që kërkon Zoti nga njerëzit; e kundërta e kësaj është në kundërshtim me natyrën dhe me besimin. Në qoftë se atyre ua ndryshon vendin dhe qasjen, atëherë fillimisht karshi këtyre dukurive do të ndjehesh i paaftë e, dalëngadalë, paaftësia do ta marrë vendin e frikës; e më pas frika do të zëvendësohet me nder, pastaj nderi kalon në shenjtëri dhe në fund arrin deri në besim. Shembulli më i mirë është me egjiptasit e vjetër, të cilët i besonin diellit dhe lumit Nil dhe i sakrifikonin vajzat e tyre duke i hedhur në lumin Nil. E njëjta ndodh me popullin indian (të Indisë) - për ta lopa është e shenjtë dhe kjo shenjtëri erdhi duke e kundërshtuar urdhrin e Allahut që ta sakrifikojnë atë për Zotin. Zoti kërkoi që të sakrifikohej lopa,

mirëpo ata e bënë të kundërtën dhe kjo është padrejtësi ose shirk, e në fakt shirku/padrejtësia është prishje e hierarkisë.

Me rastin e prerjes së kurbanit, nga besimtarët kërkohet që të sakrifikojnë kurban që është pa të meta, sepse kjo reflektohet në imanin e tyre; nëse sakrifkohet kafshë me të meta, kjo tregon se edhe besimi është me të meta. Si rrjedhojë, imani/besimi bëhet i verbër dhe nuk ka mundësi të shihet e vërteta ose të shijohet kënaqësia; por çdo gjë që do të përjetohet, do të jetë pa besim dhe pa iman.

JO GJURMËVE TË DJALLIT

Zoti nga besimtarët kërkoi që të kenë besim të plotë, e këtë më së miri e tregon në Kuranin fisnik, ku thotë: "O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkoni gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar." (Bekare, 208)

Si i bëhet Kurban Allahut - kafshët me thikë, ndërsa njeriu: me dorëzim, siç u dorëzuan pejgamberët e Allahut. Gjithsesi, kurbanit pritet në emër të Allahut, duke e madhëruar dhe duke e lartësuar Atë. Përpos kësaj, prej besimtarit kërkohet që çdo veprim ta bëjë me emrin e Allahut: çdo punë të mirë dhe të hairit ta fillojë me "Bismil-lah" (me emrin e Allahut); kur të kërkojë ndihmë kundër shejtanit, të thotë: "Eudhubil-lah" (kërkoj mbrojtjen e Allahut); atëherë kur mahnitet dhe kur habitet, thotë: "Mashallah" (shumë mirë); në rast të pendesës/teubes thotë: "Estagfirullah" (kërkoj falje nga Allahu); në çdo gëzim dhe hare thotë: "Allahu Ekber" (Allahu është më i madhi); në raste mërzie dhe dëshpërimi thotë: "Inna Lil-lah" (të Allahut jemi); gjatë shqetësimeve të ndryshme thotë: "Fe Subhanallah" (çdo lavdërim i takon Allahut); në çdo fitore apo ngadhënjim thotë: "Nasrun Minallah" (fitorja vjen nga Allahu); në rast të përfundimit të pasurisë apo të ardhurave materiale thotë: "Er-Rrizku al-Allah" (furnizimi është nga Allahu); për çdo dëshirë dhe kërkesë nga Zoti thotë: "Ishallah" (nëse do Allahu); pas kryerjes apo përfundimit të ndonjë pune të rëndësishme të thotë: "Bidhnil-lah" (me lejen e Allahut); në ballafaqimet me problemet dhe vështirësitë e jetës të thotë: "La havle ve la kuvvete ila bil-lah" (Nuk ka fuqi dhe mujshi që mund të ndodhë pa lejen dhe caktimin e Allahut) dhe në çdo premtim thotë "Valah-Bil-lah" (pasha Allahun, për Allahun!)

MEDRESEJA ME SUKSES PËRFUNDOI VITIN SHKOLLOR



Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, më 28.06.2022 mori pjesë në mbledhjen e Këshillit Edukativo-Arsimor të Medresesë Isa Beu në Shkup, në të cilën u vlerësua puna e shkollës së mesme islame për vitin shkollor 2021/2022, thuhet në njoftimin e BFI.

Mbledhja u mbajt në lokalet e Medresesë-Qendër dhe në të morën pjesë të gjithë Këshillat e klasave të Paraleleve të Shtirra, me të gjithë mësuesit e Medresesë.

Fillimisht, Reis'ul-Ulemaja u dëshiroi punë të mbarë të gj-

të të pranishmëve në mbledhje, e më pas Drejtori, prof. Ibrahim ef. Idrizi, prezantoi rendin e ditës, ku çdo kujdestar paraqiti suksesin e klasës.

Këshilli Edukativo-Arsimor, i udhëhequr nga Drejtori prof. Ibrahim Idrizi, ka diskutuar për Raportin me shkrim nga kujdestarët e klasave për suksesin, sjelljen e nxënësve dhe mungesat, ndërsa më pas për Raportin nga profesorët e lëndëve për realizimin e planprogrameve, Raportin me shkrim nga Këshilli i Edukatorëve për realizimin e rendit shtëpiak.

Në fjalën e tij para Këshillit, kreu i myslimanëve të Maqedonisë së Veriut, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu e ka çmuar lart punën e nxënësve të Medresesë dhe suksesin e tyre të arritur në këtë vit shkollor, duke e falënderuar drejtorin e shkollës, mësuesit, të cilët drejtpërdrejt kanë punuar me nxënësit. Ai po ashtu tregoi për gatishmërinë dhe sfidat rreth ecurisë së regjistrimit të Medresesë në Regjistrin e shkollave të mesme.

Anëtarët e Këshillit Edukativo-Arsimor të Medresesë Isa Beu janë shprehur optimistë për punën në vijim të Medresesë, thuhet në njoftimin e BFI.

145 MATURANTË MARRIN DIPLOMAT



Me sukses të lartë u mbyll viti shkollor 2021/22 në shkollën e mesme islame "Medreseja Isa Beu", Shkup, që u kurorëzua me shpërndarjen e diplomave për 145 maturantë më 5 korrik, 2022, thuhet në njoftimin e BFI.

Në këtë ceremoni ishte i pranishëm Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, i shoqëruar nga drejtorët e sektorëve të Rijasetit, nga myftinjët e Myftinive, nga koordinatorët e Paraleleve të Shtirra të Medresesë, nga profesorët dhe profesoret, nga prindërit dhe shumë miq dhe dashamirë të kësaj vatre edukativo-arsimorë.

Fjalën përsëritëse e mbajti Drejtori i Medresesë Isa Beu, prof. Ibrahim ef.

Idrizi, i cili pasi i përsëriti të pranishmit në emër të kolektivit të Medresesë Isa Beu, foli për përgatitjen e nxënësve në këtë vatrë të dijes.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në fjalën e tij të rastit uroi medresantët e diplomuar, ndërsa edukatorët, profesorët dhe profesoret dhe përgëzoji për punën e tyre të palodhshme dhe për sakrificat e bëra që kjo vatrë arsimore dhe këta nxënës kryelartë të përfundojnë vitin shkollor.

Më pas, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, së bashku me Drejtorin e Medresesë prof. Ibrahim ef. Idrizi, Myftiun e Shkupit dr. Qenan ef. Ismaili dhe Myftiun e Tetovës prof. dr. Qani ef. Nesimi i ndanë diplomat për 145 maturantët e Medresesë

Isa Beu.

Vlen të theksohet se këtë vit në Medresenë-Qendër diplomoi gjenerata e 35, në Paralelen e Vajzave Tetovë - gjenerata 15, në Paralelen e Djemve në Shtip - gjenerata 14, në Paralelen e Vajzave në Shkup - gjenerata 13, në Paralelen e Vajzave Gosivar - gjenerata 11, thuhet në njoftimin e BFI.

Gjatë ditës, në kohë reale, pati dhe transmetim të drejtpërdrejtë në platformat elektronike të BFI, gjatë të cilit u transmetua fjala e Kryetarit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në ceremoninë e përcjelljes së maturantëve të Medresesë Isa Beu.

HATME NË GURGURICË

Më 13 korrik, 2022, u mbajt manifestimi i dytë së hatmes së nxënësve të xhamisë së fshatit Gurguricë, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Në Mejtepin e Xhamisë nxënëset mësimet i kanë marrë nga hoxhë Jakup ef. Jakupi.

Gjithsej 11 vajza kanë marrë diploma, të gjitha në shkallën IV.

Suksesi i nxënësve nga ana e Komisionit të Myftinisë u vlerësua me 'shumë mirë', thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Tetovës.

NJË DELEGACION NGA ST. GALLEN VIZITON BFI-në



Në kuadër të takimeve me besimtarë, në veçanti me ata nga diaspora, sot pritëm në vizitë delegacionin nga qendra islame shqiptare "Xheneti" nga St.Gallen (Zvicër), thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu (Facebook, faqja personale, 21.07.2022).

Në delegacion ishin nënkryetari z. Mevludin Ademi (Preshevë) dhe z. Ragib Rama nga Prishtina, të shoqëruar nga prof. Muharrem Loku, mësimdhënës i SHMI "Medreseja Isa Beu" në Shkup, shpeshherë imam i për-

kohshëm në këtë xhami.

Falënderuam mysafirët për kontributin e dhënë në shërbim të Islamit dhe të kombit në Zvicër, si dhe të BFI të RMV e më gjerë. Ata na dhuruan mirënjohje në emër të Qendrës së tyre për organizimin e jetës fetare në vendin tonë. Njëherësh, edhe ne në emër të BFI iu ndamë mirënjohje, në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për kontributin dhe angazhimin e tyre. Iu uruam punë të mbarë dhe suksese në jetën e tyre, thuhet në njoftimin e Kryetarit të BFI të RMV.

TAKOHEN DONATORËT E QENDRËS ISLAME NË KRIVA-PALLANKË

Më 9 korrik, 2022, patëm një takim të rëndësishëm me z. Salih Rexhepi, i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, znj. Ajshe Rexhepi, dëshira e të cilëve ishte të vizitojnë Bashkësinë Fetare Islame të RMV, thuhet në njoftimin e Shaqir ef. Fetahu.

Pata nderin që të jenë mysafirë të mi, sepse janë donatorët kryesorë të Qendrës Islame në Kriva-Pallankë, RMV. Si familje, jetojnë dhe punojnë në Çikago të SHBA, me prejardhje nga Struga dhe njihen si kontribues të mëdhenj në shërbim të vlerave fetare e kombëtare dhe si humanistë të mëdhenj.

Ne iu falënderuam për kontributin e madh për një shtëpi të Zotit mu aty ku ka pasur nevojë më të madhe për besimtarët islamë.

Njëherësh, i shprehëm mirënjohje hoxhës së mirënjohur, h. Muharrem Ismaili, anëtar i Kryesisë së Myftinisë së Shkupit dhe imam në Xhaminë e Isa Beut në Shkup, për mundin që dha në menaxhimin e donacionit dhe z. Driton Dikena,



drejtor për çështje të vakëfit në BFI, për menaxhimin e përfundimit të këtij projekti.

Bashkë me kontribuesin z. Salih Rexhepi ishte edhe miku i tij, z. Sefer Tahiri dhe bashkëshortja e tij, znj. Yrimsha Tahiri.

Mysafirët e nderuar mbetën shumë të kënaqur nga pritja dhe shprehën mirënjohje për respektin e treguar ndaj tyre. Për kontributin e dhënë iu ndamë mirënjohje të veçantë. Zoti i bekoftë, thuhet në njoftimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu. (Facebook, 21.07.2022)

MYFTIU TAKON IMAMËT NGA TETOVA

Më 20 korrik, 2022, në hapësirat e Myftinisë së Tetovës, Myftiu prof. dr. Qani ef. Nesimi realizoi një takim me imamët nga Tetova me rrethinë, që shërbejnë nëpër qendra të ndryshme të shteteve evropiane, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Tetovës.

Me këtë rast, Myftiu i falënderoi të pranishmit, duke e lutur Allahun Fuqiplotë që t'i shpërblejë me të mirat e Tij.

Pas takimit, të gjithë bashkërisht vizituan Xhaminë e Kodrës së Diellit, ku edhe e falën namazin e drekës, thuhet në njoftimin e Myftinisë së BFI-Tetovës.



PRITJE NË BEZISTAN PËR MYSAFIRËT NGA BERNA



Sot pata nderin të mirëpres në Çarshinë e Shkupit mysafirët nga qyteti i Bernës (Zvicër): priftin dr. Christian Walti dhe priftëreshën dr. Angela Büchel Sladkovic, të cilët udhëhiqnin një grup teologësh profesionistë, të ardhur në vizitë në Shkup, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili, të datës 14 korrik, 2022.

Veprimtarët e përkushtuar në çështje fetare qëndrojnë në Shkup për disa ditë, për të vazhduar edhe në vende të tjera të rajonit, për t'u njohur për së afërmi me autoritetet fetare të Ballkanit.

Me kënaqësi i pritja në Bezistan dhe i njoftova me veprimtarinë e Myftinisë së Shkupit, me jetën fetare islame që zhvillohet në trevat tona, përkushtimin fetar të

popullatës sonë, si dhe me aktivitetet tona të llojllojshme, me qëllim ruajtjen e traditës fetare të kultivuar ndër shekuj, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit.

NDJESË

Foto-teksti në fq. 35 B është i datës 1.06.2022. Ngatërresa është bërë gjatë përpunimit teknik të materialeve.

ÇËSHTJA E “SHTATË SHKRONJAVE”

Këto shtatë shkronja janë rezultat i lutjes së Profetit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), i cili kërkoi prej të Madhit Allah t’ia lehtësojë leximin e Kuranit ymetit të tij. Allahu i Lartë e pranon lutjen e këtij profeti të dhembshur ndaj ymetit dhe lejon që Kurani të lexohet në disa forma të ndryshme.

Shkruan: Hasime Salihu

Për të kuptuar temën e kiræeteve duhet patjetër të cekim çështjen e “shtatë shkronjave”. Ky është një term i shprehur nga vetë Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Hz. Omeri (radijallahu anh-Zoti qoftë i kënaqur me të) na transmeton një nga hadithet më të rëndësishme në lidhje me kiræetet. Ta lexojmë këtë nga vetë fjalët e tij:

Kur Profeti (a. s.) ishte ende në jetë, dëgjova Hishâm b. Hakîmin (r. a.) duke lexuar suren Furkan. Ndërkohë, vura re që ai lexonte ndryshe nga ajo që kisha mësuar nga i dërguari i Allahut (a. s.). Për pak, sa nuk e sulmova në namaz. Durova

derisa dha selamin dhe menjëherë shkova, e shtrëngova për jakën e rrobës dhe e pyeta: “Kush ta ka mësuar suren që sapo dëgjova prej teje?!” Ai m’u përgjigj: “Ma ka mësuar i dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem).” “Gënjen”, i thashë – “sepse Profeti (alejhis-selâm) ma ka mësuar edhe mua këtë sure, por në një formë tjetër.” Kështu, shkova së bashku me të te Resulullahu (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) dhe i tregova: “Dëgjova prej këtij personi të lexojë suren Furkan ndryshe nga ç’më ke mësuar mua.” Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) kërkoi prej Hishâm-it të lexojë dhe ai e lexoi suren Furkan ashtu si e lexoi më parë. Pas saj i dërguari i Allahut (alejhis-selâm)

thotë: “Kështu ka zbritur kjo sure.” Më pas m’u drejtua mua dhe duke thënë “Lexo, o Omer!”, kërkoi prej meje të lexoj të njëjtën sure dhe pasi përfundova leximin, pohoi kështu: “Kjo sure ka zbritur edhe kështu. Ky Kuran ka zbritur në bazë të shtatë shkronjave. Lexoni sipas cilës ta keni më të lehtë.”

SHKAKU I DALLIMEVE NË LEXIM

Në një transmetim tjetër i dërguari i Allahut (a. s.) e shpjegon shkakun e këtyre dallimeve në lexim. Muslimi transmeton prej Ibn Abbâs-it (radijallahu anh) se Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) ka thënë: “Xhibrili ma lexoi Kuranin

sipas një shkronje, por unë kërkova t’ma lexonte atë sipas më tepër se një shkronje, derisa ai ma lexoi në bazë të shtatë shkronjave.”

Transmetim i ngjashëm është edhe ai i Ubej b. Ka’bit (radijallahu anh), i cili dëgjon disa persona të lexojnë Kuranin, por në forma të ndryshme dhe shkon te Profeti (sal’lallahu alejhi ue sel’lem) me të njëjtën pyetje. Profeti i nderuar (alejhis-selâm) i shpjegon Ubej-it që Kurani ka zbritur në bazë të shtatë shkronjave dhe për këtë arsye ka lexime të ndryshme të tij.

Këtu po mjaftohemi me transmetimet, sepse thajse të gjitha hadithet në fjalë kanë të njëjtin thelb dhe të kalojmë në analizën e tyre.

Siç thamë edhe më sipër, këto shtatë shkronja janë rezultat i lutjes së Profetit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem), i cili kërkoi prej të Madhit Allah t’ia lehtësojë leximin e Kuranit ymetit të tij. Allahu i Lartë e pranon lutjen e këtij profeti të dhembshur ndaj ymetit dhe lejon që Kurani të lexohet në disa forma të ndryshme. Çdo person kishte leje ta lexonte tekstin hyjnor në mënyrën që i dukej më e lehtë, me kushtin që këtë formë leximi ta kishte mësuar prej Profetit (sal’lallahu alejhi ue sel’lem). Këtë kërkesë, Krenaria e njerëzimit, e bën për shkak se ymeti i tij nuk ishte i përbërë vetëm prej djemsh të rinj e dinamikë, por midis tyre ndodheshin burra e gra, të vegjël e të moshuar, njerëz që nuk dinë as lexim e as këndim etj. Pra, për një pjesë të madhe të popullit leximi i Kuranit sipas gjuhës së kurejshëve, gjuhës së fisit të Profetit (alejhis-selâm), ishte shumë e vështirë. Me sa kuptohet, me lejen e shtatë shkronjave, leximi i Kuranit është lehtësuar për shumë individë.

Nga ana tjetër, duhet theksuar edhe se transmetimet lënë të kuptohet se kjo leje është dhënë pas Hixhretit.

Pra, Kurani është lejuar të lexohet në forma të ndryshme në bazë të këtyre shtatë shkronjave. Vetëm se, në ditët e sotme dhe në informacionet që ndodhen në literaturën tonë klasike, megjithëse mendimet në lidhje me kuptimin e shtatë shkronjave janë të shumta (rreth 40), nuk kemi mundësinë të gjejmë një përkufizim të qartë për to. Edhe hadithet në lidhje me çështjen janë të kufizuara dhe nuk na paraqesin një pamje të qartë. Me shumë mundësi kjo ka ndodhur për shkak se në kohën e sahabëve të gjithë e dinin se çfarë do të thotë leximi i Kuranit në bazë të shkronjave të ndryshme. Për këtë arsye ata as kanë pyetur se çfarë janë shtatë shkronjat, por as nuk kanë transmetuar ndonjë informacion të detajuar në lidhje

me të. Kështu, dijetarëve u është dhënë liria ta interpretojnë këtë term në mënyra të ndryshme.

Megjithatë, kjo nuk është tema jonë kryesore në këtë shkrim. Shkaku që ne e trajtuam këtë çështje, qoftë edhe shkurtimisht, është se kiræetet kanë lidhje të ngushtë me shtatë shkronjat. Dijetarët janë të mendimit se kiræetet janë pjesa e mbetur e këtyre shtatë shkronjave, e transmetuar deri në ditët e sotme me zinxhirin muteuatir, e përshtatshme me mus’hafin e Hz. Osmanit (r. a.) dhe pa divergjenca me gjuhën letrare arabe. Nga transmetimet tjera dallohet që shtatë shkronjat kanë qenë më gjithëpërfshirëse, kurse kiræetet janë më të kufizuara.

Shkenca e Kiræetit është më e veçanta ndër disiplinat fetare. Në të nuk ka ndërhyrë mudi, apo dora e njeriut, sepse është shpallur nga Zoti i Gjithësisë dhe është ruajtur nga po vetë Ai. Tematikë e këtij shkrimi do të jenë çështjet si: shtatë shkronjat e Kuranit, shkaku i zbritjes, objektivit, kuptimi dhe disa specifika rreth tyre.

ZBRITJA E KURANIT NË SHTATË SHKRONJA

Shkaku i zbritjes së Kuranit në shtatë shkronja është që të jetë lehtësim për bashkësinë e tij, si shenjë fleksibiliteti, mëshirë dhe veçori për vlerat që ato bartin. Krahas këtij shkak, mund të aludohet edhe si dhënie përgjigje ndaj lutjes së Profetit (a. s.) në kohën kur i erdhni engjëlli i shpalljes dhe i tha: “Allahu të ka urdhëruar ty që t’ia lexosh Kuranin bashkësisë tënde sipas një shkronje. Ai (a. s.) tha: Kërkoi faljen e Zotit për atë që nuk di dhe ndihmën e Tij për atë që kërkoi, bashkësia ime nuk mund ta përballojë dot këtë.” Vazhdoi edhe më tej ta përsërisë të njëjtën gjë, derisa arriti në shtatë shkronja.”

Kurani u zbrit në gjuhën arabe, e cila përmban dialekte dhe thekse të ndryshme. Për këtë arsye, disave u vështirësohej përdorimi i fjalëve duke kaluar nga një dialekt në tjetrin, apo nga një shkronjë në tjetrën. Veçanërisht të moshuarit, gratë dhe ata që nuk dinin të lexonin nuk mund të bënin kalime të tilla qoftë edhe nëpërmjet metodës së nxënies. Nëse do t’u kushtëzohej të braktisnin dialektin dhe theksin e tyre, kjo do të ishte një peshë që s’do ta përballonin dot.

Gjuhësisht, fjala harf ka kuptimin anë, aspekt, brinjë, kufi, zonë dhe pjesë.

Shkronja gjithashtu është pjesë e rrokjeve në kontekstin e të qenit pjesë e fjalës.

“Ebu Amr ed’Dani thotë se kuptimi i shkronjave të aluduara nga Profeti (a. s.) mund të shpjegohet në dy pika: 1- Kurani u zbrit në shtatë dialekte të gjuhës arabe. Fjala “ahruf” është shumësi i fjalës “harf” dhe prej saj nënkuptohet fjala “formë ose mënyrë”, bazuar tek ajeti gjegjës, i cili në thelb përmban mënyrën e adhurimit ndaj mirësisë së shëndetit dhe përgjigjes së lutjes. Andaj, edhe Resulullahu i quajti dialektet e ndryshme të kiræetit “shkronja”, në kuptimin se për çdo dialekt ndodhet një formë ose mënyrë leximi. 2- Resulullahu i ka emërtuar “shkronja”, si një shenjë fleksibiliteti, sepse edhe arabët e kishin për zakon t’i emërtonin sendet me një emër të ngjashëm apo të përafërt me emrin e vetë sendit. Arsyeja e emërtimeve dhe e lidhjes në këtë formë është një shembull se si ata e emërtonin fjalinë me emrin e disa pjesëve të saj. Prandaj, Resulullahu e quajti kiræetin “shkronjë”, edhe nëse kjo është fjala e gjatë për faktin se në të ndodhen shkronja të cilave mund t’u ndryshojë radha, zanorja, forma, ose mund të lexohet me imale, mund t’i shtohet apo t’i pakësohet një shkronjë bazuar në llojshmërinë e kiræeteve. Kjo ishte arsyeja se pse Profeti ynë (a. s.) e quajti kiræetin “shkronjë” sipas zakonit të arabëve dhe si shenjë mirëbesimi ndaj përdorimit të kësaj fjale prej tyre.

ÇFARË SYNOHET ME KËTO SHTATË SHKRONJA?

Ndonëse dijetarët kanë mendime të ndryshme për sa i përket synimit të tyre, ata kanë rënë në konsensus për dy konkluzione:

1) Qëllimi prej këtyre shtatë shkronjave nuk është që njëra prej tyre të lexohet në shtatë dialekte, sepse kjo veçori është e kufizuar vetëm me disa fjalë të thjeshta.

2) Nuk lejohet të synohen prej këtyre shkronjave shtatë imamët e shquar të kiræetit, në kundërshtim me atë që mendon një pjesë e njerëzve. Shtatë imamët e shquar kanë jetuar shumë kohë më vonë pasi është zbritur Kurani.

Ndaj, shumica e dijetarëve janë të mendimit se ato janë dialekte. Natyrisht që edhe në këtë temë ka opinione të ndryshme. Ebû ‘Ubejd thotë se këto dialekte janë dialekti: kurejsh, hudhejl, thekîf, heuâzin, kenâne, temîm dhe jemen. Një tjetër thotë se ato janë pesë dialekte të krahinës heuâzin: sa’d, thekîf, kenâne, temîm dhe jemen, si dhe dy dialekte të përbashkëta në të gjitha dialektet arabe. Ebû ‘Ubejd Ahmed b. Muhammed b.

ا	ب	ت	ث	ج	ح	خ
د	ذ	ر	ز	س	ش	ص
ض	ط	ظ	ع	غ	ف	ق
ك	ل	م	ن	ه	و	ي

Muhammed el'Herauî thotë se këto shtatë dialekte janë nga dialektet e gjuhës arabe dhe janë të shpërndara në Kuran, duke u shprehur se një pjesë e tij është në dialektin kurejsh, një pjesë në dialektin hudhejl, një pjesë në dialektin heuâzin dhe një pjesë në dialektin jemen. Ibnu'l Xhezerî thotë se të gjitha këto opinione janë të sakta. Edhe pse Hz. Omeri dhe Hishâm b. Hakîm (r. anhumâ) ishin të dy kurejshitë, nga i njëjti fis dhe flisnin të njëjtin dialekt, ata ndryshonin në çështjen e leximit të sures el'Furkân.

Ka dijetarë që thonë se prej shtatë shkronjave synohen kuptimet e gjykimeve, si: hallall, haram, muhkem, muteshâbih etj. Sipas Ibnu'l Xhezerî ky mendim është i pasaktë, sepse sahabet nuk patën kontradikta në komentin dhe gjykimet e Kur'anit, por në leximin e gërmeve të tij.

PËRSE NUMRI SHTATË?

Mendime të ndryshme gjithashtu janë paraqitur edhe në lidhje me temën se përse nuk janë më shumë apo më pak, por janë shtatë shkronja. Shumica e dijetarëve mbështesin mendimin se rrënjët e fiseve arabe përfundonin në numrin shtatë, ose dialektet e pastra janë shtatë, mirëpo të dyja këto nuk janë tjetër veçse pretendime. Një tjetër mendim thotë se nuk synohet numri i vërtetë prej shtatës me idenë e shtimit, apo pakësimit, por qëllimi është fleksibiliteti dhe lehtësimi; dialektet arabe nuk përbëjnë pengesë në leximin e kiraetit për arsyen se Allahu ua ka lejuar atyre. Arabët e përdorin fjalën

“shtatë” edhe në vend të shtatëdhjetës, apo shtatëqindës dhe nuk kanë për qëllim numrin e saktë, por synojnë sasinë e shumtë dhe hiperbolën pa ndonjë limit.

Vendndodhja e shtatë shkronjave: Këto shtatë shkronja janë në vende të ndryshme të Kuranit. Për këtë nuk ka asnjë dyshim, madje ato ndodhen te çdo transmetim dhe kiraet në nocionin që po huam në lidhje me të qenit shtatë shkronja dhe se ato nuk janë të kufizuara me leximin nga fillimi deri në fund të një kiraeti, apo këndimin e një rivajeti. Ai që lexon Kuranin me një kiraet të caktuar, konsiderohet që e ka lexuar atë me një nga shkronjat e përmendura, por nuk mund të thuhet se ai e ka lexuar me të shtatë shkronjat.

Një grup prej tyre janë të mendimit se mus'hafet osmanije i përfshijnë të shtatë shkronjat. Në bazë të këtij përfundimi ata thonë se nuk lejohet neglizhimi në transmetim qoftë edhe i një diçkaje të vogël në lidhje me shtatë shkronjat. Ata gjithashtu janë në konsensus për braktisjen e çdo gjëje tjetër përveç shtatë shkronjave, duke thënë: nuk lejohet ndalimi i leximit me disa prej shtatë shkronjave dhe nuk lejohet braktisja e diçkaje që është prej Kuranit.

Ndërsa shumica e dijetarëve të parë, të mëvonshëm dhe e imamëve të tjerë janë të mendimit se mus'hafet osmanije përfshijnë vetëm atë që përmban pamja, resmja, fotoja e tyre prej shtatë shkronjave. Nisur nga prezantimi ballë për ballë dhe i fundit i Kuranit ndërmjet Profetit dhe engjëllit të shpalljes, mus'hafet osmanije janë përmbledhëse dhe përfshi-

rëse të të shtatë shkronjave, pa çuar dëm as edhe një germë. Në ndryshim nga herët e tjera, Profeti (a. s.) në vitin që shtegtoi në botën e përtejme e këndoi Kuranin me Xhibrilin (a. s.), engjëllin e shpalljes dy herë, pra një herë këndonte Profeti dhe dëgjonte Xhibrili, pastaj këndonte engjëlli, Xhibrili (a. s.) dhe dëgjonte Profeti, dhe herën e dytë këndonte Profeti e dëgjonte engjëlli, më pas këndonte engjëlli dhe dëgjonte Profeti. Në total, vitin e fundit Kurani është kënduar katër herë me nga dy seanca. Ibnu'l Xhezerî e mbështet këtë mendim dhe thotë se hadithet e sakta të transmetuara dhe veprat e famshme janë argumentuese të këtij mendimi.

Leximi sipas shtatë shkronjave nuk është vaxhib, por është i lejuar, si lehtësi për ummetin. Secili është i lirë të lexojë me cilën shkronjë ka lexuar më parë. Një mendim është se lejimi i rreth shtatë shkronjave ishte i posaçëm për kohët e para të Islamit, në mënyrë që të ruhej në një shkronjë të vetme, sepse njerëzit vështirësoheshin në leximin me të tëra shtatë shkronjat. Në kohën që gjuhët u mësuan, me artikulin e tyre arritën në unanimitetin e leximit me një shkronjë të vetme, si një shenjë lehtësimi për njerëzit. Ky është mendimi më i përshtatshëm. Në fund ata ranë në konsensusin e leximit sipas shkronjës me të cilën u lexua në prezantimin e fundit të Kuranit.

A janë kiraetet që lexohen në ditët e sotme përfshirëse të të gjitha shtatë shkronjave, apo të një pjese të tyre? - Një pjesë e mirë e njerëzve mendojnë se shtatë shkronjat e përmendura në hadith

janë shtatë kiraetet. Për këtë arsye, shumica e dijetarëve nuk e kanë pëlqyer shkurtimin e bërë nga Ibni Muxhahidi në shtatë imamë. Dijetari ibni Tejmije thotë se “shtatë shkronjat e përmendura në hadith nuk janë shtatë kiraetet, apo shtatë imamët.” Hadithi i Profetit (a. s.) kurrësi nuk duhet të mendohet i kufizuar në shtatë kiraete. Thelbi është se kiraeti merret nga një imam i besueshëm fjalë për fjalë, derisa zinxhiri i transmetimit të arrijë të Profeti (a. s.).

Në fakt, kiraetet nuk kanë kontradiktë, apo mospërputhje me njëra-tjetrën. Ato dallojnë për nga variacioni dhe larmia e llojeve të leximit. Nuk mund të mendohet që mospërputhja të jetë veçoria e kiraeteve, sepse Allahu (xh. sh.) në Kuranin famëlartë thotë: “A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, do të gjenin në të shumë kundërthënie.”

Çdo gjë e transmetuar në mënyrë të saktë nga Profeti (a. s.) është obligim që të pranohet. Nuk mund të pranohet refuzimi i tij dhe automatikisht kërkohet t'i besohet atij transmetimi, sepse ai është zbritur prej Allahut (xh.xh). Pozita e çdo kiraeti në krahasim me kiraetin tjetër është e ngjashme me pozitën e ajeteve me njëra-tjetrën, ku është obligim besimi ndaj tyre dhe ndjekja e thelbit si nga ana kuptimore, ashtu edhe nga ajo e vënies në praktikë. Nuk lejohet braktisja e njërit prej tyre me idenë se në mes tyre mund të ketë ndryshime.

Sahabiu i nderuar Abdullah b. Mes'udi shprehet tekstualisht: “Mos u konfliktoni dhe mos bëni polemikë në çështjen e Kur'anit, sepse në të nuk ka ndonjë gjë për konflikt, apo për të t'u ngatërruar. A nuk e shikoni që ligji i Islamit, kufijet e vendosur nga ai, leximi i tij (ligjit të Islamit) dhe urdhëresat e Allahut janë të njëjta, pra nuk ndryshojnë? Nëse njëra nga shkronjat e zbritura të Kuranit do të urdhëronte për diçka, e shkronja tjetër do të ishte penguese për të, atëherë këtij mund t'i thuhet kontradiktë. Mirëpo, Kurani i përfshin të gjitha llojet e leximeve. Ai që lexon sipas një kiraeti, të mos e braktisë atë me idenë se kiraeti tjetër është më i mirë. Ai që mohon njërin nga shtatë shkronjat, ka mohuar tërë Kuranin.”

DOBITË E LLOJEVE TË NDRYSHME TË KIRATEVE

1) Pika më e lartë e elokuencës, perfeksionimi i i'xhazit, maja e koncizitetit bashkë me ekzakhtësinë dhe bukuria e lakonizmit – dobia e parë. Secili kiraet ka



pozitën e ajetit. Nëse dallimet ndërmjet fjalëve vendosen në vend të ajeteve dhe nëse bëhet shenjimi i çdo fjale si ajet, sipas madhësisë së tij, atëherë do të ishte i pashmangshëm zgjatimi.

2) Ndër argumentet e mëdha dhe evidente është se, ndonëse ka kaq shumë variante dhe llojshmëri në kiraete, ato nuk bien në kundërshti dhe kontradiktë me njëra-tjetrën. Përkundrazi, ato vërtetojnë, shpjegojnë dhe dëshmojnë për njëra-tjetrën sipas një metode dhe stili të njëjtë.

3) Lehtësia e memorizimit dhe e transmetimit të bashkësia.

4) Shpërblimi i madh për bashkësinë. Ata shpenzojnë energji në mënyrë që të arrijnë objektivin e tyre në kërkimin e kuptimeve, apo në deduktimin e urtesive dhe gjykimeve nisur nga aludimi i çdo fjale.

5) Virtyti dhe vlera e kësaj bashkë-

sie në krahasim me bashkësitë e tjera për sa i përket pranimit, orientimit kah libri, kërkimit fjalë për fjalë, zbulimit shprehje për shprehje, kumtimin të saktësisë dhe korrektesisë së tij, perfeksionimit të rregullave të texhvidit. Ruajtja nga deformimet dhe shtrembërimet, mosneglizhenca qoftë edhe e një zanoreje, apo sukuni, një tefkhîmi, apo terkîki derisa konsoliduan kohën e zgjatjes së meddeve, dallimet ndërmjet imaleve dhe bënë ndarjen në mes shkronjave dhe cilësive të tyre.

6) Ndër karakteristikat e tjera daluese është edhe lartësia e gradës së personit tek Allahu, si pasojë e transmetimit me saktësi të çdo shkronje të Kuranit, duke mos lënë hapësira dyshimi. Nëse nuk do të shquheshin tiparet e tjera, kjo karakteristikë do të mjaftonte si një veçori e vetme. /Vazhdon/

(Fusnotat janë hequr nga Redaksia gjatë përpunimit të tekstit)



DISPOZITA E VEPRIMIT ME HADITH TË DOBËT (2)



Shkruan: Melek Bislimi

Për hadithin daif të ketë ndonjë bazë, nën të cilën mund që të përfshihet hadithi i tillë (i dobët) që nënkupton se, hadithi i tillë të jetë në mesin e disa haditheve tjera, të cilët dëshmojnë për autenticitetin e tij. Hadithet ose mund të jenë sahiha vetvetiu (ar. bi-dhatiha), kështu që ato hadithe e përforcojnë hadithin daif, ose mund të jenë edhe ato hadithe daife (të dobëta), kështu që ato përforcohen mes tyre.

Nuk është patjetër që hadithet që e përforcojnë njëri-tjetrin të jenë në të njëjtin libër, respektivisht në të njëjtin koleksion, sepse ai mund të jetë në ndonjë koleksion tjetër të haditheve. Sa për ilustrim do të shënojmë këto dy shembuj.

Hadithin nr. 1167 që e transmeton Ibni Maxhe në sunenin e tij.

Na ka treguar Ebu Kurejb, do të thotë

Muhamed ibni Ala Hemedani, na ka treguar Zejd ibni Habbab, na ka treguar Omer ibni Ebu Hush'am, nga Jahja Ibni Kethir, nga Ebu Selemete, nga Ebu Hurejrete r. a. (hadith merru), i cili ka thënë: I dërguari i Allahut (sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) ka thënë: "Kush fal gjashtë rekate pas (namazit të-salati evvabin akshamit, mes tyre (gjatë faljes së këtyre rekateve) nuk flet me ndonjë të keqe, (këto rekate) atij i llogariten sikur të adhurojë (të bëjë adhurim, të falë) dymbëdhjetë vjet."

Ebu Isa (Tirmidhiu) ka thënë: Në lidhje me këtë është transmetuar nga Aisheja (r. a.), nga Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem (hadith merfu), i cili ka thënë: "Kush i fal pas (namazit të) akshamit njëzetë rekate, atij Allahu ia ndërton një shtëpi në xhenet (në parajsë)." Këtë e ka transmetuar Ibni Maxhe nga transmetimi që e ka transmetuar Jakub

ibni Velid Medaini, nga Hisham ibni Ur-vete, nga babai i tij nga Aisheja r.a..

Sa i përket hadithit që e transmeton Ebu Hurejreja r.a. në senedin e këtij hadithi, të cilin e transmeton Ibni Maxhe dhe Tirmidhiu gjendet Omer ibni Ebu Hush'am, për të cilin Imam Mundhiri në Tergib (dhe terhib) ka thënë: Këtë e ka transmetuar Ibni Maxhe; Ibni Huzejme në sahihun e tij dhe Tirmidhiu, të gjithë këta e kanë transmetuar nga Omer Ibni Hush'am nga Jahja Ibni Ebu Kethir, nga Ebu Selemete, nga ai (Ebu Hurejreja r.a.), ndërsa Tirmidhiu ka thënë se, ky është hadith garib¹. Pastaj Tirmidhiu shton edhe këtë ku thotë se, kam dëgjuar Muhamed Ibni Ismail (Buhariun), i cili thoshte: Omer Ibni Abdulla Ibni Ebu Hush'am është munkerul hadithi. Dhe kështu ai (Buhariu) e konsideron shumë të dobët (ar. daif xhinden).ⁱⁱ

Kurse në lidhje me hadithin që e tran-

smeton Aisheja r.a.h. në senedin e tij gjendet Jakub Ibni Velid Medini (Medaini), për Jakubin janë deklaruar Imam Ahmedi, Ebu Hatimi dhe Ibni Hibbani se ai është gënjeshtarⁱⁱⁱ.

Kështu që asnjëri prej tyre nuk mund të përforcojë tjetrin, por megjithatë Ibni Maxheh i ka shënuar në sunenin e tij edhe për faktin se dy hadithet janë shumë të dobëta dhe asnjëri nuk mund ta përforcojë tjetrin.^{iv}

Mirëpo këto hadithe i përforcojnë disa hadithe tjera që janë transmetuar përmes rrugëve tjera dhe që janë shënuar në koleksione të tjera. Në lidhje me këtë Imam Mundhiri në veprën e tij "tergib ve terhib" shënon disa hadithe që dëshmojnë për këto hadithe, e në veçanti për hadithin e Ebu Hurejres r.a.. Në vazhdim do t'i përmendim hadithet që i ka shënuar Imam Mundhiri në terhib ve terhib.^v

Nga Muhamed Ibni Ammar Ibni Jasir, i cili ka thënë: Kam parë (vërejtur) Ammar Ibni Jasirin kur falej pas (namazit të) akshamit gjashtë rekate dhe kishte thënë: kamë parë të dashurin tim, të dërguarin e Allahut s.a.v.s. falej pas (namazit të) akshamit gjashtë rekate dhe kishte thënë: "Kush fal pas (namazit të) akshamit gjashtë rekate, atij i falen mëkatet (gjynahet) edhe nëse ato janë si (sa) shkuma e detit". (Ky është) hadith garib. E ka transmetuar Taberaniu në tri (veprat e tij, në kebir, evsat dhe sagir) dhe ka thënë: Vetëm Salih Ibni Katzen Buhariu e ka transmetuar këtë (hadith). Ndërsa Hafidhi ka thënë: ky Salih, nuk më kujtohet për momentin (tash), as nuk mund ta zhvlerësoj (xherh) e as ta vlerësoj (ta'dil).

Nga Esved Ibni Jezid, i cili ka thënë: Asnjëherë nuk kam shkuar tek Abdulla Ibni Mes'udi në atë kohë (pas akshamit), veçse e kam gjetur atë duke u falur, këtë ia thashë atij (se sa herë që prezantohet të gjej duke u falur), ai më tha: Sa e mirë është kjo kohë e lënë pas dore. Do të thotë, mes akshamit dhe jacisë. Transmeton, Taberaniu në Kebir, nga transmetimi i Xhabir El-Xhu'fij, por nuk e ka ngritur këtë.

Nga Mekhuli r.a., i cili tregon se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Kush fal pas (namazit të) akshamit dy rekate, para se të flet". Në një transmetim tjetër. "Katër rekate, namazi i tij ngritet te ata më të lartët (në qiejt e lartë)".

Nga Enesi r.a., i cili në lidhje me (ajetin kuranor) "I hiqin trupat e tyre prej shtretërve" (suret Es-sexhde, 16), ka zbritur në pritjen e namazit, i cili quhet namazi i errësirës. Transmetoi Tirmidhiu dhe ka thënë se (ky është) hadith hasenun sahih garib dhe (transmetoi edhe) Ebu

Davudi, por ky ka thënë: Ata falnin namaz nafile (vullnetare) mes akshamit dhe jacisë. Ndërsa Hasani thoshte: ajo është Kijamul-lejli (namaz i natës).

Nga Hudhjeje r.a., i cili ka thënë: Prezantova (shkova) te Pejgamberi [sal-lallahu alejhi vese-l-em] dhe e fala me të (namazin e) akshamin, pastaj ai u fal deri në (namazin e) jacisë. Transmetoi Nisaiu me zinxhir (sened) të mirë.

Prandaj këto hadithe janë dëshmi për faljen e gjashtë rekateve apo njëzet rekate^{vi}.

-Hadithin që e shënon Imam Dhehebiu në veprën e tij "El-Kebair". "Se xheneti është nën këmbët e nënave"^{vii}. Këtë hadith e shënon Ibni Adij.

Transmeton Ibni Adij në "El-kamil" nga Musa Ibni Muhamed Ibni Ata, na ka treguar Ebu Melihi, na ka treguar Mej-muni nga Ibni Abbasi r.a., i cili ka thënë: I Dërguari i Allahut sal-lall-llahu alejhi vesel-lem ka thënë: "Xheneti është nën këmbët e nënave, ato kë dëshirojnë e futin (në xhenet) e kë dëshirojnë e nxjerrin (prej xhenetit)".^{viii} Ibni Adij ka thënë se Musa Ibni Muhamed Mekdisij është munkerul hadithi. Që të thotë se, ky hadith është mevdud apo ngjashëm (sikur) me hadithin mevdud^{ix}.

Mirëpo, këtë hadith e përforcon hadithi të cilin e transmetojnë Imam Ahmedi, Nisaiu dhe Ibni Maxheh me sened të mirë nga Xhahimete Eslemij.

Nga Muavijete Ibni Xhahimete se Xhahimeje kishte shkruar te Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem dhe i kishte thënë: O i Dërguari i Allahut, unë dëshiroj të luftoj, për këtë unë kam ardhur të konsultoj ty? (Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem) i kishte thënë: "Ti a ke nënë"? Po, ju përgjigj ai, i tha: "qëndro pranë saj, sepse xheneti është nën këmbën e saj". Transmeton, Ibni Maxheh, Nesaiu dhe kjo formë e shprehjes është sipas transmetimit të Nisaiut dhe Hakim-it, i cili ka thënë se ky hadith ka sahihul isnad.

Transmeton Taberaniu me zinxhir (sened) të mirë, ndërsa shprehja e tij është, ka thënë: shkova te Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem ta konsultoja për xhihad, Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi vesel-lem më tha: "Ti i ke dy prindërit"? Po, i thashë. Më tha: "Qëndro pranë tyre, sepse xheneti është nën këmbët e tyre."^x

Të mos besojë (të mos jetë i bindur) gjatë të vepruarit me të (me këtë lloj të hadithit) se, ai është vërtetuar, por të besojë se me atë vepron si masë preventive dhe rezervë.

Kështu, duhet të besojë me qëllim që

të mos i bashkëngjitet dhe të mos i vishet Pejgamberit a.s. diçka që nuk e ka thënë^x.

Me këtë kusht është për qëllim që të shtohet masa preventive dhe të ketë sa më shumë kujdes ndaj këtij lloji të hadithit, sepse, përndryshe, vepruesi me këtë lloj të hadithit veç e di dhe e ka të qartë se, ai është duke vepruar me hadith daif, prandaj çfarë nevojë ka, që t'i thuhet atij se, mos beso dhe mos u bind se ky është hadith i shih.^{xii}

Vepruesi me këtë hadith të mos e publikojë veprën e tij me të madhe në mesin e njerëzve.

Këtë kusht i pari dhe ndoshta i vetmi që e kushtëzon është Hafidh Ibni Haxher Askalaniu, ku në hyrje të veprës së tij "Tebjinul axhebi bima verede fi fadli re-xheb "ai këtë kusht e arsyeton duke thënë: "që të mos veprojë njeriu (personi) me hadith daif dhe kështu ai ligjëson (bënë ligj) diçka, që nuk është ligj. Ose këtë e shohin disa të padijshëm (xhahila) dhe ata mendojnë se ky veprim është sunnet sahih. Në këtë kontekst është prononcuar edhe profesori (dijetari) Ebu Muhamed Ibni Abdusalam^{xiii} dhe të tjerë. Personi (njeriu) le të ketë kujdes e të mos hyjë (futet, përfshihet) nën fjalën e Pejgamberit a.s.

"Kush transmeton (fol) ndonjë hadith nga unë, të cilin e sheh se është gënjeshtër, ai është njëri nga gënjeshtarët", prandaj si është gjendja e atij që vepron me të (hadithin e tillë)?! Nuk ka ndonjë dallim me të vepruarit me hadithin e dobët (daif) në dispozitat apo në vepra të mira, sepse të gjitha këto konsiderohen ligjësim^{xiv}.

Mirëpo, këtë kusht shumë nga dijetarët e refuzuan dhe e konsideruan si kusht të çuditshëm, sepse ky qëndrim bie ndesh me qëndrimin e shumicës së dijetarëve të hadithit, usulit dhe fikhut (jurisprudencës islame). Në anën tjetër, kjo nuk përputhet me realitetin praktik të përditshëm, sepse të vepruarit me hadithin daif shfaqet hap-tazi gjatë sjelljeve dhe veprimtarisë së vepruesit me atë hadith^{xv}.

Vepruesi me këtë hadith të mos besojë se është sunnet. Për këtë kusht dijetarët eminentë të shkencës së hadithit thonë se, nuk dimë se kush qëndron pas këtij kushti, respektivisht, cili dijetar kushtëzon me këtë kusht. Si demant për këtë kusht dijetarët shprehen se, dikush mund të thotë se, përse të veproj një vepër, kur nuk shpresoj prej saj ndonjë shpërblim, apo shpërblim për shkak braktisjes (lënien) së asaj vepre?^{xvi}

Hadith daif të mos jetë në kundërshtim me hadithin sahih. Edhe për këtë kusht dijetarët thonë se, nuk ka nevojë,

sepse është e qartë se, në ekzistimin e hadithit sahih nuk ka nevojë të veprohet me hadith daif; kjo është e qartë dhe nuk ka ndonjë nevojë për demant të këtij kushti. Në anën tjetër, dijetarët eminentë thonë se edhe për këtë kusht nuk dimë se kush qëndron pas tij^{xvii}.

Shënim: Përgjegjës për aplikimin dhe praktikimin e këtyre kushteve janë dijetarët (ar. ulemat), koleksionuesit e librave të hadithit (ar. muhaddithinët) dhe ata që mbajnë mësim, ligjërata dhe këshilla në mesin e njerëzve, por jo njerëzit e rëndomtë (avami), të cilët i lexojnë dhe i dëgjojnë këto hadithe. Kurse me shprehjen njerëz të rëndomtë, respektivisht avami, është për qëllim ata njerëz që nuk merren me shkencat e shariatit islam, edhe pse ai në ndonjë shkencë tjetër është i ditur, por në shkencat islame ai nuk ka njohuri; ky dhe njerëzit tjerë konsiderohen avam, personi i tillë dispozitat e shariatit duhet t'i pranojë prej dijetarëve, të cilët janë të specializuar në shariat. Prandaj dijetari i shariatit dhe i shkencës së hadithit duhet t'i aplikojë këto kushte, ai duhet të ketë kujdes, të shmangët dhe të heqë dorë nga hadithet mevdu, hadithet munker dhe hadithet shumë të dobëta. Ndërsa dispozita që mund të përfitohet nga këto hadithe të jetë në veprat e mira (fedailul-e'mali), kështu që ai që duhet të përmend me gojë e tij gjatë mësimave dhe këshillave dhe gjatë përpilimit të veprave të tij se, një hadith i tillë është i dobët, por në raste të tilla veprohet me të. Pastaj shtrohet pyetja se, dijetari a

duhet, respektivisht, a e ka obligim që avamit t'i tregojë se ky hadith është shumë i dobët? Përgjigjja është se, sipas shumicës së dijetarëve, respektivisht të atyre që lejojnë të veprohet me hadith daif, është se nuk është obligim që ai t'ua sqarojë dhe tregojë atyre. Kurse sipas disa dijetarëve, respektivisht të atyre që nuk lejojnë të veprohet me hadith daif, sipas tyre duhet që t'ua sqarojë dhe t'ua bëjë me dije.^{xviii}

(Punimi, në disa vazhdime, është temë diplome e autores në FSHI. Për botim është redaktuar nga Jusuf Zimeri.)

- ⁱ Imam Mundhiri, *Tergib ve Terhib*, Dar ihja turathul arabi, Bejrut 1388h-1968m, fq, 1/404.
- ⁱⁱ Tirmidhiu, 2/298, bab nr 321, nr, i hadithit 435.
- ⁱⁱⁱ Imam Mundhiri, *Tergib ve Terhib*, 1/404.
- ^{iv} Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 105.
- ^v Imam Mundhiri, *Tergib ve Terhib*, Dar ihja turathul arabi, Bejrut 1388h-1968m, fq, 1/404.
- ^{vi} Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 106.
- ^{vii} Shemsiddin Dhehebij, *Kitabul Kebair*, menshurat, daru kerem, Damask, 43.
- ^{viii} Ibni Adij Xhurxhani, Imam Hafidh Ebu Abdullah, *El-kamil fi duafair rixhali*, Darul fikri, Bejrut, 6/348.

- ^{ix} Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 106.
- ^x Imam Mundhiri, *Tergib ve Terhib*, Dar ihja turathul arabi, Bejrut 1388h-1968m, fq, 3/316.
- ^{xi} Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 106. Es-sujuti, Hafidh Xhelaluddin Abdurrahman, *Tedriburr-ravi fi sherhi tekribun-nevavi*, menshurat mektebetul ilmijje bil medinetil munevvere, 1392h- 1972m, fq, 196. Muhamed Axhxhaxh Hatib, *El-vevhiz fi ulumil hadith*, matbaatul xhedide, Damask, 1401-1402 / 1981-1982, fq, 325.
- ^{xii} Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 107.
- ^{xiii} Ka për qëllim dijetarin e njohur me nofkën Izz Ibni Abduselam Sulltanul ulemai.
- ^{xiv} Ibni Haxher Askalani, *Tebjinul axhebi bima vered fi fadli rexheb*, nashir, mueseetu kurtube, (në hyrje të veprës) fq, 19. Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 107.
- ^{xv} Muhamed Avvame, *hukmul ameli bil hadithid dai* bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 109.
- ^{xvi}Po aty, 109.
- ^{xvii}Po aty, 110.
- ^{xviii} Muhamed Avvame, *Hukmul ameli bil hadithid daifi*, bejnene dherijeti ve teybiki ve da'va, Darul juri darul minhaxhi, Medine Munevvere, 1438 h- 2017 m, fq, 74 dhe 107.



“NEVOJAT E DOMOSDOSHME I BËJNË TË LEJUARA SENDET E NDALUARA”



Shkruan: Seid Fejzuli (Enkas për Her)

Telfiku mund të aplikohet në çështjet dytësore, respektivisht, veprat e të obliguarve, të cilat janë të vërtetuara me argument jo të prerë, që nënkupton, ato çështje që mbi to dijetarët mes vete kanë kundërthënë. Kurse ato çështje që kanë të bëjnë me besimin (apologjetikën islame) dhe ato të cilat janë vërtetuar me argument të prerë, për çështjet e tilla nuk lejohet telfiku, respektivisht, ato çështje nuk janë objektivi i telfikut. Në akide (çështje të besimit) dhe në dispozitat të cilat janë vërtetuar me argument të prerë, jo vetëm që nuk lejohet telfiku, por ato nuk janë fushëveprim i ixhtihadit, kështu që në ato çështje nuk guxon të ketë kundërthënë, mbi të

cilën bazohet taklidi dhe telfiku.ⁱ

Telfiku klasifikohet sipas dy këndvështrimeve, edhe atë:

Telfiku në kundërshtim me ixhmanë dhe konform ixhmasë (konsensusit) - Telfiku në kundërshtim me ixhmanë siç kuptohet nga vetë emërtimi, këtu bëhet fjalë për grumbullimin e disa fetvave të medh'hebeve të ndryshme, të kundërta me njëra-tjetrën dhe nxjerrja si rezultat e një fetvaje të re. Ndërsa, konform ixhmasë, ku edhe në këtë rast, pas grumbullimit të disa fetvave, konkludohet një fetva e re, por që nuk bie ndesh me ixhmanë.

Telfiku në imitim dhe ixhtihad - Telfiku në imitim, këtu juristët e kanë përdorur termin në kuptimin e bashkimit të disa gjërave të ndryshme. Kurse metodologët e kanë përdorur në dy kuptime. Njëra prej tyre në fushën e ixhtihadit dhe

tjetra në fushën e imituesit. Prandaj, telfiku në imitim do thotë të grumbullim i mendimeve të ndryshme të medh'hebeve në lidhje me një temë të caktuar dhe t'i aplikosh ato. Kjo është praktikë e cila veprohet nga personat që nuk janë në gradën e muxhtehidit. Ndërsa, telfiku në ixhtihad realizohet kur një muxhtehid, duke u nisur nga dy fetva të ndryshme të mëparshme, nxjerr një fetva të tretë. Ky ixhtihad i përbërë, tashmë është fetvaja e tij.ⁱⁱ

Sipas qëndrimit të dijetarit bashkëkohor dr. Vehbeh Ez- Zuhajli, telfiku ka të bëjë vetëm me çështjet dytësore, të cilat ndahen në tri lloje:

Telfiku mbi bazën e lehtësimit dhe tolerancës - ky lloj telfiku ndryshon me ndryshimin e gjendjes së të obliguarit. Këtij lloji i takojnë ato dispozita, të cilat

janë adhurime, qofshin të plota apo financiare. Sa i përket adhurimeve të plota, lejohet telfiku në rast nevojë. Sepse motivi i këtyre adhurimeve është nënshtrimi i plotë ndaj Allahut (xh.sh), por në të njëjtën kohë nuk guxojnë që të obliguarit t'i shkaktojnë vështirësi të rënda. Gjatë aplikimit të tyre nuk duhet tepruar, sepse mund të shpie në shkatërrim. Kurse adhurimet materiale, në këto dispozita duhet të vepruar me atë që është më e shtrënguar dhe e rreptë me qëllim preventive, edhe atë duke pasur parasysh interesin e të varfërve dhe hallexhinjve, në mënyrë që lëshimi i tillë të mos jetë në dëm të tyre, andaj, personi i cili është i obliguar me ndonjë adhurim material (zekat apo sadaka), ai nuk duhet të veprojë me ndonjë qëndrim të dobët të ndonjë dijetari apo të marrë prej secilit medh'heb mendimin dhe qëndrimin, në mënyrë që të bëjë telfik, dhe kështu të dëmtojë të varfrin. Prandaj, myftiu dhe dijetari duhen të japin fetva me atë, që është më e sigurt dhe më e dobishme për të varfrin. Por, gjithsesi, myftiu duhet pasur në konsideratë gjendjen e personit, i cili kërkon fetva, se sa është i përpiktë dhe këmbëngulës në aplikimin e dispozitave të shariatit ose jo.

Telfiku në çështjet me të cilat ndërli-dhen me sendet e ndaluara - sende të cilat janë ligjësuar mbi preventivë dhe marrjen e asaj që është më e devotshme, që nënkupton se në çështjet të cilat në esencë janë të ndaluara, në këto dispozita dhe gjëra, në mënyrë maksimale duhet të veprohet ajo, e cila është më e sigurt dhe që tregon për devotshmëri. Allahu (xh.sh) nuk ka ndaluar ndonjë gjë vetëm për dëmin dhe të këqijat që i ngërthen ajo gjë. Andaj, për gjërat e tilla nuk vjen në shprehje toleranca apo telfiku, vetëm në raste domosdoshmërie, sepse nevojat e domosdoshme i bëjnë të lejuara sendet e ndaluara.

Telfiku në çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e përditshme - përfshijnë dënimet e përcaktuara, obligimet materiale, si dhe dhënia e zekatit dhe e tatimit. Po ashtu në lidhje me të drejtat familjare, që në esencë janë të ligjësuara me qëllim të arritjes së lumturisë së dy bashkëshortëve dhe pasardhësve të tyre. Sa i përket të drejtave familjare, çdo send i cili ndihmon dhe përforcon marrëdhëniet mes tyre, një kombinim i tillë lejohet të veprohet, por deri në atë masë që mos të manipulohet. Kurse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e përditshme, dënimet e përcaktuara, obligimet materiale, si dhe dhënia e zekatit dhe e tatimit, në këto dispozita kujdes duhet

t'i kushtohet interesit dhe dobisë së njerëzve; në këto dispozita lejohet të veprohet me qëndrimin e atij medh'hebi i cili është më i dobishëm, i cili njeriut i sjell lumturi edhe nëse bëhet ndonjë lloj telfiku.ⁱⁱⁱ

Pasi që telfiku ka të bëjë vetëm me çështjet dytësore, do të ndalemi vetëm te një lloj, që ka të bëjë vetëm me adhurimet e plota, edhe atë do të ndalemi në dy çështje.

MES'HI MBI ÇORAPE

Ekzistojnë debate dhe mendime të ndryshme në lidhje mbi çështjen e mes'hit mbi çorape gjatë marrjes së avdesit me qëllim të faljes së namazit.

Lejohet të bëhet mes'hi mbi çorape, nëse ato janë si ato të cilat kanë bërë mes'h gjeneratat e para të myslimanëve, gjegjësisht të jenë të shpeshta aq sa të mos mund të shihet se ç'ka nën to, të mund të kalohet një fersah e më shumë (një fersah llogaritet nga katër e deri në gjashtë km) pa këpucë dhe që e pengojnë depërtimin e lagështisë në këmbë. Janë të pakta çorapet që prodhohen sot e që u përgjigjen këtyre kushteve. Dikur çorapet janë punuar nga lëkura dhe janë futur në këmbë deri nën gjunj, por jo si meste. Ato janë thurur nga leshi i dredhur dhe janë veshur në këmbë deri te nyja. Imamët, ndërkaq, janë unanimitë se nuk lejohet të bëhet mes'h mbi çorape të holla të cilat janë të tejdukshme.^{iv} Sipas mendimit të katër imamëve, themelues të shkollave juridike (Ebu Hanifes, Malikut, Shafiut dhe Ahmedit), marrja e mes'hit mbi çorape ashtu siç praktikohet sot, është e ndaluar dhe çdo mendim ndryshe nuk është i saktë. Por, ata që përipiqen ta lejojnë mes'hin mbi çorapet e sotme, duke ndjekur vetëm epsheet vetjake, i shfrytëzojnë disa hadithe të cilat patjetër duhet t'i përmendim, me qëllim që të mos vijë deri të ndonjë huti në mesin e myslimanëve.

Transmetohet Mugire ibn Shu'be të ketë thënë: *“E kam parë të dërguarin e Allahut duke marrë avdes dhe duke dhënë mes'h mbi çorape.”* Mirëpo ky hadith nuk është argument për mes'hin mbi çorape nisur nga këto arsye:

En-Nesaiu në librin e tij “Sunen’ul Kubra thotë: “Nuk e njoh ndonjë njeri që ndjek Ebu Kajsini në këtë transmetim. E vërteta është ajo që e transmeton Mugire me sened transmetuesish autentik se i dërguari i Allahut u ka dhënë mes'h mesteve.” Këtë hadith e përmend dhe El-Bejhëkiu dhe se është i papranueshëm.

En-Nesaiu në librin e tij “Sunen’ul Kubra thotë: “Nuk e njoh ndonjë njeri që ndjek Ebu Kajsini në këtë transmetim. E vërteta është ajo që e transmeton Mugire me sened transmetuesish autentik se i dërguari i Allahut u ka dhënë mes'h mesteve.” Këtë hadith e përmend dhe El-Bejhëkiu dhe se është i papranueshëm.

Gjithashtu, Sufjan Eth-Thevriu, Abdurahman ibn Mehdiu, Ahmed ibn Hanbeli, Jahja ibn Me'ini, Ali ibn El-Medini dhe Muslim ibn Haxhaxhi thonë se është i njohur hadithi i Mugires për mes'hin mbi meste, por jo edhe për mes'hin mbi çorape. Prandaj, vlen të theksohet se asnjë nga juristët myslimanë nuk e ka lejuar mes'hin mbi mbi llojet e çorapeve që përdoren sot, për një arsye fare të thjeshtë - kurse kjo është pamja e çorapeve në kohën e të dërguarit të Allahut. Ajo që quhej çorap në kohën e të dërguarit të Allahut do të shërbente si këpucë në kohën e sotme. Që diçka mund ta quajmë çorap, do të duhej të ishte e tillë që me të së paku të mund të ecej një rrugë prej katër kilometrash.^v

MENDIMI I JURISTËVE

Imam Ebu Hanife ka thënë: “Lejohet mes'hi mbi çorape vetëm nëse janë të mbuluara me lëkurë.”

Nxënësi i tij Ebu Jusufi dhe Muhammedi konsiderojnë se lejohet mes'hi mbi çorape të qepura me lëkurë dhe mbathëset të qepura me lëkurë, kurse janë ndarë në mendime se a mund të bëhet mes'h tek çorapet e bëra në mënyrë të vrazhdë dhe fortë të bëra.

Imam Ahmedi dhe Imam Shafi: “Konsideroj se çorapet duhet të jenë të atilla që nuk e lëshojnë dot ujin dhe të ketë mundësi që me ta të ecet në mënyrë normale si dhe të qëndrojnë vetvetiu në këmbë pa lidhëse.”

Imam Maliku: “Konsideroj se çorapet duhet të jenë prej lëkure, ashtu që të duken sikurse mestet.”

Muhammed Jusuf El-Benuri thotë: “Të gjithë imamët kanë pranuar se lejohet mes'hi mbi çorape që janë të bërë nga lëkura. Ata në të njëjtën kohë pranuan se nuk merret mes'hi mbi çorape të holla dhe të tejdukshme, ndërsa nuk janë të një mendimi se a mund të merret mes'hi mbi çorapet e forta dhe të ngurta.” Ndërsa, Imam Es'ad Muhammed b. Seid Sagirxhi në librin e tij *El Fikh'ul-hanefij ve edilletuhu* thotë: “Mes'hi mbi çorapet e holla nuk është i lejuar, sepse në traditën e selefite (gjeneratat e para të Islamit) çorapet nuk janë përdorur për ngrohjen e këmbëve, por për shëtitje, sikur që ne sot i përdorim këpucët.”^{vi}

MENDIMI I DIJETARËVE

Sipas dijetarit bashkëkohor Jusuf el-Kradavit, lejohet t'u jepet mes'h çorapeve nëse vishen në gjendje të pastër, dhe



nëse avdesi prishet duke i pasur çorapet të veshura dhe dëshiron të marrë avdes, në këtë rast lejohet që ai t'u jap mes'h çorapeve. Kjo i mjafton atij brenda njëzet e katër orëve nëse është vendas, mirëpo nëse është në udhëtim, atëherë tre ditë. Kjo çështje ua lehtëson njerëzve avdesin sidomos gjatë ditëve të ftohta të dimrit, me ç'rast të ftohtit është i ashpër e njeriu frikësohet t'i zbatë çorapet për t'i larë këmbët me ujë të ftohtë. Islami siç dihet është fe e lehtësimit dhe jo e vështirësive. Prandaj dijetari mysliman duhet të ketë në konsideratë kohën në të cilën jeton - t'ua lehtësojë e jo t'ua vështirësojë çështjet për të cilat ekziston hapësirë lehtësimi.

Arsyet e lejimit:

Lehtësimi është shpirti i këtij legjislacioni. Ku Allahu në ajetin mbi pastrimin thotë: **“Allahu nuk dëshiron (me obligimin për avdes e larje) t’ju sjellë ndonjë vështirësi, por dëshiron t’ju pastrojë (prej mëkateve), t’ua plotësojë të**

mirën e Tij ndaj jush e që t’i falënderoheni.”^{vii} Arsye tjetër e lehtësimit është edhe ajo se njerëzit jetojnë në një kohë në të cilën janë shtuar tronditjet; ai që aplikon sot normat fetare, është si në pozitën e atij që është kapur për gacën. Pra, obligimi ynë është të ju ndihmojmë njerëzve për ta aplikuar fenë, e jo t'i largojmë nga feja, sepse vështirësimi i largon, ndërsa lehtësimi ua lehtëson dhe i afron sa më afër saj.^{viii}

Sipas fetvasë së lëshuar nga Qendra për fetva në Egjipt me numër 719, thuhet: “Lejohet te të gjithë dijetarët mes'hi mbi çorapet nëse janë të lëkurës dhe mundet të ecet me to, e që të njëjtat i ka veshur në pastërti (me avdes); kjo fetva ka për bazë hadithin e Mugire ibnu Shub'bes të lartpërmendur. Dijetarët kanë bërë lidhje mes hadithit që transmetohet për çorapet dhe haditheve për mes'hin mbi meste, ku i kanë kushtëzuar të njëjtat kushte që i kanë për mestet. Mirëpo, disa dijetarë të drejtimit hanbeli të mëvon-

shëm, si Kasimi dhe Ahmed Shakir, e kanë marrë kuptimin e hapur të tekstit dhe kanë lejuar mes'hin mbi çorape pavarësisht cilësisë së tyre. Nga kjo që u tha vijmë në përfundim se: Ndalohet mes'hi mbi çorape të holla nga shumica absolute e dijetarëve, kurse e lejon vetëm një pakicë e tyre. Dhe si përfundim del se: te çorapet e kohës sonë nuk lejohet mes'hi mbi çorape, e ata që e bëjnë këtë, veprojnë në kundërshtim me atë që shumica absolute e dijetarëve të të gjitha kohërave e kanë kuptuar nga argumentet se është e ndaluar.^{ix}

DISTANCA MIDIS KËMBËVE NË NAMAZ

Një çështje e cila diskutohet në mesin e myslimanëve është edhe ajo e mënyrës së qëndrimit në namaz me këmbë të zgjeruara, në mënyrë që namazlinjtë të prekin këmbët e njëri-tjetrit apo të mos i

prekin fare, por t'i zgjerojnë këmbët gjatë namazit në një distancë prej katër gishtave? Pyetjet e kësaj natyre i ngatërojnë shumë njerëz, të cilët do të dëshironin të dinin mënyrën e saktë të qëndrimit në namaz sipas Sunnetit.^x Në lidhje mbi distancën midis këmbëve në namaz, konkretisht për këtë si argument kemi përzgjedhur hadithin e Pejgamberit (alejhis-selam), i cili iu drejtua njerëzve një ditë:

“Ose keni për t'i drejtuar rreshtat, ose Allahu ka për ta futur në mesin tuaj kundërshtimin.”^x

Mendimi i shkollës hanefite: Sipas mendimit të shkollës hanefite për çështjen e pozitës së këmbëve në namaz, kemi dy mendime. Mendimi i parë thotë se besimtari gjatë namazit këmbët i hap në distancë prej katër gishtave. Këtë mendim e hasim tek Imami Hanefit Ibn Abidini në veprën e tij Ed-Durr'ul-muhtar, ku thotë: “Distanca mes këmbëve të besimtarëve në namaz do të duhej të ishte katër gishta të dorës, sepse kjo distancë është mjaft efikase në aspekt të rënditjes dhe përlulesisë që kërkohet në namaz.” Ndërsa, mendimi i dytë sipas metodës së tyre mund të kuptohet nga vijuesija. Në veprën Mearifus-sunen shpjegim mbi sunenin e Tirmidhiut të dijetarit të vonshëm të hadithit Imam Jusuf Binnurit, thuhet se nuk ceket dhe nuk ka përcjellje autentike të hadithit për distancën e vërtetuar ndërmjet këmbëve të veta të besimtarit gjatë namazit. Nga ky shkak do të mund të përfundohet se metoda sunetike e pozicionimit të këmbëve në namaz është e tillë aq sa besimtari në namaz e konsideron të përshtatshme dhe të këndshme.^{xii}

Mendimi i shkollës shafi'ite: Sipas mendimit në përcaktimin e Shafi'ut lidhur me këtë çështje, studimi i vëmendshëm i literaturës së kësaj shkolle juridike zbulon se si mendimi i tyre më i pranishëm është që besimtari duhet t'i mbajë këmbët e veta në distancë prej një dore. Megjithatë, në veprën El-Envar, një vepër e fikhut shafi'it, rekomandohet se distanca duhet të jetë vetëm katër gishta – sikur edhe në mendimin hanefit. Më tej imami i madh shafi'it, Imam Neveviu, përfundon: “Është jo e pëlqyeshme (mekruh) që këmbët të ngjiten në namaz; është më mirë (mustehab) të mbahet një distancë ndërmjet këmbëve.” Në total kemi tre mendime të ndryshme të shkollës shafi'ite për këtë çështje: distanca e barabartë me një shuplakë prej katër gishta të dorës dhe sipas vlerësimit të lirë, aq sa besimtari e vlerëson të nevojshme. Mendimi i parë është specifik për shkollën

lën shafi'ite, derisa mendimi i dytë dhe i tretë janë të përbashkëta për shkollën shafi'ite dhe hanefite. Deri tash mund të vërejmë fleksibilitetin e shkollës hanefite lidhur me këtë çështje. Ku sipas tyre besimtarit i lejohet të qëndrojë në namaz me distancë të njëjtë të këmbëve apo më së shumti se katër gishta. Ndërsa, tek shafi'itët vërejmë se nuk ka asnjë mendim që përmend bashkimin e këmbëve mes namazlinjve. Nëse kjo njëmend është mënyra e drejtë dhe sunetike e qëndrimit në namaz, pa dyshim si e tillë do të pranohet.^{xiii} Ata që këmbëngulin në bashkimin e këmbëve nuk e kanë kuptuar domethënien e drejtë të hadithit dhe kështu nuk kanë kurrfarë prove të fortë për ta argumentuar qëndrimin e tyre. Prandaj, metoda e mirëfilltë sunetike do të ishte që të krijohet hapësirë përafërsisht katër gishta mes këmbëve të veta, ose çfarëdo distance nëpërmjet së cilës besimtaritari mund të arrijë qëndrim komod dhe koncentrim në namaz.^{xiv}

Andaj, telfiku vjen në shprehje kur e kryejmë një vepër në atë mënyrë dhe formë, të cilën nuk lejon asnjëri prej medh'hebeve (shkollave juridike islame). Format dalluese që më së shumti e identifikojnë sot mënyrën e telfikut, është në çështjet praktike dhe dytësore. Sot e kemi për obligim të jemi imitues i një shkolle juridike apo medh'hebi. Sipas katër shkollave juridike (mendimit të juristëve) dhe mendimit të dijetarëve, mes'hi mbi çorapet është i ndaluar dhe nuk e plotëson avdesin. Por, sipas tyre mes'hi mbi çorape lejohet në rastet vetëm si lehtësim për personin në qoftë se i plotëson kushtet çorapi për mes'h. Mirëpo, mendimet dhe pretendimet e disa dijetarëve dhe të disa të ashtuquajtur shejhë të xhema-teve, apo thënë më mirë të disa grupacioneve, sipas shumicës së dijetarëve mendimet dhe pretendimet e tyre janë të pabaza dhe nuk ka nevojë për ndjekje pa arsyetim, sepse mendimet e tilla krijojnë huti dhe një adhurim i tillë është i pavlefshëm. Në lidhje mbi distancimin e këmbëve në namaz, sipas Ebu Hanifes dhe Shafiut ka përshtatshmëri në çështjen e qëndrimit të falësit në namaz. Mirëpo, dispozita sipas tyre dallon. Sipas Ebu Hanifes distancimi i këmbëve në katër gishta është sunnet, ndërsa sipas Imam Shafiut është mustehab. Por, thelbi është se ekziston fleksibiliteti në qëndrimin e këtyre shkollave dhe kjo nuk krijon huti.

(Autori ka kryer Fakultetin e Shkencave Islame. Është edukator në Medresenë Isa Beu në Shkup. Jeton në Sllupçan, Kumanovë)

LITERATURA & BURIMET

IBRAHIMI, Nexhat. *Fjalor enciklopedik islam*. Logos-A. Shkup, 2017.

MEDH'HEBI Hanefij, *prioritetet dhe sfidat: konferencë shkencore*. Bashkësia Fetare Islame e R. së Maqedonisë. Shkup, 2017.

BISLIMI, Taxhedin. *Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut*. Shkup, 2018.

MUSALLARI, Rushit. *Fikhu praktik*. Shoqata Kulturore Ardhmëria, Tiranë, 2016.

MAHMUD TUHMAZ, Abdulhamid. *Fikhu hanefi*, 1. “Fondacioni i Rinisë Islame” Zurich, 2011.

XHEKO, Sami. *Udhëzime praktike akaidore dhe fikhere: (hanefij-maturidi)*. Përktheu Nexhat Ibrahim. Bashkësia Fetare Islame e R. së Maqedonisë. Shkup, 2011.

KARDAVI, Jusuf. *Fetva bashkëkohore, 1*. Furkan-ISM. Shkup, 2015.

ABDUR-Rahman ibn Jusuf. *Provat kyç të fikhut hanefi*. Përktheu nga gjuha boshnjake Nexhat Ibrahim. Logos-A. Shkup, 2016.

SULEJMAN, Ebu Davud. *Suneni i Ebu Davudit, 1*. Autor El-Imam El-Hafidh, Ebu Davud, Sulejman Ibn El-Esh'ath Es-Sixhistani El-Ezdi; nga arabishtja: ABAZI, Irfan; EBIBI, Faredin; ZIMERI, Jusuf; BISLIMI, Taxhedin. “Furkan ISM” Shkup, 2015.

www.lexoedheti.com

ⁱ Taxhedin Bislmi. *Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut*. Shkup, 2018, faqe 144.

ⁱⁱ Elton Karaj. *Mehdhebi hanefij, prioritetet dhe sfidat*. Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë. Shkup, 2017, faqe 44/46.

ⁱⁱⁱ Taxhedin Bislmi. *Hyrje në shkencën e Usuli Fikhut*. Shkup, 2018, faqe 145/146.

^{iv} Abdulhamid Mahmud Tuhmaz. *Fikhu Hanefi, 1*. “Fondacioni i Rinisë Islame” Zurich, 2011, faqe 126

^v Sami Xheko. *Udhëzime praktike akaidore dhe fikhere (hanefij-maturidij)*. Bashkësia Fetare islame e R. Maqedonisë – Shoqata “Ilmije”. Shkup, 2011, faqe 140/141.

^{vi} Po aty. faqe 141/142.

^{vii} El-Maide, 6.

^{viii} Jusuf Kardavi. *Fetva bashkëkohore, 1*. Furkan-ISM, Shkup, 2015, faqe 194.

^{ix} Lexo edhe ti: *mes'hi mbi çorape.lexoedheti.blogspot.com*

^x Abdurrahman Ibn Jusuf. *Provat kyç të filhut hanefi*. Logos-A. Shkup, 2016, faqe 73.

^{xi} Ebu Davudi. *Suneni i Ebu Davudit, 1*. “Furkan ISM” Shkup, 2015, faqe 321, nr. 658.

^{xii} Po aty. faqe 74/75.

^{xiii} Po aty. faqe 76.

^{xiv} Po aty. faqe 81-82

DËNOHET SULMI MBI IMAMIN E XHAMISË SË LUPÇIT

Dënojmë me ashpërsinë më të madhe sulmin mbi Imamin e Xhamisë së fshatit Lupç, komuna e Podujevës, Zeqir ef. Berisha, thuhet në njoftimin e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) të datës 22 korrik, 2022.

Sulmi mbi Imamin në hapësirat e Xhamisë, në vendin e tij të punës, është akt i papranueshëm, madje, përveç se sulm mbi Imamin, është edhe atak mbi xhaminë dhe xhematin e respektuar.

Imami është autoriteti më i lartë fetar në xhematë, prandaj atakimi i tij është atakim i vlerave dhe i misionit që përfaqëson ai, e në këtë rast është edhe atak mbi Bashkësinë Islame të Kosovës.

Ne e mbështesim Imamin e respektuar dhe i qëndrojmë afër dhe nga xhemati kërkohet që të distancohet nga autorët e sulmit, ndërsa nga organet e drejtësisë kërkohet që të marrin vendimet e duhura, sepse është sulmuar Imami – autoriteti zyrtar fetar në vendin e tij të punës, si dhe është atakuar hapësira e Xhamisë, e cila është e dedikuar për lutje e ibadete, thuhet në njoftimin e

Kryesisë së Bashkësisë Islame të Ko-



sovës.

Siç raportohet, Imami ka marrë lëndime të rënda, me gjakderdhje në kokë dhe dëmtime në fytyrë. Imami po trajtohet në Klinikën e Neurokirurgjisë në Prishtinë, pas rrahjes së rëndë nga tre vëllezërit Murturi dhe vazhdon të jetë në gjendje të rëndë shëndetësore.

“Rasti ka ndodhur pas namazit të jamicisë, më 21 korrik”, ka shkruar gazeta

“Nacionale”. Imami është 61-vjeçar. Ai u kthye nga Vlora e Shqipërisë për të shërbyer në Kosovë. Por, në kryerjen e punës në vendlindje, Imami hasi në shumë vështirësi. Sfidat e punës për të ishin aq të mëdha, sa që desh i morën edhe jetën. Hoxhë Zeqir Berisha kishte 10 vite që i printe xhematit në fshatin Lupç të komunës së Podujevës, ka shkruar gazeta “Nacionale” (Nacionale.com).

SHPREHJE TË RREZIKSHME



Shprehjet islamofobe si: "shkoni n'Anadoll, shkoni n'Arabi", që na thuhet neve shqiptarëve myslimanë nga islamofobë të ndryshëm, nuk janë as të rastësishme, as veç të sotme. Në fakt, janë pjesë e fjalive bazë të platformës serbo-sllave për shpërnguljen me dhunë të shqiptarëve nga trojet e tyre.

Këto fjalë, dhe të ngjashmet si këto, janë të pasqyruara qartë në memorandumet famëkeqe të Ilija Garashaninit (1812-1874) dhe të Vaso Çubrilloviqit (1897-1990). Për më tepër, janë fryma serbe e implementuar përmes bajonetave, pushkëve, mitralozëve dhe tankeve për dëbimin dhe shfarosjen e shqiptarëve.

Metodat dhe fytyrat e njerëzve mund të ndryshojnë, por synimet dhe qëllimet janë të njëjta.

Prandaj, bëni kujdes! Mos i merrni aq të thjeshta këto fjalë. Janë me plot përmbajtje dhe me programe të punuar mirë. Janë shumë të rrezikshme.

Një nga rapsodët e njohur dikur kështu e përshkruante ultimatumin vrastar të Nikolla Pashiqit drejtuar shqiptarëve: ...qe dy udhë ku tek i ki ndaç n'Turki, ndaç n'Albani...!

(Mustafë Bajrami, Prishtinë/në bashkëpunim)

IDEJA E PANSLAVIZMIT, NJË NGA QËLLIMET RUSE

Në Ballkan, para dhe pas Revolucionit të Tetorit, historikisht Rusia ka pasur tre interesa kryesorë: strategjikë, kulturorë dhe fetarë. Është e rëndësishme këtu të theksohet një fakt që Rusia së bashku me shtetet e Evropës Perëndimore morën pjesë në procesin e modernizimit të kombeve dhe shteteve të Ballkanit dhe të Evropës Lindore që nga fillimi i shekullit XIX e deri në Luftën e Dytë Botërore. Pa dyshim se më tej politikën strategjike të Fuqive të Mëdha në Ballkan u bënë pjesë e politikave shtetërore dhe lokale për pavarësi nga Austro-Hungaria dhe Perandoria Osmane.

Shkruan: Dr. Selim Ibraimi

Ballkani Perëndimor historikisht ka qenë një nga pikat kryesore të politikës së jashtme ruse, ndikimeve politike, fetare, dhe përpjekjeve për propagandë. Të gjitha tendencat ruse në të kaluarën janë transformuar në forma të reja të ndikimit dhe janë bërë aktuale sot me ardhjen në pushtet të presidentit Vlla-

dimir Putin. Kur Rusia e humbi Luftën e Krimesë të viteve 1853-1856, ajo e shpejtoi ndikimin e saj fetar dhe diplomatik në rajonin e Ballkanit jugor për qëllime të nxitjes së rivalitetit gjeopolitik me Habsburgët dhe atyre Osmane, me qëllim të përhapjes së idesë së pansllavizmit në Ballkan. Sidoqoftë, Lufta e Krimesë ishte në thelb lufta e Londrës kundër Rusisë, me qëllim që të parandalonin fitoret e

mëtejshme ruse kundër Perandorisë Osmane. Pas kësaj lufte u bë e qartë për Rusinë që Fuqitë e Mëdha të Evropës Perëndimore janë armiqtë e saj, veçanërisht Britania e Madhe. Do të duhen edhe 50 vjet të tjera që Rusia të nënshkruajë një marrëveshje ushtarako-politike me Londrën në vitin 1907, vetëm pas një ndarjeje përfundimtare të sferave të ndikimit në Persi. Rivaliteti politik dhe ekonomik




midis Rusisë nga njëra anë, Habsburgëve nga viti 1867 dhe Perandorisë gjermane nga viti 1871 nga ana tjetër për ndikim në Ballkan, u prekën fuqimisht në Rusi nga rritja e ndjenjës pansllave e bazuar në origjinën e përbashkët sllave, dhe mbi të gjitha ishte e bazuar në ndjenjën emocionale për të çliruar sllavët e jugut që ishin nën zgjedhën e Perandorisë Osmane.

Në Ballkan para dhe pas Revolucionit të Tetorit, historikisht Rusia ka pasur tre interesa kryesorë: strategjikë, kulturorë dhe fetarë. Është e rëndësishme këtu të theksohet një fakt që Rusia, së bashku me shtetet e Evropës Perëndimore morën pjesë në procesin e modernizimit të kombeve dhe shteteve të Ballkanit dhe të Evropës Lindore që nga fillimi i shekullit XIX e deri në Luftën e Dytë Botërore. Pa dyshim se më tej politikën strategjike të Fuqive të Mëdha në Ballkan u bënë pjesë e politikave shtetërore dhe lokale për pavarësi nga Austro-Hungaria dhe Perandoria Osmane.

Nga pikëpamja strategjike, diplomacia ruse e konsideroi Ballkanin si thelbësorë për sigurinë e shtetit rus dhe mbi të gjitha për stabilitetin e kufijve të shtetit rus. Synimi i Rusisë ishte të siguronte një kufi të favorshëm në Moldavi dhe të kishte një kontroll mbi ngushticën e Bosforit dhe të Dardaneleve, të cilat u bënë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik rus dhe projektet gjeopolitike në veçanti për dërgimin e grurit dhe të misrit nga Ukraina e sotme në tregjet ndërkombëtare. Ngushtica e Bosforit dhe e Dardaneleve u bënë një pjesë e "zonës së sigurisë" së Rusisë në aspektin ekonomik dhe politik.

PROPAGANDA DHE SHQETËSIMI KRYESOR I RUSISË

Shqetësimi kryesor i Rusisë ishte të mbronte kalimin e lirë të flotës ruse përmes ngushticës së Bosforit në Detin Mesdhe, drejt Atlantikut. Njëkohësisht, Rusia synonte të bllokonte zgjerimin e Fuqive të tjera të Mëdha evropiane, veçanërisht të Austro-Hungarisë dhe të Gjermanisë në rajon, por veçanërisht në pjesën lindore të Evropës. Duke marrë në konsideratë aspektet fetare dhe kulturorë të interesave ruse në Ballkan dhe në Evropën Lindore, kryesisht për shkak të propagandës pansllave, Rusia arriti të zhvillojë që nga vitet 1870, 1917 e deri në vitin 1945 një politikë aktive për fatin e sllavëve të Ballkanit. Pansllavizmi i bazuar në mitin e solidaritetit dhe kryesisht mbi reciprocitetin ortodoks, krijoi një ndjenjë të fortë etnike, fetare dhe kultu-



Dokumenti 1. Rritet mbështetja për Titon gjatë mosmarrëveshjeve me Stalinin. <https://www.cia.gov/library/readingroom>

rore midis popullatës ortodokse sllave të Ballkanit. Kjo vijë ndaj Ballkanit u bë aktive pas Revolucionit të Tetorit, si një nga forcat drejtuese mbizotëruese të politikës ruse në Ballkan. Miti i solidaritetit dhe vëllazërimit ushtroi një ndikim të konsiderueshëm në shumë intelektualë dhe qarqe të rajonit dhe pa dyshim se gjeti mbështetje në rrethet zyrtare në Rusi, Serbi, Mal të Zi dhe Bullgari, e sidomos pas çlirimit të Bullgarisë nga Rusia në vitin 1878 dhe pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Historikisht Rusia cariste po përpiqej gjatë gjithë kohës për të pajtuar kombet sllave në konflikte. Ndo-

shta rasti i konfliktit serbo-bullgar në vitet 1912-1915 mbi çështjen maqedonase, është shembulli më i mirë i politikës së tillë ruse të pansllavizmit. Interpretuar ndryshe, Rusia u bë krijuesi i "Traktatit serbo-bullgar" të vitit 1912 dhe ndërmjetësi kryesor në konfliktin diplomatik të viteve 1912-1913 midis Serbisë dhe Bullgarisë për fatin e Maqedonisë gjatë Luftërave Ballkanike. Politika e jashtme ruse ndaj Ballkanit në këtë rast ishte pansllave, pasi Shën Petersburgu dëshironte të kënaqte pretendimet territoriale të dy palëve me marrëveshje diplomatike midis Serbisë dhe Bullga-

risë. E njëjta situatë vazhdoi me konsolidimin e shtetit rus pas vitit 1918 dhe përhapjen e komunizmit në Ballkan nga viti 1918 deri në përfundimin e LDB-së.

Platforma tjetër gjeopolitike ruse, e quajtur Federata Ballkanike, ishte një projekt për krijimin e një konfederate ballkanike, e mbështetur kryesisht në idetë e majta politike. Koncepti politik i një federate ballkanike doli në fund të shekullit XIX nga forcat e majta politike rajonale. Qëllimi parësor ishte krijimi i një uniteti politik të ri që e bashkon Gadishullin Ballkanik në bazë të ndërkom-bëtarizmit, socializmit, solidaritetit dhe barazisë ekonomike. Vizioni themelor i federatës qëndronte pavarësisht dallimeve midis popujve të Ballkanit. Ky koncept politik rus kaloi në tre faza të zhvillimit të tij. Në fazën e parë ideja u artikulua si përgjigje ndaj rënies së Perandorisë Osmane në fillim të shekullit XX. Në fazën e dytë, kryesisht gjatë periudhës së konfliktit 1919–1936, ideja e Federatës së Ballkanit ishte pjesë ideologjike e partive komuniste të Ballkanit. Faza e tretë karakterizohet nga përplasje midis udhëheqësve komunistë të Ballkanit dhe drejtuesit komunist Josif Stalin.

Ashtu siç theksuam, ideja për një federatë të shteteve të Ballkanit është e vjetër, duke marrë parasysh që pas vitit 1919 e sidomos pas Revolucionit të Tetorit, nga Internacionalja Komuniste me seli në Moskë u miratua një koncept ideologjik socialist rus që popujt ballkanikë duhet ta praninin si një vlerë e ardhmërisë së tyre. Qëllimi i federatës u ringjall gjatë fazës së parë pas LDB-së, disi me ironi nga qeveritë greke dhe jugosllave në mërgim, me thirrje të rezervuar të Britanisë së Madhe që kërkonte një garanci të fuqishme kundër një rreziku eventual bolshevik dhe e cila kërkesë u refuzua nga BRSS në konferencën e ministrave të jashtëm në Moskë gjatë tetorit të viti 1943, si një përpjekje për të vendosur një kufi të ri rreth BRSS-së dhe për të parandaluar sovjetikët drejt kufijve të skajshëm lindorë të Perëndimit.

Gjatë vitit 1943 dhe 1944, projekte të ngjashme diplomatike, por me një motiv shumë të ndryshëm, u rritën nga dinamika e rezistencës partizane të drejtuar nga komunistët drejt vendeve të Ballkanit. Me miratimin e një shkalle autonome për “Komitetin Rajonal Maqedonas” të rezistencës në vjeshtën e vitit 1942, Josif Broz Tito mund të kishte pasur në plan krijimin e Federatës Ballkanike dhe përfshirjen e një Maqedonie nën sundimin jugosllav, e cila u bë realitet në fund të vitit 1945. Në shkurt të vitit 1943 Sve-

tozar Vukmanoviq-Tempo arriti në Maqedoni si i dërguari special i Titos, i cili frymëzoi themelimin e një “Partie Autonome Komuniste Maqedonase” dhe nxiti gjithashtu krijimin e një “Shtabi të Përgjithshëm Ballkanik” për të bashkuar lëvizjet e rezistencës së rajonit. Tempo ndërtoi një marrëveshje të 20 qershorit të vitit 1943, e nënshkruar nga drejtuesit e Partive Komuniste Jugosllave, Greke dhe Shqiptare, të cilët premtonin bashkëpunim të ndërsjellë në mbledhjen e 12 korrikut të vitit 1943, në një angazhim për të ndërtuar një seli të përhershme të Ushtrisë Çlirimtare Popullore të Ballkanit si embrioni kryesor ushtarak i një konfederate të ardhshme ballkanike.

Nisma e Svetozar V. Tempos mbërriti në një kohë kur vrulli i luftës ushtarake kundër Boshtit po ndryshonte shpejt. Midis janarit dhe korrikut të vitit 1943, partizanët jugosllavë i luftuan ashpër ofensivat gjermane në Bosnjë e Hercegovinë. Në frontin tjetër në “Betejën e Kurskut”, në korrik të vitit 1943, forcat e armatosura sovjetike i shkaktuan humbje të madhe ushtrisë gjermane “Vermahtit” dhe më 25 korrik të vitit 1943 qeveria e Benito Musolinit ra në Romë.

Ndërkaq, në frontin jugor ballkanik qëllimet e Tempos dhe të sovjetikëve dukeshin të ndërhuara në atë mënyrë për të kontribuar me forca në frontin lindor rus. Marrëveshjet ishin formale, dhe pasi situata ushtarake në Ballkan mbeti pezull, në seancën e 12 korrikut të vitit 1943 çështja maqedonase ishte shfaqur tashmë si një burim përçarjeje në mes forcave të majta komuniste. Mbi të gjitha, sponsorimi i jashtëm diplomatik mungonte për çështjen e re maqedonase dhe nuk vonoi shumë kur më 22 maj të vitit 1943 sovjetikët njoftuan shpërbërjen e Internacionales Komuniste, si një gjest tërheqës në Perëndim, duke dashur të fshehin qëllimet afatgjata se kinse Moskë nuk kishte synime për të ringjallur spektrin e komunizmit ushtarak ndërkom-bëtar. Strategjia ruse ishte mjaft e dukshme për amerikanët dhe britanikët, të cilët kishin frikë nga ndarja e mundshme e Evropës pas përfundimit të LDB-së.

Megjithatë, kjo duket se ishte një taktizim i ri i sovjetikëve deri në përfundim të LDB-së, ku Moskë filloi një ofensivë të fshehur në Ballkan për të mbajtur këtë territor nën thundrën sovjetike. Krijimi i një “federate të vogël” në Ballkan në një nivel ushtarak në luftën kundër fashizmit dhe nazizmit, nuk i përgjigjej politikës së Josif Stalinit. Nga ana tjetër, më 21 shtator të vitit 1943, duke zgjedhur për t’u dhënë përparësi marrëdhënieve me brita-

nikët, me të cilët partizanët e Titos kishin krijuar lidhje zyrtare, oficeri ndërlihdës i inteligjencës ushtarake britanike Fitzroy Maclean arriti në selinë e Titos në shtator të vitit 1943. Më pas Tito e njoftoi Tempon se qëllimi i një federate të popujve të Ballkanit ishte vetëm një parullë dhe propagandë, dhe e urdhëroi atë të ndërpresë negociatat për një komandë të unifikuar të Ballkanit.

Me gjithë këtë tërheqje strategjike dhe pas shpine të komunistëve jugosllavë, Josif Broz Tito përsëri e inkurajoi Tempon të forcojë marrëdhëniet me forcat e rezistencës greke dhe bullgare, dhe në një seancë të 16-18 tetorit të vitit 1943 Byroja Politike e Partisë Komuniste të Jugosllavisë (BP-PKJ) bëri publik qëllimin e “Federatës së Sllavëve të Jugut” dhe në raportin e tij për seancën, komunisti Millovan Gjillas evokoi një bashkim federativ të popujve sllavë të jugut.

Lufta e Dytë Botërore solli ndryshime dramatike në raportet mes forcave aleate dhe sovjetikëve. Çlirimi rus i Ballkanit pati një ndikim të madh në politikën e pasluftës në Evropën Juglindore. Kundërshtarë të partive komuniste në Ballkan kishin shpresuar se forcat aleate perëndimore do të zbarkonin së pari në gadishull, por këto shpresa u thyen nga uljet e fuqive perëndimore në Itali dhe Normandi.

Konferenca e Jaltës e vitit 1945, e Dresdenit 1945, e Teheranit 1943 në mes Fuqive të Mëdha, dhe e fundit e organizuar në Uashington D.C. mes amerikanëve dhe anglezëve, e definuan qartë kontinentin evropian dhe ardhmërinë e Ballkanit. Çerçili deri në fund të vitit 1944 e përdori Ballkanin si një pazar të negociatave në përpjekjet e tij për të siguruar një marrëveshje më të mirë me Josif Stalinin.

Nën propozimin e kryeministrit britanik u ra dakord që Rusia të kishte ndikim mbizotërues në Rumanë dhe në Bullgari, ndërsa Perëndimi do të gëzonte të njëjtën status në Greqi.

Jugosllavia dhe Hungaria duhej të ndaheshin në mënyrë të barabartë, ndërsa Shqipëria nuk u përmend në bisedimet për të ardhmen e Evropës Lindore dhe të Ballkanit.

Besohet se pushtimi rus i Ballkanit Perëndimor dhe ujdia e fuqive aleate që këto shtete të mbeteshin nën BRSS-në e ndihmuan konsolidimin e pushtetit komunist në ish-hapësirën jugosllave.



Dokumenti 2. Ministria e Jashtme e Rusisë kërcënon Malin e Zi, 2016 https://twitter.com/mfa_russia/status/753582967356854272?s=20

“Perdja e Hekurt” e re në mes dy superfuqive krijoi ndarje të reja në Ballkan, deri në shpërbërjen e komunizmit në vitin 1989. Me tendosjen e marrëdhënieve mes sovjetikëve dhe jugosllavëve në vitin 1948, në fakt diplomacia ruse ndryshoi qasjen ndaj Ballkanit, sidomos ndaj hapësirës jugosllave, duke u fokusuar në Shqipëri dhe u aktualizua përsëri pas Luftës së Ftohtë

POLITIKA RUSE PAS RËNIES SË MURIT TË BERLINIT

Roli i Rusisë në Ballkanin postkomunist ka qenë prej kohësh një temë e hapur midis shteteve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, një debat që u bë aktual sidomos pas vitit 2008, me rënien e interesit të zgjerimit Bashkimit Evropian në Ballkan. Periudha e Boris Jelcinit dhe e Vladimiri Putinit është e një rëndësie të madhe për reflektimet e fundit ndaj Ballkanit, pasi hedhin dritë mbi politikën dhe perceptimet kombëtare ruse në lidhje me vendet e Ballkanit dhe të ardhmen e tyre. Elita politike ruse eksperimentoi me një internacionalizëm para se të kalonte drejt realizmit socialist. Është interesante se si shkolla të ndryshme të mendimit i perceptojnë interesat kombëtare ruse në rajonin e Ballkanit dhe si bota perëndimore

dhe shtetet e brishta të Ballkanit e shohin Rusinë në gadishull.

Politika ruse u bë aktive gjatë shkapërdërdhjes së ish-Jugosllavisë (1991) dhe konfliktit në Kosovë (1998-1999), ku diplomacia e saj bëhet pjesë e negociatave në Dejton dhe Rambuje të Francës, që vulosën të ardhmen e konflikteve në rajon. Gjatë luftës në Bosnjë, shqetësimi kryesor i Moskës ishte parandalimi i NATO-s që të ndërmarrë aksione ushtarake kundër serbëve të Bosnjës. Ky ishte pjesë e planit më të gjerë rus për të ndaluar zgjerimin e NATO-s, sesa një veprim thjesht i solidaritetit për vëllezërit sllavë ortodoksë. Me gjithë kundërshtimet ruse, NATO nën urdhrin e presidentit të atëhershëm amerikan Bill Clinton në vitin 1995 nisi një fushatë ajrore kundër forcave serbe të Bosnjës, e cila përfundimisht çoi në negociatat e Dejtonit dhe përfundimin e luftës në vjeshtën e vitit 1995. Ngjashmëritë dhe dallimet në politikën e jashtme ruse vazhduan deri në luftën e Kosovës, ku këndvështrimi rus për Ballkanin nuk ndryshoi.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë sipas Moskës ishte një intervenim pa miratimin e OKB-së dhe një shkelje e të drejtës ndërkom-bëtare. Fuqitë perëndimore thanë të kundërtën nga ajo “se ndërhyrja

në Kosovë ishte shkelje e të drejtës humanitare”. Në të vërtetë, Kremli e interpretoi këtë veprim të NATO-s si një dëshmi tjetër të shndërrimit të NATO-s në një aleancë ushtarake me qëllime globale dhe shkelje të sovranitetit të shteteve, rasti i Serbisë.

Rusia arriti megjithatë të dërgojë në të njëjtën kohë forca ruse në Kosovën veriore, paralel kur forcat shumëkombëshe të NATO-s hynë në Kosovë, por megjithatë kjo ishte një zhgënjim për Rusinë për rolin e saj minimal në Kosovën e pasluftës. Moskë, duke marrë një qëndrim kundër “standardeve të dyfishta” nga Perëndimi, e rriti mundësinë e shfrytëzimit të zhvillimeve në Ballkan për të mbështetur politikën ish-sovjetike në sferat e dikurshme të interesit rus. Me rënien nga pushteti të Sllobodan Millosheviqit në vitin 2000, krizën ndëretnike (2001) në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM), tani e quajtur Maqedonia e Veriut dhe në Mal të Zi, Rusia krijoi kushte që të ndërhyjë në politikën e brishta të Ballkanit Perëndimor. Në këtë drejtim duhet parë disa pika kritike ku politika e jashtme ruse në Ballkan mbështeti partitë politike në mënyrë të hapur dhe ndonjëherë fshehurazi. Që nga fillimi i dekadës dhe sidomos pas vitit 2000 politika bal-

lkanike e Rusisë ishte e përcaktuar, të paktën pjesërisht, nga gjeopolitika e energjisë dhe e tubacioneve të gazit natyror.

Moska ishte e shqetësuar gjithnjë e më shumë se eksportet e energjisë në Detin Kaspik mund të kenë një ndikim negativ në aftësinë ekonomike të vetë Rusisë për të siguruar tregjet evropiane dhe ballkanike për produktet e saj. Duke pasur parasysh varësinë e vet nga eksportet e naftës dhe të gazit për pjesën më të madhe të fitimeve të saj, Rusia nuk mund të përballojë një eksport të ulët të mallrave, gjë që vërteton varësinë e ekonomisë nga distribuimi i resurseve natyrore shtetërore. Kompanitë ruse si “Gazprom”, dhe “Lukoil” ishin dhe vazhdojnë të jenë të inkurajuar nga politika zyrtare ruse të investojnë shumë në infrastrukturën energjetike të rajonit dhe të ushtrojnë ndikim në politikën e vendeve të Ballkanit. Në lidhje me “fuqinë e butë” të Rusisë në rajon, e cila duhet të merret parasysh si një tregues që luan rol para dhe pas hyrjes së shteteve të Ballkanit Perëndimor në NATO apo BE, duhet theksuar se këto taktika dhe koncepte të reja të Rusisë janë armë vdekjeprurëse për demokracitë e brishta të Ballkanit.

Këtu duhet përmendur edhe një argument tjetër, se me shpërbërjen e BRSS-së ka pasur një rigjallërim të madh të interesit për të kaluarën para-sovjetike të Rusisë nga popujt sllavë të Ballkanit, si dhe një debat të madh për rindërtimin e një aleance të re pas vitit 2000. Kishat ortodokse janë restauruar në të gjitha vendet e rajonit, poetë dhe artistë pro shtrirjes së Rusisë në këtë pjesë të Evropës me veprat e tyre të financuara nga Federata Ruse edhe një herë ishin dhe janë në shërbim të politikës ruse për një Ballkan të ri proruse. Sidoqoftë, politika aktuale e shteteve nuk është aq bindëse se raportet e tyre pro-SHBA-së dhe BE-së do të qëndrojnë në të njëjtin kurs, duke theksuar këtu rolin strategjik të Serbisë me standarde të dyfishta në politikën e jashtme dhe të sigurisë.

Federata Ruse ka qenë historikisht dhe politikisht e pranishme në Ballkan në këto dy shekujt e fundit dhe është arsyeja pse marrëdhëniet midis Rusisë dhe Ballkanit kanë një traditë të pasur dhe të gjatë në Gadishullin Ballkanik, në të cilin Rusia ka luajtur një rol të rëndësishëm duke bërë presion për të ndryshuar kursin e jashtëm të shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Në aspektin gjeopolitik, së bashku me ndryshimet që ndodhën në fund të viteve 80-të në bllokun komunist dhe ish-Jugosllavi, Rusia ka realizuar gjithnjë e më

shumë interesat e saj përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik me organizatat joqeveritare, përdorimin e Kishës Ortodokse Ruse (KOR) dhe, së fundi, me ndërhyrjet hibride.

Ndër partnerët më të rëndësishëm ekonomik të Rusisë janë pothuajse të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, duke përfshirë këtu edhe Ballkanin. Në këtë kontekst, Rusia bëhet një subjekt gjithnjë e më i rëndësishëm i marrëdhënieve politike dhe ekonomike ndërkombëtare. Potencialët ekonomik dhe teknologjisë ushtarake e bëjnë Rusinë një subjekt shumë të respektueshëm të ekonomisë globale dhe aktor kryesor në të gjitha krizat dhe vendimmarrjet botërore.

Dekadat e fundit të shekullit XX, ndërprerja e strukturës socialiste, shembja e BRSS-së, ish-hapësira jugosllave dhe domosdoshmëria e përfshirjes në procesin e globalizimit, e kanë ndryshuar disi rrjedhën e politikës së jashtme të Rusisë dhe të shteteve të Ballkanit. Duke pasur parasysh këtë, marrëdhëniet ndërkombëtare midis vendeve të Ballkanit dhe Rusisë duhet të vëzhgohen në kontekstin e marrëdhënieve gjeostrategjike, përkatësisht aty mund t'i gjejmë edhe themelet dhe fazat e ndërhyrjes ruse në Ballkan në emër, gjoja të globalizimit dhe shfrytëzimit të situatave emergjente shëndetësore ose kombëtare, rasti me pandeminë globale Covid-19. Edhe pse shtetet e Ballkanit Perëndimor mbeten në rrugën e duhur për t'u anëtarësuar në BE, pasiguria e shteteve të brishta është tipar i rëndësishëm për politikën e jashtme ruse.

Rusia dëshiron të punojë kundër BE-së dhe NATO-s në rajon. Që nga fillimi i konfliktit në Ukrainë në vitin 2014, angazhimi në rritje i Rusisë ka shkakuar shqetësime në Uashington në lidhje me stabilitetin në rajon dhe planet e vendeve të Ballkanit Perëndimor për t'u anëtarësuar në BE.

Sidoqoftë, anëtarësimi në të ardhmen në BE i kandidatëve si Mali i Zi, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria, si dhe kandidatët Kosova dhe Bosnja-Hercegovina, lë të kuptojmë se dilema strategjike se a do të ketë shtrirje të ndikimit të Rusisë në të ardhmen nuk është aq e tepruar. Përkundër vullnetit të mirë për anëtarësim dhe përparim zyrtar drejt BE-së, vendet janë ende larg përmbyshjes së kriterëve për pranimin në BE. Rajoni vazhdon të lëngojë nga korrupsioni, mungesa e sundimit të ligjit dhe krimi i organizuar. BE-ja pohon perspektivën e Ballkanit Perëndimor brenda unionit dhe dëshiron t'i afrojë shtetet e rajonit përmes reformave strukturore deri në vitin 2030.

Në këtë linjë, Rusia është e lidhur ngushtë me pjesët sllave dhe ortodokse të Ballkanit Perëndimor me lidhje të ngushta tradicionale.


Lufta e Kosovës e vitit 1999 ishte një pikë kthese ku Rusia mendonte se interesat ishin shpërfillur nga vendimi i NATO-s për të sulmuar Serbinë. Ndërsa angazhimi më i fortë ekonomik i Moskës në dhjetë vitet e fundit ka përfshirë gjithnjë një element politik, por ajo kurrë nuk e sfidoi seriozisht perspektivën e BE-së për shtetet e Ballkanit Perëndimor, por vetëm anëtarësimin ushtarak në NATO. Në lidhje me Ballkanin Perëndimor, Rusia tani i referohet presionit të jashtëm për integrimin të shteteve të ish-hapësirës jugosllave në NATO si një problem që kërkon zgjidhje strategjike, ku detyrimit veprimet e ardhshme ruse lidhen me konceptin e politikës së jashtme ruse të miratuar në vitin 2013, ku rajonit i atribuohet një shkallë e lartë me rëndësi strategjike.

Partneri kryesor i Rusisë në Ballkanin Perëndimor është Serbia. Lidhja e ngushtë midis dy vendeve mund të gjurmohet përsëri në rolin e Perandorisë Ruse si mbrojtës i të gjithë popujve sllavë. Kohët e fundit, mbështetja politike e Rusisë për Serbinë në dialogun mes Serbisë dhe Kosovës ka qenë e një rëndësie thelbësore.

Vendimi i Rusisë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KSOKB), për të mos njohur shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 është gur themeli i pozitës serbe në këtë mosmarrëveshje. Kjo rrethanë shpjegon gjithashtu popullaritetin e lartë të Rusisë midis pakicës serbe në Kosovë. Dëshira për bashkimin e zonave me shumicë serbe të veriut të Kosovës me Serbinë i dha një impuls të ri të aneksimit rus të Krimesë në vitin 2014, pasi që nga viti 2013 Rusia dhe Serbia kanë mbajtur një partneritet strategjik. Kjo përfshin bashkëpunim ushtarak dhe inteligjent, si dhe pozicione të koordinuara në organizatat ndërkombëtare.

Në të njëjtin vit, Serbia u bë një vëzhgues në aleancën ushtarake të Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive (CSTO), të udhëhequr nga Rusia.

Rusia gjithashtu mban lidhje të ngushta me Republikën Serpska në Bosnjë dhe Hercegovinë, ku dihet se udhëheqja politike e kësaj republike vazhdon të flirtojë me shpërbërjen nga federata. Aneksimi i Krimesë nga Rusia u mirëprit nga serbët e Bosnjës, madje u fol për një shpallje të mundshme të pavarësisë që do të njihej nga Rusia. Kështu, Rusia ka ndikim mbi shtetin serb dhe serbët e Bosnjës në tërësi



për qëllime strategjike të hapjes së korridoreve lundruese dhe të transportit në Neum, portin strategjik të federatës boshnjake.

Në këtë drejtim, vitet e fundit nga 2008 e deri në vitin 2017, duke përfshirë etapën politike deri në rrëzimin e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski, ishim dëshmitarë të një aleance midis Rusisë dhe Maqedonisë së atëhershme (IRJM). Qeveria maqedonase e Gruevskit, si ato të Serbisë dhe Bosnjë dhe Hercegovinës, nuk pranuan t'u bashkohesh sanksioneve ndërkombëtare kundër Rusisë, duke shpresuar të arrijnë një intensifikim të bashkëpunimit ekonomik dhe strategjik me Rusinë. Ndërsa ekonomia e Malit të Zi varej fuqimisht nga investitorët rusë në bregdetin malazez, veprimet e qeverisë malazeze kanë qenë të pavarura politikisht nga Moska, qëkur vendi fitoi pavarësinë nga Serbia në vitin 2006, megjithatë Rusia ende përpigëj të ushtronte ndikimin politik përmes opozitës dhe pakicës serbe deri në grusht shtetin e vitit 2016.

Për më shumë, pozita dominuese e Rusisë në sektorin e energjisë është thel-

bësore për ruajtjen e ndikimit të saj në Ballkanin Perëndimor, ku Serbia, Bosnja dhe Maqedonia e Veriut varen dukshëm nga gazi natyror rus. Në plan kombëtar Serbia mbulon më shumë se 75 për qind të nevojave kombëtare me gaz rus, ndërsa kompanitë shtetërore ruse kontrollojnë prodhimin e naftës dhe të gazit dhe gjithashtu operojnë rafineritë, si dhe rrjetin e shpërndarjes. Gjendja vazhdon të paraqitet e njëjtë edhe në Republikën Serbe të Bosnjës, pasi rafineritë e vetme boshnjake të naftës janë nën kontrollin e kompanive ruse dhe që ushtrojnë në një farë mënyre ndikim mbi ekonominë boshnjake.

Pavarësisht llogaritjeve politike, vlera strategjike e rajonit zbrit në rëndësinë e Ballkanit si rrugë tranzitore për gazin rus, pasi njoftimi i qeverisë së Rusisë në fund të vitit 2014 se po përfundonte tubacionin “Përroi Jugor” u vlerësua gjerësisht si një pengesë për marrëdhëniet e saj me Ballkanin Perëndimor. Tubacioni kishte për qëllim të transmetonte gazin rus përmes Bullgarisë dhe Ballkanit Perëndimor në Evropën Qendrore dhe Perëndimore. Nuk vonoi shumë kur Rusia filloi ndërti-

min një tubacioni tjetër në Turqi, “Përroi Turk”, dhe që ka një rëndësi tejet strategjike dhe gjeopolitike për politikën e ndikimit rus në Ballkan.

ⁱSotirovic, Vladislav B. 2018. <https://www.globalresearch.ca/tsarist-russia-and-the-balkans-a-brief-historical-overview/5634498.42>. Accessed 4 20, 2020.

ⁱⁱStavrianos, Leften Stavros. 1945. *Balkan Federation: A history of the movement toward Balkan unity in modern times*. Northampton: Archon Books. 30-59.

ⁱⁱⁱPons, Francesca GoriSilvio. 1996. *The Soviet Union and Europe in the Cold War, 1943-53*. London: Palgrave Macmillan, London. 222-245.

^{iv}Nation, R. Craig. 1996. *A Balkan Union? Southeastern Europe in Soviet security policy, 1944-8*. London: Palgrave Macmillan, London. 125-135.

^vKaragiannis, Emmanuel. 2011. “Russia and the Balkans: Foreign Policy from Yeltsin to Putin.” *Journal of Southeast European & Black Sea Studies* 11 (1): 93-94.

^{vi}Samokhvalov, Vsevolod. 2019. “Russia in the Balkan: “Great Power politics and local response”.” *Insight Turkey* 21, 2. 189-210.

RRËFIM PËR DY BOTËT NË ALANYA

**Nga Qemal Rushiti
(Enkas për HeR)**

Vitet kaluan pa u vënë re, u humbën në valët e tërbuara të kohës vërtik. Pas shumë vitesh pune të lodhshme, por i lumtur se mund të bëj diçka të mirë për veten e për shoqërinë, më erdhi koha e pensionit, koha për të hyrë nën strehën e qetësisë. Herët a vonë, vjen një moment kur njeriu mbërthehet nga gëzimet dhe urimet. Pensioni është një nga ngjarjet më të rëndësishme të njeriut: njeriu mendon se gjithçka në jetë do të jetë e qetë dhe e matur, mund ta planifikosh kohën tënde të lirë ashtu siç beson vetë, si është më mirë!

Ashtu më ndodhi edhe mua. Më 18 maj, 2022, elhamdulillah, i rrumbullakove të 65-tat, ku në mënyrë definitive e mora emrin pensionist. Dalja në pension nuk është një arsye për t'u mërziur dhe për të menduar se koha deri sa hyra nën strehën e qetësisë ishte e gjitha që ia fala vetes dhe shoqërisë, ngaqë jam ende plot energji për të ecur përpara, për sfidat tjera të jetës.

SURPRIZA TË SHUMTA

Urimet nuk munguan!...Pos surprizave të shumta që më bënë anëtarët e familjes, më nxitën që të shkoj diku në pushime bashkë me mamanë e tyre, përkatësisht me haxhineshën time. Plot qejfe, duke kërkuar një bujtinë, një hotel apo diçka të ngjashme, si "Last Minute", syri m'u fokusua në një ofertë me çmim të volitshëm dhe, pa hezitim, më 3 qershor bëmë rezervimin. E para që më ra në sy dhe më pëlqeu tejmasë ishte pikërisht emri i hotelit, "Haydarpasha Palace", në Alanya (Turqi).

Nisja nga Aeroporti i Zürichut ishte me një aeroplan Boeing me standarde optimale. Ishte një fluturim i qetë, i rehatshëm dhe zgjati diku tre orë e një çerek. E dija se koha e fluturimit do të jetë e



gjatë, prandaj nga Zvicra mora disa libra për të lexuar, kryesisht libra me tematikë fetare. Gjatë fluturimit shfletova nga libri "Gruaja në Kuran" të hoxhës së mirënjohur dr. Benjamin ef. Idriz, Imam në Xhaminë e Pencbergut (Penzberger Moschee) të Bavarisë, Gjermani. Libri në fjalë më pëlqeu tejmasë. Në të autori me shumë burime nga dijetarë eminentë nga këndvështrimi i tij gruan e sheh "më tepër se sa të barabartë" me burrin.

Në mesnatë mbërritëm në Antalia dhe që andej u nisëm drejt destinacionit tonë, Alanya. E gjithë rruga ishte autostradë. Diku-diku, në dalje të Antalisë, vëreja kufizimin e shpejtësisë, ku çuditërisht ishte "82 km" në orë. Diku pas dy orëve rrugëtim me autobus, mbërritëm në kështjellën "Haydarpasha", ku do të kalonim pushimet. Nga shikimi i parë, ngelëm të mahnitur dhe të impresionuar me bukurinë dhe arkitekturën e kështjellës.

Mbretëronte heshtje dhe qetësi, ndoshta edhe nga lodhja që kishim bërë më shumë se gjashtë orë. Pas dy ore gjumë, u dëgjua ezani i sabahut. Me sy gjysmë të hapur, mezi e gjeta ballkonin që ta shijoj ezanin me mekam "türkçe", e që unë e kam më shumë se pasion.

Hë, paskëm ardhur mu aty ku do t'më kënaqet shpirti, thashë me vete.

Pasi e falëm sabahun në dhomë, sërisht ramë në gjumë, se lodhja e kishte bërë të veten.

Gjëja që më së shumti më pëlqeu në dhomë ishte piktura që rrinte varur në anën juglindore: plaku mjekërbardhë me «qitap» në dorë, duke e dëgjuar «dersin» e mbesës së tij, e cila me shumë vëmendje e shikonte bablokun, i cili bartte fesin e kuq me maramë të bardhë, që ndoshta nga vjetërsia kishte marrë një ngjyrë të vrugët. Piktura për mua ishte shumë domethënëse, sepse simbolizonte trashëgiminë e edukatës dhe të diturisë islame ndaj brezave të rinj.

Nga kati ku banonim lëvizjet brenda hotelit i bënë me ashensor. Aty takonim njerëz ngjyrë biond, të pashëm e të bëshëm. Ne dëshironim t'i përshëndesnim ashtu siç e kemi adet - o me "merhaba" apo me atë zvicerançen "grüezi", por asnjëra as tjetra fjalë s'kishte vend aty, sepse bashkudhëtarët e ashensorit fare nuk na vërenin, apo as që donin të na shikonin!

EZANI I SABAHUT

Ditën e parë e kaluam brenda hotelit, duke mos u larguar më tej. Meqë ishte e xhuma mbrëma, dëshira ime ishte të

shkoj sa më parë te xhamia më e afërt, ku nga ballkoni ynë dukej vetëm minarja. Prej asaj xhamie për herë të parë e dëgjua thirrjen e ezanit të sabahut. Në kohërat kur është ndërtuar kjo xhami, me siguri që ka qenë ndër më të lartat, që të dëgjohet ezani, dhe të shihet nga larg për besimtarët. E tash, për fat të keq, dukej shumë e vogël karshi hoteleve shumëkateshe që ishin ndërtuar përreth saj dhe e kishin ngufatur atë.

Vajta drejt saj, por, si thotë fjala popullore, "syri të rren" - ishte shumë larg. Eca paksa me shpejtësi, sepse nuk e dija me saktësi se kur fillon koha e namazit. Isha në një vend të cilin për së pari herë e vizitoja. Tatëpjetës, drejt saj fillova t'i shpejtoj hapat, por edhe frymëmarrja filloi të më ngufat, u djersita, prandaj ngadalësova hapat.

Para xhamisë, në një pllakë, shkruante: Alanya Müftülüğü TURKLER MH. ARABI CAMII. Sa hyra në oborrin e xhamisë, pashë ca xhematlinj që me shumë qetësi merrnin avdes. Thashë me vete: paskam kohë që të fal dy reqatë namaz për nder të xhamisë.

Në hyrje të faltores, në anën e djathtë, vëreja një derë e cila ishte e hapur. Iu afrova me kureshtje. Një burrë shtatshkurtër më përshëndeti me selam. Më kishte përcjellë duke hyrë në xhami. Ia ktheva selamin. Me një zë të trashë, personi më pyeti në turqisht 'nga ju kemi?'. S'pari herë s'e kuptova, por me "isharete" u morëm vesh dhe i thashë se jam nga Maqedonia e Veriut. Me gjestet e tij, e kuptova se ishte Imami i Xhamisë. Pyetja e radhës që m'u drejtua ishte se 'a jam hoxhë?'. Më pëlqeu mënyra e tij e të shprehurit direkt dhe me buzëqeshje ia ktheva: 'jo, por i respektoj dhe i dua dijetarët; nganjëherë bëj myezinllëk në xhaminë nga vij, në Zvicër'. E pyeta për kohën e namazit të jacosë. M'u drejtua me një fletë kalendari, më të vockël se shputa e dorës.

Meqë kishte mbetur edhe pak kohë, disa minuta, derisa të thirret ezani, shfrytëzoja nga rasti që ta lexoja suren Jasin, sepse tashmë e sa kohë është bërë e zakonshme që kjo sure lexohet për çdo xhuma mbrëma te ne në Xhaminë El-Hidaje (St. Gallen), dedikuar merhumëve të xhamisë e më gjerë.

Me shpejtësi, duke përfunduar faqen e katërt, prej gjithsej gjashtë, hoxha më preku kraharorin në të djathtë, duke ma bërë të ditur se ka hyrë koha e jacosë dhe - 'do na e thërrasësh ezanin'. E falënderova me dorën në zemër dhe pranova. Kisha emocione, por gjeta forcë dhe fillova interpretimin. Të jem korrekt: kisha

dëshirë që ta incizoja këndimin e ezanit, sepse një jabanxhi po thërret ezan në një vend ku rrallëkujt i jepet mundësia. Por, nga respekti nuk tentova. Ma ofroi mikrofonin. Hetova se kishte një teknologji të përsosur zërimi. Sidoqoftë, ia dola dhe më pastaj më tha që të vazhdoj edhe me myezinllëkun...

Prezenca e xhematlinjve ishte shumë e vogël. Por, hoxha që të më inkurajojë, më tha se 'nesër mbushet xhamia', sepse ishte dita e xhuma.

Në fund, si për kujtim, shkrepëm edhe disa foto rasti. Në farzin e jacosë Imami na këndoï nga surja Er-Rahman. Ajo çka unë vëreja, ishte se zëri i tij nuk përputhej fare me atë të ezanit të sabahut. Andaj, e kuptova se ezani gjithandej interpretohet me CD.

Recitimi ishte me një zë paksa të shterrur dhe nga frymëmarrja e shpeshtë, ajëtin s'mund ta kalonte deri në fund. Thashë me vete: 'edhe ky i ngrati vuaka nga astma'. Stili i xhamisë ishte shumë i ngjashëm me ato tonat. Por, çuditërisht, rrethepërqark saj, pjesa ku mbështeten pleqtë, ishte e veshur me 'lamperi'.

...Dita e xhuma, ashtu siç tha dhe vetë hoxha, ishte përplot xhematlinj. Njerëzit nga dukja ishin shumë kategorish: shumica, kuptohet, më esmerë se ne, por atë që vëreja, kishte edhe nga ata me shtat shumë të gjatë dhe të bëshëm. Thashë me vete: 'qenka zonë pehlivanash!'.

PUNËTORI NGA AZERBAJXHANI

Në hotel u nisa më këmbë. Vendi përreth ishte i ngjashëm me tonin dhe dukej shumë pjellor. Edhe kodrat jo aq të larta, por me drurë dhe me gjethe jeshil në të errët. Edhe pse vapë e madhe, thatësira s'kishte vend aty. Dyqanet e vogla rrugës, me punëtorët që presin jashtë, për të të bindur që të hysh brenda dhe të blesh diçka. Ata ishin shumë të shkathët dhe flisnin shumë gjuhë. Njëri prej tyre fliste shumë rrjedhshëm rusisht. Ishte simpatik dhe i afërt me myshterinjtë. Nga kureshtja i dhashë kompliment. Më tha se vjen nga Azerbajxhani dhe se rusishtja është edhe nga gjuhët zyrtare andej.

...Ditët ecin. Ballafaqimi me realitetin që mbretëron në oborret e kështjellës shkon duke marrë hije të zymtë! Në vend të oborreve të rëndomta, kështjella ishte me ujëra «Pool». Pishinat, në krahasim me plazhin, që nuk ishte aq i përshtatshëm, ishin të stërmbushura plot e përplot me turistë. Ta çonin mallin sikur fokat apo luanët e detit kanë dalë të ngrohen në diell... Aty ekskluzivisht shërbehej vodka "gorbaçov". S'i pengonte aspak

dielli, që t'i nxirrte trutë nga vapa. Me një fjalë, alkooli dhe vera këtu derdheshin si në kohën e xhahilijetit. Atëherë e kuptova se përse 'luanët e detit', biondë e bionde, rrinin rrethepërqark 'folesë' së tyre. Pleqtë tanë thoshin më parë se «parja t'i qet mendtë». Interesi dhe materializmi e paskan mundur dinjitetin dhe hyjnoren. Kjo gjendje nuk ishte vetëm në «kështjellë», por, sipas të dhënave, 95% e hoteleve të kësaj ane funksiononin në këtë formë dhe në këtë mënyrë. Ndërkohë që një përqindje fare e vogël kanë filluar të ofrojnë edhe plazhe «hallall»...

Sidoqoftë, ne u munduam që ta ruanim veten dhe u përcaktuam që vetëm pas namazit të sabahut të dilnim rreth bregut të detit sa për të thithur një çikë jod, nëse edhe ai s'do të kishte ndonjë promil alkooli. Shteg për ecje nuk kishte, sepse edhe interesimi për të ishte nën zero. Të vetmit ne ishim ata që e prisnim lindjen e bukur të diellit ngjyrë portokalli, andej nga krahu i minares me drita jeshile. Ngadalë e kuptuam se përse punësohen njerëz nga Azerbajxhani dhe shtete të tjera që kufizohen me Rusinë, enkas për t'ju shërbyer "luanëve të detit" flokëverdhtë.

Të binin në sy, tek-tuk, edhe njerëz nga raca të ndryshme. Një kohë dreke rastësisht, meqë ishin tavolinat gati se të zëna, gjetëm dy vende të lira dhe u ulëm. Në tavolinë kishte ngelur diçka ende pa u ngrënë dhe u patëm mësuar më me këso lloj veprimesh. Ndërkohë, u afrua një çift në moshë të shtyrë dhe një djalë i ri me të. Me shumë buzëqeshje na përshëndetën, duke na thënë 'ju bëftë mirë' në anglisht. Ata kishin shkuar të sjellin edhe diçka nga pemët. Vërejtëm se gjithë çka patën nëpër pjatat e tyre e hëngrën, e jo si të tjerët, të cilët një të tretën e hanin, kurse tjetrën e gjuanin... Kjo sjellje e tyre na detyroi ta fillonim bisedën se 'kush nga je' dhe 'nga vjen'. Kur u prezantuam se vijmë nga Maqedonia e Veriut, por me banim jemi në Zvicër, e moshuara u gëzua tejmasë, sepse kishte qenë në Shkup dhe i njihnte anët tona.

"ATA ISHIN MË NDRYSHE"

Ata vinin nga Guangzhou shumëmilionësh i Kinës, por, si edhe ne, ishin me vendqëndrim në Amsterdam. Njerëz shumë më ndryshe nga shumica e klientelës, me kulturë, me disiplinë dhe shumë

mirënjohës ndaj ushqimit. Biseda jonë me ta vazhdoi edhe më tej, në Pazar (Bazar), ku dolëm bashkë për të blerë...

Brenda kështjellës kishte shërbime nga më të ndryshmet. Kur kalonim për në restorant, punëtorët e Kaukazit ta merrnin mendjen duke reklamuar hamamet dhe masazhet turke!

Ditën e parafundit edhe unë u bëra një prej myshterinjve të tyre. Meqë kam dhembje në anën e majtë të kraharorit, mendova 'haj, se po e provoj se çfarë terapie dhe masazhesh ofrojnë këta esmerët'. Çmimet ishin gati të njëjta, ndoshta pak më të shtrenjta se andej nga vij unë...

E tash, si përfundim: Kush sundon në këto toka??? Unë mendoj se "as sulltani, as krali", por biznesi dhe interesi...

Duke e përfunduar këtë udhëpërshkrim, gëzohem pa masë që nesër, nga orët e hershme të mëngjesit, largohemi nga kështjella "e flokëverdhtëve" dhe kthehemi në Zvicër...

/21 qershor 2022/

(Autori është nga Orasha, Tetovë, dhe jeton në St. Gallen, Zvicër. Është autor i librit "Kujtime nga Haxhi 2018")



KURBANI NGA ASPEKTI JURIDIK ISLAM



Nga Ömer Nasuhi Bilmen

Ç'ËSHTË KURBANI?

Kurbani është një kafshë e posaçme që pritet me nijet ibadeti për t'iu afruar rahmetit (mëshirës) së Allahut fuqiplotë.

Prerja e një kurbani të këtilllë në ditën e Bajramit të Kurbanit është vaxhib (obligim nën farzin e mbi sunnetin - hadithi: "Kush posedon pasuri dhe nuk ka therur kurban, mos t'i afrohet vendit tonë ku falim namazin e Bajramit") për personin që është mysliman, i lirë (jo i robëruar ose jo i burgosur), që është në vendlindje (e nuk është mysafir larg vendlindjes mbi

83 km dhe ku do të qëndrojë më pak se 15 ditë) dhe i pasur. I pasur quhet personi i cili përpos nevojave të veta elementare dhe përpos borxheve, ka pasuri sa e arrin shkallën e nisabit (nisab = është kufiri prej ku myslimani fillon të quhet pasanik dhe obligohet të japë zeqatin dhe sadaka-tu'l-fitrin; kjo shumë është 85 g ar ose 1.128 € (për vitin 2008), që do të thotë se personi i cili mbi nevojat elementare të tij ka kaq pasuri e më tepër, ai obligohet me zeqat e me kurban.

Nëse një person gjatë 3 ditëve të Kurban-Bajramit kishte mundësi materiale të therte kurban, por nuk theri dhe më vonë u varfërua, ky person vazhdon të mbetet borxhli për kurbanin, prandaj nëse nuk pret kurban gjatë këtyre 3 ditëve, mbandaj ai duhet atë kurban ose kundërvlerën e tij t'ua japë sadaka (lëmoshë) fukarenjve. Nëse një person kishte mundësi për të prerë kurban, po nuk preu, apo edhe nuk dha sadaka, atëherë ky duhet të lërë testament (vasijjet, me gojë) që pas vdekjes së tij të paguhet një kurban nga pasuria që ka lënë pas vetes. Trashëgimtarët e kanë vaxhib ta plotësojnë këtë testament të të vdekurit nëse ai ka lënë

pasuri pas vete; e nëse jo, atëherë trashëgimtarët janë të lirë të zgjedhin për po ose jo. Ndërkaq, aspak nuk mund ta kuptoj sjelljen e disa myslimanëve të cilët vetë janë të obliguar të presin kurban dhe nuk e presin këtë kurban për vete, po për babën ose nënën që kanë vdekur. Këta myslimanë duhet ta dinë se ata të vdekurit nuk janë të obliguar të presin kurban, po të gjallët.

KAFSHËT PËR KURBAN

Për kurban mund të priten vetëm dhentë, dhitë, lopët, buallicat dhe devetë. Dhentë e dhitë duhet t'i kenë mbushur nga një vit, ose 7-8 muaj, por që janë të ushqyera mirë, sa të mos dallohen nga nënat e tyre. Lopët e buallicat duhet t'i kenë mbushur nga 2 vjet të plota, kurse devetë nga 5 vjet.

Për kurban nuk mund të priten pulat, gjelat, patat etj., po as edhe kafshët e egra të cilave u ahahet mishi. T'i presësh këto me nijet kurban, është mekruhi tahrimen (gjë e papëlqyeshme afër haramit).

Dhentë e dhitë, secila prej tyre, vlen vetëm për një person. Kurse një lopë,





buallicë a një deve vlen prej 1-7 persona. Mirëpo, me këtë rast është kusht që të gjithë këta pjesëmarrës në kurban të jenë myslimanë, të kenë hise në të dhe nijetin të gjithë ta kenë për kurban. Ortakët pastaj mishin e kurbanit e ndajnë, duke e matur me kandar e jo me sy (kutrum).

Për kurban duhet të zgjidhet kafsha e shëndoshë dhe e ushqyer dhe jo e dobëta dhe e sëmura.

Kurban mund të pritet edhe kafsha që është syçakërr (që shikon shtrembër), e çalë (që shqepen pak, sa mund të ecë vetë deri te vendi ku do të pritet), e zgjebosur, e çmendur (e hutuar), e lindur pa brirë, me brirë pakëz të thyer, me veshë të shpuar apo të çarë për së gjati, me veshë të prerë pakëz në majë të tyre, me disa dhëmbë të rënë (shumicën e dhëmbëve i ka), pa organin gjenital apo edhe e tredhur. Të gjitha këto janë të lejueshme, mirëpo më mirë është të mos i ketë as edhe këto të meta.

Kurban nuk mund të pritet kafsha e verbër (qorre) në një ose të dy sytë, me shumicën e dhëmbëve të rënë, me veshë të prerë ose më tepër se gjysma të këputur, me njërën ose të dy brirët të thyer deri në rrënjë, me bisht të prerë ose të këputur më tepër se gjysmën, me sisa të prera ose të këputura në majë të tyre, e lindur pa veshë ose pa bisht, shumë e dobët sa s'i ka mbetur palcë në asht (kockë) ose e çalë (topalle) aq shumë, sa s'mund të ecë deri te vendi ku do të pritet.

Nëse një person që është i obliguar të presë kurban e blen një kafshë të shëndoshë, mirëpo para se ta presë gjymtohet (bëhet sakat) me një rën prej atyre të ndaluarave që i përmendëm më lart, ky person duhet të presë tjetër kurban të shëndoshë e jo këtë që u bë sakat. Mirëpo, nëse një fukara që s'e kishte borxh

të presë kurban po e bleu (kafshën) dhe pastaj u bë sakat, ky nuk duhet të presë tjetër kurban, ky mund ta presë ashtu siç është. Po kështu, nëse vdes (cof) kurbanit i zengjinit pa u prerë, ai duhet të blejë tjetër kurban, kurse i varfëri nuk duhet të blejë kurban tjetër.

Nëse një kafshë që është blerë për kurban pjell (lind) para se të pritet, bashkë me të pritet edhe e vogla, sepse ajo është e lidhur me nënën dhe hahet mishi i të dyjave. Nëse të voglën nuk e pret, por e shet, ato para duhen dhënë sadaka.

KOHA E PRERJES SË KURBANIT

Koha e prerjes së kurbanit është dita e parë, e dytë dhe e tretë e Bajramit të Kurbanit. Koha e prerjes së kurbanit fillon me faljen e namazit të Bajramit dhe shkon deri në perëndimin e diellit në ditën e tretë të Bajramit. Është mekruh që kurbanit të pritet gjatë netëve të Bajramit. Nuk quhet kurban nëse është prerë ditën e Arifës; përveç nëse është menduar se atë ditë ka qenë ditë Bajrami e del se ka qenë ditë Arifeje, atëherë mundet.

Nëse një person ka blerë kurban, por nuk e preu gjatë këtyre 3 ditëve të Bajramit, ai atë kafshë duhet ta japë sadaka. Nëse pas këtyre ditëve nuk e ka kafshën që e bleu për kurban, përsëri vlerën e asaj kafshe duhet ta japë sadaka dhe nuk e lë për ta prerë një tjetër vitin e ardhshëm. Vitin e ardhshëm do të presë tjetër nëse obligohet të presë.

Me kurban obligohet, pra, personi i cili gjatë këtyre 3 ditëve të Bajramit i plotëson kushtet e parapara që i përmendëm në fillim.

Kurbanin e kthejmë kah kibla dhe pasi themi „Bismil-lahi All-llahu Ekber“,

e therim duke ia prerë zorrën e ushqimit, të frymëmarrjes dhe dy venat kryesore që kalojnë përmes qafës. Është mirë me këtë rast të lexohet ky ajet kuranor: „Inne salati ve nusuki ve mahjaje ve mematii lil-lahi rabbil-alemine la sherike leh“ – „Vërtet namazi im, ibadetet e mia (kurbanit im), jeta ime dhe vdekja ime janë për Allahun, Zotin e botëve, i Cili nuk ka shok.“ (el-En'am: 162)

Kurbanin duhet ta presë vetë personi që e ka obligim prerjen e tij, por nëse ai nuk ka mundësi vetë ta presë, mund ta autorizojë dikë tjetër në vend të tij dhe që të dy duhet të bëjnë "Bismil-lah" me rastin e prerjes së tij.

Mishi i kurbanit është më mirë të ndahet në tri pjesë: një e treta ndalet për familjen, një e treta u shpërndahet fqinjëve të pasur e të papasur, myslimanë a jomuslimanë, dhe një e treta u ndahet nevojtarëve të tjerë. Nëse personi vetë ka më tepër nevojë për gjithë mishin, ai mund ta ndalë edhe të tërin për vete.

Lëkura e kurbanit nuk guxon të shitet; ajo jepet sadaka, ose përdoret për nevojat shtëpiake.

Prej ditës së Arifës në namazin e sabahut e deri në namazin e iqindisë së ditës së katërt të Bajramit, pas çdo namazi farz është vaxhib këndimi i tekbitit (një herë). Nëse harrojmë ta bëjmë sapa të japim selamin e farzit, duhet ta këndojmë atëherë kur të na kujtohet. Tekbiri shqiptohet kështu: "All-llahu ekeberullahu ekber. La ilaha il-lall-llahu vall-llahu ekber. All-llahu ekberu ve lil-lahlil hamd."

Përshtatur nga Rejhan Neziri, nga libri "Büyük İslam İlmihali". Vegëza: <http://www.el-hikmeh.net/.../147-kurban-nga-aspekti-juridik>

ALPINISTI NGA XHEPÇISHTI SYNON NGJITJEN NË SHPELLËN HIRA

Imami i fshatit Lisec, që gjendet në 1.300 m lartësi mbidetare mbi Tetovë, Arsim Idrizi (1993), është nga Xhepçishti dhe prej vitit 2019 merret me alpinizëm në mënyrë profesionale. Ka kryer Medresenë Isa Beu dhe Fakultetin e Shkencave Islame në Stamboll (Istanbul 29 Mayıs). Aktualisht është me studime për master në FSHI, Shkup.

Për mua, thotë ai, Sharri është një mal i shenjtë. Është amanet nga të parët tanë. Muhamedi (a. s.) një ditë prej ditësh shokëve të vet u ka thënë: "Uhudi na do neve; edhe ne e duam Uhudin." Kjo lë të kuptosh se, si mysliman, duhet ta duash kodrën apo malin që ke afër: ta përmendësh dhe ta ruash atë, thotë ai.

Është anëtar i klubit të alpinizmit "Tektaks", alpinist profesional dhe udhëheqës profesional në alpinizëm. Qëllimi im, thotë ai, nuk është që të ngjitem majave më të larta të botës, por t'i di dhe t'i ndjej edhe vendet më të ulëta të Sharrit. Nuk ka terapi më të mirë që të shëron shpirtin sesa bjeshkët. Nuk ka vend që të edukon sikurse që të edukon mali. Veçanërisht nëse jeton në një vend që e çmon malin. Vendi ynë, Maqedonia e Veriut, për këtë sport ofron 2.000 kilometër hapësirë. Pra,



nëse do të njihej një shtetas yni në botë për ndonjë gjë, pa dyshim se do të ishte alpinizmi (Hiking).

Arsim Idrizi thotë se është teologu i parë islam në RMV që ka ndjekur mësimet nga alpinizmi. Por, shton, nuk do të jem i fundit. Kjo, pasi që ne si myslimanë e kemi Haxhin. Haxhi, përveçse si ibadet, llogaritet një degë e sportit të alpinizmit. Ëndrra ime është që t'i prij një grupi për

një shteg të vetëm – drejt rrugës që të çon deri te shpella Hira (Qabe, Arabi Saudite). Kjo është ëndrra e çdo myslimani alpinist.

Imam Idrizi është dhe mësues i Etikës së religjioneve, siç quhet lënda fetare në shkollat publike në RMV, në fshatin Strimnicë, po ashtu rrethina e Tetovës. Gjithashtu, është aktiv në Youtube me dokumentarin "Njeriu i Sharrit" etj.

DHUNA NË FAMILJE, NJË QASJE ISLAME

Ka dalë nga shtypi libri "Dhuna në familje-një qasje nga këndvështrimi islam"

me autor Bashkim Aliun. Libri trajton një nga problemet e nxehta gjithandej në botë

- dhunën në familje.

Libri i qaset kësaj problematike nga këndvështrimi islam, duke vërtetuar me argumente, nga Kurani dhe Sunneti, se dhuna është e ndaluar në Islam; si në familje, ashtu dhe jashtë saj.

Libri në veçanti debaton me ata që pa të drejtë e akuzojnë Islamin, kinse e keq-trajton femrën dhe e legjitimon dhunën në familje, duke e demantuar këtë akuzë të pabazë me argumente nga burimet themelore të Islamit: Kurani dhe Sunneti, si dhe me shpjegime autentike relevante të dijetarëve islamë.

Botues i librit është Swiss Ecri në Zürich (Zvicër), ndërsa recensentë të tij janë Nehat Ismaili dhe Suad Veliji. Redaktimin gjuhësor e ka bërë Entela Hidri. Libri është në dy gjuhë: shqip dhe gjermanisht. Referenca: Islamshop.ch (20.06.2022)



EMRA TË NJOHUR PROF. NUREDIN AHMEDI (1955-2008)

Nga Mr. Beqir ef. Memeti

Prof. Nuredin Ahmedi lindi më 14 shkurt të vitit 1955 në fshatin Xhepçisht të Tetovës. Shkollimin fillor e mbaroi në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në Medresenë Alauddin në Prishtinë. Pas mbarimit të Medresesë, studimet i vazhdoi në Universitetin e famshëm të Ez'herit në Kajro të Egjiptit, në Fakultetin e Gjuhës Arabe – dega Histori islame dhe Civilizim islam. Studimet i përfundoi me sukses në vitin 1985.

Pas përfundimit të studimeve në Universitetin e Ez'herit, u kthye në vendlindje si kuadër deficitar dhe në vitin 1986 u angazhua si profesor i rregullt në Medresenë Isa Beu në Shkup, si mësimdhënës i lëndës Histori islame dhe Civilizim islam.

Veprimtaria dhe puna e tij e palodhshme si mësimdhënës i shquar rezultoi me zhvillimin e arsimit fetar, duke ndihmuar në ngritjen dhe mëkëmbjen e kulturës islame në Maqedoni dhe më gjerë. Angazhimi i tij nuk ishte vetëm si mësimdhënës, pasi ai iu përvesh edhe punës për përpilimin e teksteve shkollore për nxënësit e kësaj shkolle, duke u bërë autor i disa teksteve shkollore për nxënësit e Medresesë, siç janë ato të Historisë

islame për vitin I, II, III dhe IV. Falë angazhimit të tij, u lehtësua dukshëm nxënia e diturive tek nxënësit, sepse ata u pajisën me tekste profesionale dhe njëherazi kështu u kompletua planprogrami mësimor i Medresesë për lëndën Histori islame.

Krahas veprimtarisë së tij si mësimdhënës e edukator, profesor Nuredini angazhohej edhe në çështje të tjera. Ai ishte gjithëherë aty ku e kërkonte nevoja, gjithnjë në frymën e ngritjes së çështjes fetare e kombëtare. Kështu, pas një pune mjaft të madhe, nxori në dritë revistën e Medresesë "Ikre", ku ai ishte redaktor përgjegjës. Ndërkaq, kjo revistë edhe sot e kësaj dite për shumë nxënës të Medresesë shërben si dritare për promovimin e aftësive të tyre shkrimore.

Profesor Nuredini, me punën e tij të palodhshme, u shqua edhe si përkthyes, redaktor, kryeredaktor dhe recensues i shumë librave, si: Etika bashkëkohore të autorit Ibrahim Amini, Islami në praktikë, Komploti botëror, Islami dhe nacionalizmi, Familja e Muhamedit (a. s.), Rasti Israel etj.

Ai asnjëherë nuk kishte frikë nga vdekja, por vetëm nga përtacia. Prandaj, nuk kishte ditë që nuk e vizitonte, nuk e këshillonte dhe nuk e ndihmonte dikë.




Atij nuk i ikte ditë pa e vizituar një shok ose një nxënës.

Ambicet e tij si studiues ishin të mëdha, mirëpo ai ishte jetëshkurtër. Ndërroi jetë në moshën 52-vjeçare, në vitin 2008. Lajmi për vdekjen pikëlloi jo vetëm familjen e tij, por edhe të gjithë ata që e njihnin.

Profesor Nuredini u varros me nderime të larta në vendlindje. Në përcjelljen e tij për në botën tjetër morën pjesë shumë nxënës të Medresesë, profesorë, kolegë, udhëheqës të Bashkësisë Islame, miq e familjarë.

Profesor Nuredini Ahmedi ishte një pedagog i palodhur dhe njeri me horizont të gjerë, i cili me dashamirësinë dhe zemërgjerësinë që e karakterizonte gjithë jetën ia kushtoi përgatitjes së brezit të ri. Ai do të mbetet i paharruar për kolegët, për nxënësit e Medresesë, për miqtë e dashamirët në të gjitha trojet shqiptare e më gjerë.

Allahu (xh.sh.) e pastë mëshiruar.



GOSTIVAR: DHIMBJE PËR DILAVER QAMILIN

Më 7 korrik, 2022, me dhimbje të thellë pranua lajmin se u nda nga kjo botë njeriu human që njohu Gostivari dhe më gjerë - Dilaver Qamili, pronari i Digital Photo Studio DILO nga Gostivari, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Myftinia e BFI-Gostivar, në emër të Myftiut të saj h. Sabahudin ef. Zendeli, nëpunësve fetarë, këshillave të xhamive dhe mbarë besimtarëve islamë të Gostivarit, shpreh ngushëllimet më të sinqerta që rahmetliun Allahu (xh. sh.) ta pranojë në mëshirën e Tij të pafund, familjes t'i

japë durim të pashoq, ndërsa kontributi i tij për Bashkësinë Fetare Islame dhe për Myftininë e BFI-Gostivar të jenë të vlerësuara tek Ai që i vlerëson më së miri veprat e robërve të Tij. Vendtakimi ynë qoftë Xheneti, ishalla, thuhet në njoftimin e Myftinisë së Gostivarit.

Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu, në faqen e vet në Facebook ka shkruar: Me dhimbje të thellë pranova lajmin e ndërrimit jetë të Dilaver Qamilit-Dilo, një shokut tim të ngushtë, po edhe më tepër: një dashamirës i Myftinisë së

Gostivarit dhe BFI të RMV.

Ishte dhe mbeti një personalitet i çiltër, i urtë, i sjellshëm, human e solidar dhe shumë i matur. Nuk dinte t'u thotë 'jo' veprave të mira, në veçanti atyre fetare, kombëtare dhe humane.

Si profesionist i madh në profesionin e fotografisë, gjithmonë ishte në shërbim të jetës fetare. I bëjmë lutje Allahut Fuqiptotë që ta mëshirojë me xhenetin e tij të amshueshëm, ndërsa familjes t'i japë durim të paluhatshëm, thuhet në shkrimin e Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu.



Në ngushëllime te familja e njohur Baleza në Tetovë, me rastin e kalimit në ahiret të haxhi Hasan Balezës, një njeri me personalitet të fortë, që i ka shërbyer shumë fesë dhe kombit. Rahmetliu ka shërbyer mbi dy dekada si myteveli i Xhamisë Muhareme në Tetovë, ndërsa gjithë jetën ia kushtoi me kontribute dhe aktivitete të shumta fesë dhe kombit. I bëjmë lutje Allahut (xh. sh.) që rahmetliun ta përfshijë në mëshirën e tij, duke e graduar me Xhenetin Firdeus, ndërsa familjes t'i japë durimin e paluhatshëm, ka shkruar Reis'ul-Ulema h. hfz. Shaqir ef. Fetahu në faqen e vet në Facebook (16.07.2022).

MESAZH NGUSHËLLIMI

Me pikëllim e dhimbje pranua lajmin për ndërrimin jetë të Mulla Mitatit - Mitat ef. Ismani.

Mulla Mitati jetoi në Gllumovë të Sarajit, por me vullnetin e tij për punë vitet e fundit me shumë përkushtim kreu deytirën e hatibit dhe të imamit në xhaminë e fshatit Arnaqi, thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit, dr. Qenan ef. Ismaili.

Nga thellësia e zemrës i shprehim familjes së tij ngushëllimet më të sinqerta

në emrin personal dhe në emër të Myftinisë së BFI - Shkup.

Familja e tij humbi njeriun e tyre të dashur, ndërsa Gllumova, Arnaqia e Shishova hoxhën e tyre të përkushtuar, kurse Shkupi - një hoxhë të dalluar, që i shërbeu xhematit dhe xhamisë gjatë gjithë jetës së tij.

I lutem Allahut Fuqiptotë që ta shpërblejë me Xhenet për kontributin e tij! - thuhet në njoftimin e Myftiut të Myftinisë së Shkupit. (9.07.2022)

PËRJETIME QË DUA T'I PREK SOT

**-Në kujtim të Mahmud Efendi Ustaosmanoglu,
Turqi, i cili ditë më parë ndërroi jetë-**

Nga Hysein Rizai

Sekretet dhe përjetimet e njeriut nge-
lin mister dhe vazhdojnë të jetojnë deri
në pafundësi me shpirtin!

Ka shumë vite që me vete barti përje-
timet e mia gjatë takimit me një njeri të
ndritur (evlia), e që nuk i kam shfaqur me
të tjerët se kam dashur të ngelin sekreti
im, vetëm e vetëm të mos keqkuptohem.

Por, ja që nga dita kur ky
evlia ia dorëzoi shpirtin Zotit,
shpirti im nuk me lë rehat dhe
më flet. Më thotë se duhet të
flas.

Unë e gjeta rrugën e të
shkruarit, me qëllim që edhe
shkrimi të ngel një përjetim!

Ishin ato ditë të nxehta të
verës së vitit 1989, ku unë bashkë
me djalin e xhaxhait tim udhëtuam
për në Stamboll, me qëllim që të
mësonim rregullat e leximit të Kuranit
famelartë-te-xhvidin.

Ndoshta në moshën që
ishim, kuptohet që më tepër
ishite kënaqësia e shëtijes sesa e
të mësuarit; bile, edhe kur e di
se do të shkoni te familjarë që
jetojnë në Stamboll, që janë
shpërngulur nga Tetova!

Në Stamboll janë disa zona
të njohura për ne ku jetojnë më
tepër familje të shpërngulura
prej këtu. Njëra prej tyre është
edhe lagjeja Alibekoj!

Në Alibekoj jetojnë dajtë e
babait tim (daja Hamdi me
djemtë, Hamza dhe Halid abiu dhe daja
Shukri me të birin Idris abiu), edhe ata të
shpërngulur nga Tetova, por kishin arritur
në atë kohë që të krijojnë një biznes të
tyre me ëmbëlsira. Ata kishin ëmbëlto-
ren "Balltepe", e cila gjendeshte në Fatih, në
mëhallën (lagjen) Çarshamba, që është
qendër e xhematit të famshëm "Ismail-
laga".

Unë në atë kohë nuk e kisha idenë se
kush janë ata, çka veprojnë e si funksio-
nojnë dhe kush është udhëheqësi i tyre
shpirtëror. Mirëpo, dashtë e pa dashtë u
ballafaquam me këtë xhemat, sepse çdo
ditë shkonim te lokali i dajallarëve dhe
aty afër jetonte edhe mësuesi që na më-

sonte rregullat e Kuranit, Kadir efendi.

Një ditë prej ditësh, duke qëndruar
para ëmbëltores "Balltepe", papritmas
para lokalit u ndal një veturë, ndërsa
brenda saj ishte hoxha i nderuar Mahmud
efendi Ustaosmanoglu dhe gjithë njerëzit
që ishin aty u afruan ta përshëndesin. U
afrova edhe unë bashkë me djalin e xha-
xhait. Momentin që e pashë hoxhën e
nderuar ndjeva një kënaqësi shpirtërore.



Pasi iu afruam dhe e përshëndetëm, ai me
dorën e tij të butë na lëmoi në fytyrë dhe
na përkëdheli në kokë dhe na tha: "Ju jeni
të huaj dhe keni ardhur këtu të mësoni
Kuran..." Kur e dëgjuam këtë nga goja e
tij, u habitëm nga e kuptoi që ne jemi të
huaj, ngase ne kishim dëgjuar se hoxha i
nderuar kishte problem me të parit (me
shikimin).

Isha fëmijë dhe në imagjinatën time
rrotulloheshin mendime të ndryshme, por
urtia e tij më barti në një dimension ku u
humb koha; nuk i besoja vetvetes se çka
po ndodh, por ja që tani kur jam duke u
shkruar këto rreshta dhe kam kuptuar
botën e të ndjerit Mahmut Efendi Usto-

smnoglu buzëqeshi, sepse kam takuar
një evlia.

Pas këtij takimi gjithnjë ndjeja se do
takohem përsëri me hoxhën e nderuar.

Po, deshi Zoti dhe e takova pas dy vi-
teve, në vitin 1991.

Unë, bashkë me disa shokë, shkuam
në lagjen Çarshamba në Fatih për të dëg-
juar ligjëratën e tij.

Gjatë kohës që ishte duke ligjëruar
hoxha i nderuar, unë në një moment
iu drejtova Halit abiut (personi i cili
më ka njoftuar me hoxhën Mah-
mud efendiun) me zë të ulët dhe në
gjuhën shqipe i thashë: O abi Halit,
jam shumë i uritur, më hahet bukë.
Unë akoma pa e përfunduar bise-
dën, hoxha Mahmud efendi u
ndërpreu ligjërimin dhe tha: "Të
nderuar vëllezër, ka dy lloje të
urisë: njëra është uri për ilm-dituri
dhe tjetra është uri e barkut-stoma-
kut. Kush është i uritur për dituri,
duhet të jetë i qëndrueshëm në këtë
rrugëtim, ndërsa kush është i uritur
për ushqim, duhet të shkoj e të hajë
diçka."

Në momentin që ai e tha këtë,
unë dhe Halit abiu shikuam njëri-
tjetrin në sy dhe heshtëm, pa mos
thënë asgjë dhe pasi përfundoi lig-
jëratën, u afrova pranë tij dhe e për-
qafova.

Qëndroja mes ndjenjës së fajë-
sisë dhe dashurisë për të kuptuar
mjeshhtërinë e tij.

Aromën e shpirtërisë së të ndje-
rit e kam ndjerë për së fundi herë
në vitin 2012, në shtëpinë e tij në
Bejkoz!

Tani isha me ndjenja më të thella,
sepsa e njihja përvojën e tij shpirtërore!

Nuk arrita të përshëndetem, por
vetëm se e pashë nga larg, për të kuptuar
se edhe ai e di që jemi aty!

Ah sa ndjehej shpirtëria e tij se ai na
sheh neve, na vëren dhe na përjeton.

Tanimë ai nuk është në mesin tonë,
por shpirtëria e tij vazhdon të reflektojë
te njerëzit që kanë pasur mundësi ta njo-
hin.

Zoti e pastë mëshiruar dhe na ba-
shkoftë në xhenet!

(29.06.2022)

FOTO NGA HAXHI 2022 (1443):



FOTO NGA HAXHI 2022 (1443):

